



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORATI**

**RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË NË UNIVERSITETIN
E ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020**

A. SENATI AKADEMIK

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” e trajton veprimtarinë e vitit akademik 2019-2020, sipas Udhëzimit Nr. 5, datë 19.2.2018 të MASR “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”.

Situata dhe mjedisi në të cilin është zhvilluar kjo veprimtari për vitin akademik 2019-2020, ka specifikat dhe veçoritë e veta, të ndryshme nga vitet e tjera. Në këtë vit akademik veprimtaria u orientua, krahas detyrave dhe objektivave të përhershme të IAL-ve, në disa specifika si:

- Përballimi i situatës së pandemisë prej muajit mars 2020 dhe në vijim.
- Kryerja e procesit zgjedhor për autoritetet drejtuese dhe Senatin akademik të UE-së.
- Realizimi me sukses i akreditimit të dytë institucional të UE-së me **kohëzgjatjen maksimale 6 vjet**, sipas vendimit nga Bordi i Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Me Vendim Nr. 49, datë 27.11.2020 “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan”, Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe legjislacionit e vendimeve përkatëse, vendosi si vijon:

1. Vlerësimin përfundimtar pozitiv për institucionin e Arsimit të Lartë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.
2. Akreditimin Institucional të institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, me kohëzgjatjen prej 6 (gjashtë) vite.

Në këtë vlerësim Bordi i Akreditimit u bazua në dokumentacionin e Vetëvlerësimit përfshirë të dhënat e përgjithshme institucionale, Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës, dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm dhe dokumentacionin shtesë, vlerësimin e cilësisë në përmbajtje të kryer nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga ekspertë të huaj dhe vendas.

Sipas Bordit të Akreditimit vlerësohet se:

1. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, procedurën dhe afatet e përcaktuara nga ASCAL për këtë proces;
2. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimin e Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në institucion;
3. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
4. Institucioni ka ndërmarrë masa për të përmbushur rekomandimet e lëna nga akreditimi i parë;
5. Rezultatet e vlerësimit të akreditimit periodik janë nxjerrë në përputhje me gjetjet: pikat e forta, pikat e dobëta dhe afirmimet e identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
6. Rekomandimet e lëna janë në koherencë me gjetjet si dhe shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë për institucionin në fjalë;
7. Vlerësimi përfundimtar i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për cilësinë akademike për këtë institucion është Pozitiv.

Nga bashkëpunimi i strukturave të UE-së lidhur me procesin e Vetëvlerësimit Institucional, u hartua Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Raporti është organizuar dhe realizuar sipas fushave të vlerësimit si më poshtë:



- Organizimi dhe Menaxhimi i institucionit;
- Burimet;
- Kurrikula;
- Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi;
- Studentët dhe Mbështetja e tyre.

Gjykimi për secilën nga fushat e vlerësimit se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet, shprehet me një nga format e mëposhtme:

- Standardet përmbushen plotësisht,
- Standardet përmbushen kryesisht,
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet nuk përmbushen.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), realizoi vizitën në UE, në datat 03. 06.2020 dhe 04.06.2020.

Sipas **Raportit përfundimtar të Vlerësimit të Jashtëm**, datë 13.07.2020, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ka konkluduar në një gjykim të përgjithshëm mbi vlerësimin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” si vijon:

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin, **përmbushen plotësisht.**
2. Standardet për Burimet, **përmbushen kryesisht.**
3. Standardet për Kurrikulën, **përmbushen plotësisht.**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin, **përmbushen plotësisht.**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetja e tyre, **përmbushen plotësisht.**

Gjykimi i përmbledhur nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Ekspertët i rekomandojnë Bordit të Akreditimit që në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Standardet Shtetërore të Cilësisë **përmbushen plotësisht.**

Në vijimësi të punës në UE, disa nga drejtimet kryesore për të prezantuar veprimtarinë janë:

- të bëhet kujdes për parashikimn e kuotave dhe programeve të studimit të lidhura me angazhimin e personelit akademik dhe me gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi;
- të bëhet kujdes për tarifat e shkollimit për vitin në vijim, si dhe elemente të tjera që lidhen me shërbimet që UE ofron;
- të bëhet kujdes për paraqitjen e problemeve të konstatuara nga UE, me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat shtetërore në fushën e arsimit;
- të rritet në vijimësi përgjegjshmëria, transparenca, llogaridhënia dhe siguria e cilësisë së shërbimeve që ofron UE.
- të bëhet kujdes për paraqitjen e gjendjes financiare të institucionit etj.

Për vitin akademik 2019-2020, raportimi vjetor bazohet kryesisht në realizimin e misionit dhe detyrave të përcaktuara, arritjeve, vështirësive si dhe të objektivave e synimeve që ka për të ardhmen institucioni lidhur me veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare për Universitetin e Elbasanit.



Në analizat dhe vlerësimet e kryera në mënyrë periodike është bazuar raportimi për veprimtarinë e vitit akademik 2019-2020 si vijon:

- Analiza dhe vlerësime për veprimtarinë e kryer nga organet drejtuese si Senati Akademik, Bordi i Administrimit si dhe nga të gjitha njësitë përbërëse pranë Rektoratit;
- Analiza dhe vlerësime për veprimtarinë e kryer prej njërive bazë dhe njërive kryesore të pesë fakulteteve;
- Raporti financiar i institucionit për vitin 2019-2020.

Ndihmesa dhe bashkëpunimi i strukturave drejtuese me personelin akademik dhe ndihmësakademik, duhet vlerësuar për realizimin e raportit dhe dokumentimin e tij.

Strukturat drejtuese të Universitetit në vijimësi kanë monitoruar dhe ballafaquar rezultatet e punës me veprimtarinë e pasqyruar në raportet e viteve të kaluara.

Krahas objektivave konkrete që ka Universiteti për të ardhmen, për hartimin e raportit janë vlerësuar duke u përshtatur me kushtet e UE, politikat mbi arsimin e lartë të ndjekura nga MASR si dhe drejtimit e përgjithshme të zhvillimit, si ato rajonale, kombëtare e më gjerë, të shprehura sipas legjislacionit në fuqi, vendimeve të Qeverisë, udhëzimeve dhe urdhrave nga MASR.

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, datë 19.2.2018 të MASR “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, raportimi realizohet nëpërmjet një materiali të përgatitur nga organet drejtuese të UE-së, të strukturuar sipas fushës së tyre të kompetencës ku trajtohen çështjet në vijm:

a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të UE.

Në përbërjen e tij Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka pesë njësi kryesore (fakultete):

1. Fakulteti i Shkencave të Edukimit
2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës
3. Fakulteti i Shkencave Humane
4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
5. Fakulteti Ekonomik

Në këtë raport pasqyrimi i veprimtarisë mësimore e kërkimore për UE, është realizuar duke patur për bazë raportet përveprimtarinë e njërive bazë dhe ato kryesore, departamenteve dhe fakulteteve përkatëse lidhur me realizimin e procesit mësimor e kërkimor, sipas vëzhgimeve, analizave, kontrolleve, vlerësimit dhe zbatimit të dokumentacionit ligjor etj.

Senati Akademik i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për vitin akademik 2019-2020 ka përcaktuar objektiva dhe detyra konkrete, në drejtim të rritjes së cilësisë së veprimtarisë mësimore e shkencore, duke u mbështetur në arritjet e deritanishme dhe me synimin për të çuar përpara këto arritje. Njësitë kryesore dhe njësitë bazë gjatë vitit 2019-2020, mbi bazën e këtyre objektivave, e kanë orientuar dhe realizuar në disa drejtime punën mësimore e shkencore:



- Në vijimësi për të gjitha ciklet dhe format e studimit është synuar ristrukturimi dhe përmirësimi i programeve mësimore, në përputhje me standardet akademike, udhëzimet e MASR, Statutit dhe Rregullores së Universitetit si dhe gjithë dokumentacionit universitar.
- Për procesin mësimor është synuar rritja cilësore duke e shoqëruar me përditësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së ligjëratave dhe seancave praktike me të reja bashkëkohore të shkencës.
- Përmirësimi dhe zbatimi i modeleve dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies si faktorë të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për rritjen e cilësisë dhe performancës së procesit mësimor.
- Realizimin në mënyrë sa më cilësore të praktikave profesionale dhe praktikave në terren të studentëve.
- Mbarëvajtja e procesit mësimor dhe shkencor bazohet në përgatitjen dhe ruajtjen e dokumentacionit të domosdoshëm dhe marrjen e masave për minimizim deri në eliminim të problematikave të hasura.
- Në vijimësi është punuar për sigurimin e cilësisë së shërbimit të ofruar nga personeli dhe infrastruktura e laboratorëve; sigurimin e asistencës së nevojshme për të gjithë studentët dhe sidomos për mbarëvajtjen e tyre në lidhje me tregun e punës dhe kualifikimin e mëtijshëm të tyre.
- Organizimi dhe realizimi i ditëve të informimit me maturantët, në lidhje me programet e studimit të ofruara nga institucioni për vitin akademik 2019-2020.
- Personeli akademik është nxitur dhe mbështetur për kualifikim në të gjitha nivelet dhe drejtimet, ka rritur pjesëmarrjen në veprimtari shkencore, në procese kërkimi dhe botimi brenda dhe jashtë vendit.

Studimet e ndryshme të konkretizuara përmes artikujve, kumtesave e referateve etj., kanë sjellë risi si në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, ashtu edhe në drejtim të thellimit në fusha të ndryshme të shkencës dhe zbatimit të njohurive në praktikë. Veprimtaria mësimore e mbështetur nga aktiviteti kërkimor-shkencor i personelit akademik dhe kualifikimin e tij në vijimësi, e ka vendosur Universitetin në nivele gjithëpërfshirëse për zhvillimin e arsimit dhe veprimtarisë kërkimore-studimore, për rajonin dhe më gjerë.

Nga monitorimet e strukturave drejtuese të Universitetit, si dhe bazuar në raportet e analizave të realizuara në nivel njësie bazë dhe kryesore, veprimtaria mësimore e Universitetit gjatë vitit akademik 2019-2020 në tërësi është karakterizuar nga përpjekje intensive e të vazhdueshme të personelit akademik për të instaluar metoda e forma bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje e kompetenca që ju duhen për të ardhmen.

Në departamentet dhe fakultetet e Universitetit veprimtaritë kryesore të realizuara për procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor, evidentohen si vijon:

Procesi mësimor:

Nga analizat e kryera në lidhje me procesin mësimor në nivel departamenti dhe fakulteti, rezulton:

- Për vitin akademik 2019-2020 procesi mësimor është realizuar plotësisht.
- Në vijimësi është kryer rishikimi dhe përmirësimi i planeve, programeve mësimore, i strukturës së vitit akademik, orareve mësimore etj.
- Procesi mësimor dhe mësimdhënia janë integruar me veprimtarinë kërkimore.



- Nga njësitë bazë janë përgatitur kurrikula për hapjen e programeve të reja të studimit, ku disa janë miratuar nga MASR dhe të tjera janë në pritje, konkretisht në ciklin e parë, të dytë dhe programe me karakter profesional dyvjeçar.
- Riorganizimi i programeve të ciklit të dytë “Master Profesional” (kryesisht drejtimi mësuesi) në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimeve dhe vendimeve përkatëse.
- Personeli akademik në vijimësi ka hartuar dhe përmirësuar leksione, cikël leksionesh, botime të teksteve mësimore dhe laboratorike sa më bashkëkohore.
- Ka vijuar puna për riorganizimin, diskutimin dhe miratimin e programeve mësimore, në zbatim të ligjit për IAL dhe udhëzimeve të MASR, kryesisht të lidhura me programet e ciklit të parë dhe të dytë.
- Janë hartuar disa programe të reja me karakter profesional dyvjeçar, të ciklit të parë bachelor dhe të ciklit të dytë master, nga të cilat janë miratuar dy programe të reja me karakter profesional dyvjeçar.
- Veprimtaria në dokumentacionin përkatës, është pasqyruar në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e MASR, statutin dhe rregulloret e Universitetit, fakulteteve dhe programeve të studimit etj.
- Në vijimësi është kryer përmirësimi i rregullores së studimeve, zhvillimit të provimeve dhe formave të tjera të kontrollit, përmirësim në vijimësi i procedurave për udhëheqje të tezave të diplomës në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Vijon procedura sipas së cilës studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, kriteri i notës mesatare etj.
- Realizimi në mënyrë sa më cilësore për praktikat profesionale dhe mësimore sipas specifikave të programit dhe grupeve mësimore.
- Mbi bazën e planit dhe programit mësimor nga personeli akademik janë hartuar planet kalendarike dhe janë bërë përpjekje maksimale për realizimin sasior dhe cilësor të procesit mësimor. Personeli akademik gjithashtu ka treguar kujdes për përditësimin e pasurimin e ligjëratave me të reja bashkëkohore si dhe për mënyra efektive për kontrollin e dijeve.
- Biblioteka e Universitetit sipas kërkesave të njërive bazë ka synuar dhe realizuar shtimin e literaturës profesionale e shkencore.
- Sipas Statutit të Universitetit dhe modaliteteve të miratuara nga Senati, realizohet rekrutimi prej departamenteve i personelit akademik të nevojshëm duke ndjekur procedurat ligjore dhe transparente. Për të zhvilluar kryesisht orët e seminareve apo ndjekje të praktikave profesionale të studentëve, aktivizohet sipas nevojave të departamenteve personel akademik me kohë të pjesshme.

Nëpër departamente në zbatim të rregullores dhe udhëzimeve, janë zhvilluar mbledhje për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë nga ana e të gjithë personelit akademik. Për një ecuri sa më normale të procesit mësimor, nga Rektorati, fakultetet dhe departamentet janë organizuar kontrole të vazhdueshme lidhur me dokumentacionin e secilit nga personeli akademik, sidomos për programet përkatëse të disiplinave mësimore.

Në fakultete dhe departamente nga analizat që janë bërë, vihet në dukje dhe vlerësohet në përgjithësi pozitivisht puna e të gjithë personelit akademik. Për punën e personelit akademik, duhet vjelur edhe mendimi i studentëve, me më shumë shembuj konkretë.

Nga ana e strukturave drejtuese në kuadrin e organizimit të procesit mësimor, janë bërë kontrole mbi disiplinën në punë dhe cilësinë e mësimdhënies. Bisedat me pedagogë dhe studentë, kontrollet, vëzhgimet, kontrolli i dokumentacionit etj., në vijimësi kanë mundur ecurinë normale të këtij



procesi, si në aspektin sasior (realizimin e orëve të programit) ashtu edhe në aspektin cilësor. Në vijimësi është bërë ballafaqimi i planeve kalendare me orët e realizuara nga pedagogët, si dhe janë hartuar planet për plotësimin e orëve të parealizuara për arsye të ndryshme (raportet mjekësore, festa zyrtare etj), para përfundimit të çdo semestri.

Për mbarëvajtjen e procesit mësimor vlerësohet kapaciteti intelektual e profesional i personelit akademik, përgatitja për orën e mësimi, niveli i përgatitjes së studentëve dhe përgatitja e tyre sistematike dhe e vazhdueshme, nga baza materiale e didaktike, kushtet e mjedisit mësimor etj. Nga ana e personelit akademik në përgjithësi ka pasur angazhim serioz në procesin e mësimdhënies, por në disa raste të veçanta janë vërejtur edhe probleme, prandaj është tërhequr vëmendja në funksion të përmirësimit të situatës.

Në zhvillimin e procesit mësimor gjatë vitit 2019-2020 janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve dhe praktikave laboratorike, për pajisjen e studentëve me shprehitë e përgjithshme dhe të transferueshme dhe duke synuar:

- Për procesin e mësimdhënies e mësimnxënies të bëhet përcaktimi i objektivave.
- Të realizohet një mësimdhënie ndërvepruese e fokusuar te studenti dhe përdorimi i një game të gjerë materialesh burimore dhe një stil shqyrtimi që kërkon procesin e të menduarit dhe të analizës e jo thjesht njohuri faktike.
- Në procesin mësimor të kihet parasysh rritja e rolit të studentit duke e shndërruar atë nga një subjekt pasiv në aktiv, kërkues dhe pjesëmarrës.
- Përdorimi i TIK në mësim.
- Angazhimi i studentëve në veprimtari kërkimore, në detyra kursi dhe në punën krijuese në lëndë të ndryshme.
- Përfshirja e studentëve të vitit të fundit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në kryerjen e mikrotezave.
- Për kontrollin e dijeve të aplikohen metoda më rezultative etj.

Cilësinë e mësimdhënies e ka ndihmuar mjaft edhe pasurimi i laboratorëve me një bazë materiale të përshtatshme e funksionale. Janë bërë përpjekje në vijimësi për plotësimin e kërkesave të departamenteve për bazë materiale si nga ana sasiore ashtu edhe cilësore.

Në drejtim të rritjes së cilësisë, rezultate pozitive ka dhënë edhe vlerësimi i vazhduar gjithëvjetor i studentëve, i cili merret parasysh sipas një përqindje të caktuar në vlerësimin përfundimtar të tyre.

Në ndihmesë të realizimit cilësor të procesit mësimor dhe rritjes së nivelit mësimor-shkencor në të gjitha programet e studimit të Universitetit, një rol të rëndësishëm kanë luajtur investimet duke plotësuar të gjitha nevojat. Nga ana e studentëve këtë vit, në disa programe studimi, ka një pjesëmarrje më të kënaqshme se vitet e kaluara në leksione, por përpjekjet për përgatitjen e seminareve dhe e punëve laboratorike nuk janë ende në nivelin e kërkesave të kohës. Kjo reflektohet edhe në vlerësimet përfundimtare, të cilat në përgjithësi nuk kanë qenë në nivelin e duhur, qoftë nga ana sasiore, qoftë nga ana cilësore.

Në vijimësi është trajtuar pjesëmarrja e studentëve në disa programe studimi në leksione, ushtrime e laboratore. Kjo është e lidhur me disa elementë, por mendojmë se politika e liberalizimit, sidomos në përqindjen e ndjekjes së tyre dhe mospenalizimin në fund të vitit, madje duke krijuar akses hyrje në provimet e vjeshtës, kanë ndikuar në cilësinë e procesit mësimor.



Praktikat mësimore për vitin akademik 2019-2020 janë zhvilluar sipas kërkesave të programeve duke patur parasysh se zhvillimi i praktikave profesionale dhe praktikave në terren, është një aspekt i rëndësishëm i procesit mësimor në të gjitha programet e studimit në Universitetin tonë.

Nga departamentet dhe strukturat përkatëse janë marrë të gjitha masat, pra është krijuar infrastruktura e duhur për realizimin e këtij procesi të rëndësishëm të mësimdhënies. Janë hartuar programet e praktikave, janë nënshkruar aktmarrëveshjet me DAR, me Spitalin Rajonal të Elbasanit dhe subjektet e ndryshme private apo shtetërore.

Personeli akademik, institucionet dhe subjektet private apo shtetërore, ku zhvillohet praktika, janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm.

Janë bërë përpjekje nga departamentet për një mbarëvajtje sa më të mirë të praktikave dhe për vlerësimin sa më real të studentëve, duke marrë në konsideratë jo vetëm vlerësimin gjatë kryerjes së praktikës, por edhe duke organizuar testime konform programit të praktikave.

Në përgjithësi janë krijuar marrëdhënie të mira me institucionet dhe subjektet shtetërore e private ku kryhen praktikat mësimore. Futja e sistemit të “mentorëve”, si një përvojë e fituar nga projektet e përbashkëta me universitetet perëndimore, prej disa vitesh, ka ndikuar pozitivisht në cilësinë e praktikave.

Gjatë vitit akademik 2019-2020, janë bërë përpjekjet e duhura nga strukturat dhe njësitë e UE-së që praktikat e planifikuara në terren të realizohen, pavarësisht mundësive të kufizuara për të lëvizur dhe mungesës së financimit, konform synimeve për arritjen e objektivave mësimorë.

Për zhvillimin e praktikave sipas fakulteteve:

Praktika mësimore (FSHMT)

FSHMT praktikat mësimore i ka zhvilluar në përputhje me kontratat e lidhura midis institucionit tonë dhe drejtorive përkatëse të Spitalit rajonal dhe të Shëndetit Publik.

Praktikat mësimore janë zhvilluar konform programeve mësimore përkatëse sipas viteve të studimit. Zhvillimi i praktikave është bërë pranë pavioneve, qendrave shëndetësore etj., sipas marrëveshjeve përkatëse.

Praktikat profesionale dhe në terren (FSHN)

Për FSHN praktikat profesionale në programin e studimit “Teknologjitë e informacionit” dhe praktikat në terren (ekspeditat) në programin e studimit “Biologji-Kimi”, janë zhvilluar konform programeve mësimore përkatëse sipas viteve të studimit. T’i kushtohet më tepër kujdes marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave profesionale në institucionet e administratës publike në rajon si dhe në subjektet e ndryshme private.

Studentët janë pajisur me udhëzuesit dhe bazën materiale përkatëse për zhvillim sa më cilësor të këtyre praktikave.

Vlerësimi i studentëve është kryer duke kombinuar vlerësimin e njohurive teorike dhe atyre praktike.

Praktika profesionale (FE)

Për FE praktikat profesionale janë kryer në institucionet e administratës publike në rajon si dhe subjektet e ndryshme private. Studentët janë njohur me organizimin e njësive ekonomike konkrete, me dokumentacionin bazë kontabël, me sistemin e kontabilitetit që ata zbatojnë dhe organizimin e tij,



informatizimin e kontabilitetit, përgatitjen dhe publikimin e pasqyrave financiare, me regjistrimin e tyre, me marrëdhëniet me organet tatimore etj.

Zhvillimi i praktikave profesionale u ka dhënë mundësi studentëve të vëzhgojnë dhe të ushtrohen në pozicione të ndryshme pranë administratës publike, të njohin mënyrën e organizimit të institucioneve publike, bazën ligjore ku mbështesin veprimtarinë, marrëdhëniet e bashkëpunimit dhe të varësisë ndërmjet tyre, mënyrën e përdorimit të fondeve publike, përgjegjësinë në rast të shkeljeve të legjislacionit etj.

Praktikat profesionale u krijojnë mundësi studentëve për të zbatuar në praktikë njohuritë e marra dhe për t'i aftësuar në tregun e punës.

Praktika profesionale (FSHE)

FSHE në bashkëpunim me FSHN dhe FSHH për programet e studimit në Master Profesional, janë hartuar udhëzuesit e praktikave dhe janë caktuar e trajnuar mentorët sipas profileve përkatëse.

Departamentet në bashkëpunim me metodistët kanë ndjekur zhvillimin e praktikave faktike në shkollat përkatëse.

Praktikat mësimore për shkencat sociale janë zhvilluar konform programeve mësimore përkatëse sipas viteve të studimit dhe sipas kontratave me institucione të ndryshme.

Provimet janë një element i rëndësishëm i aktivitetit mësimor.

Të gjitha procedurat janë ndjekur në mënyrë korrekte dhe nuk ka patur kontenstime të rezultateve dhe parregullsi nga ana e personelit akademik. Janë mbikëqyrur dhe minimizuar disa momente të procesit të provimeve, siç është fillimi ende me vonesë në ndonjë rast i provimeve dhe jo në orarin e përcaktuar, sidomos nga personel akademik me kohë të pjesshme dhe në ndonjë rast edhe nga personel akademik me kohë të plotë, apo si pasojë e mbingarkesës së anëtarëve të komisionit që marrin pjesë në shumë komisione, duke e bërë këtë pjesëmarrje ndonjëherë formale.

Për sezonin e vjeshtës ka patur raste të mbingarkesës duke zhvilluar përditë provime, kjo si pasojë e mosfrekuentimit të studentëve në seminare, ushtrime e laboratore, një pjesë e tyre nuk janë futur në sezonin e radhës, duke u dhënë mundësinë e shlyerjes së detyrimeve në vjeshtë.

Rezultatet e vlerësimeve janë pasqyruar në procesverbalet e provimit nëpërmjet sistemit EMS.

Ka ende vend dhe mundësi për përmirësime të mëtejshme sasiore dhe cilësore, krahas rezultateve dhe arritjeve që ka në procesin mësimor.

Në të gjitha sezonet e provimeve të vitit 2019-2020, ky proces përgjithësisht është zhvilluar normalisht me përgjegjësi dhe korrektësi, duke bërë kujdesin e duhur për disa momente kryesore të këtij procesi:

1. Planifikim dhe monitorim për zhvillimin e provimeve; është hartuar në kohë kalendari i provimeve, ku janë përcaktuar datat, ora, mjedisi i zhvillimit të provimit; janë ngritur komisionet për çdo provim; është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit; është ndjekur procesi i sekretimit; afati i vlerësimit të provimeve me shkrim; dhënia dhe pasqyrimi i rezultateve etj.
2. Studentët dhe personeli akademik janë njohur në vijimësi me përmbajtjen e neneve të Rregullores së Universitetit, Fakultetit dhe programeve të studimit, me kërkesat e udhëzimeve për plotësimin e dokumentacionit etj. Duhet thënë se në këtë drejtim ka përmirësime të ndjeshme.



3. Një kujdes i veçantë nga departamentet është treguar për hartimin e tezave të provimeve me shkrim e me gojë, që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve.

Si përfundim mund të thuhet se gjatë vitit akademik 2019-2020 veprimtaria mësimore është realizuar në nivelin e duhur dhe me një punë serioze, duke angazhuar të gjithë personelin akademik të departamenteve, për përmirësimin dhe ristrukturimin e planeve dhe programeve mësimore dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe të ciklit të dytë “Master”.

Përshtatja me udhëzimet apo aktet e reja nënligjore, vijon të ngelet si detyrë që problematikat dhe përmirësimet në aspektin e mësimdhënies të pasqyrohen në Rregulloren e Universitetit dhe të programeve të studimit.

Numri i studentëve të regjistruar sipas programeve të ndryshme të studimit, padyshim ka ndikimin e vet për organizimin, dhe realizimin e procesit mësimor.

Për vitin akademik 2019-2020 është krijuar tabloja e studentëve, që ndjekin studimet në vitet e para, në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë me kohë të plotë dhe informacionet përkatëse janë në tabelat e mëposhtme për çdo fakultet (sipas pikës j të udhëzimit nr. 5 dt. 19.02.2018).

Në Universitetin tonë numri i përgjithshëm i studentëve të rinj që ndjekin studimet në vitet e para për vitin akademik 2019-2020, në të gjitha programet dhe format e studimit, është **2561** studentë.

Edhe për këtë vit akademik nisur nga vlerësimi i shifrave mbi regjistrimet në vitet e para për programet e studimit me kohë të plotë, vihen re dukuritë e mëposhtme:

Së pari, vijon të jetë në rënie numri i studentëve krahasuar me regjistrimin e studentëve të ciklit të parë në raport me vitin paraardhës, sidomos në programet e studimit me orientim mësuesi.

Ndërkohë, disa programe studimi në këtë vit akademik kanë qënë joaktive:

1. Bachelor në gjuhë shqipe dhe rome
2. Bachelor në fizikë kompjuterike
3. Master profesional në gazetari sportive
4. Master profesional gazetar reporter
5. Master profesional në redaktim
6. Master profesional në analist prodhimi
7. Master i shkencave në studime letrare
8. Master i shkencave në studime gjeografike
9. Master i shkencave në trashëgimi kulturore

Së dyti, për cilësinë është tregues nota mesatare e shkollës së mesme e studentëve të regjistruar në vitet e para në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë. Për vitin akademik 2019-2020 vihet re në tërësi një përmirësim i rritjes së cilësisë të studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve, e ndikuar kjo edhe nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave, i cili përcakton vendosjen e notës mesatare mbi 6,5 dhe 7,5 të pranimit të maturantëve në universitet.

Së treti, për Universitetin e Elbasanit është ruajtur hapësira gjeografike e rajoneve nga vijnë studentët, ku mund të përmendim Elbasanin, Librazhdin, Gramshin, Peqinin, Lushnjën, Kavajën, Pogradecin, Tiranën, Fierin, Kukësin, Peshkopinë etj.

Në drejtim të pranimit të studentëve të rinj Universiteti i Elbasanit ka kapacitete edhe më të mëdha, por për të realizuar këtë objektiv, mendojmë se disa nga arsyet janë kushtëzuar nga faktet e mëposhtme:



- Planifikimi i kuotave shumë të larta në programet e studimit në institucionet publike të Tiranës, e lidhur kjo me prirjen, gjithmonë në rritje, që kanë shumica e maturantëve të rajonit tonë për të studiuar në universitetet e kryeqytetit apo edhe jashtë shtetit, pavarësisht se cilin program studimi do të ndjekin.
- Universiteti i Elbasanit e zhvillon aktivitetin e tij në një rajon afër Tiranës, gjë e cila sjell vetvetiu uljen e numrit të studentëve.
- Duhet minimizuar mangësitë në drejtim të reklamimit të shërbimeve që UE mund të ofrojë për studentët e rinj dhe përfitimet që ata mund të kenë nga studimi në programet mësimore në UE. Hapësira e reklamimit ndoshta duhej të ishte më e madhe dhe të shtrihej edhe në rajone të tjera të Shqipërisë.
- Duhet të punohet më shumë në të ardhmen me maturantët, të qartësohen kriteret e pranimit dhe nota mesatare për programet e studimit dhe veçanërisht në programet e mësuesisë, e cila në bazë të vendimit përkatës është 7.5 etj.

b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitutionale dhe projekte ku merr pjesë UE, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.

Në lidhje me mobilitetet Erasmus+, për vitin akademik 2019-2020 Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka realizuar:

- 46 marrëveshje në fuqi, me 16 shtete evropiane;
- 50 mobilitete studentësh (14 studentë kanë kryer mobilitetin e tyre semestrin e parë në universitetet partnere, në semestrin e dytë e kanë kryer mobilitetin e tyre edhe 36 studentë të tjerë;
- 3 mobilitete staf akademik. Mbeten për t’u ekzekutuar edhe mbi 50 mobilitete Erasmus+;
- 15 incoming students, 12 studentë e kanë kryer mobilitetin në UE gjatë semestrit të parë, 3 studentë e kanë kryer gjatë semestrit të dytë;
- 3 incoming staf nga Erasmus+, nga të cilat një është kryer gjatë semestrit të parë, në semestrin e dytë kanë ardhur dy staf në UE.

Në të gjitha fakultetet e UE-së është realizuar promovimi dhe prezantimi i Erasmus+.

Në kuadër të projekteve të Erasmus+, në datat 13-14-15-16 Janar në të gjitha fakultetet u zhvillua një takim prezantues dhe konsultimi rreth mundësive për mobilitete me studentët e secilit fakultet. Përgjatë takimeve u mundësua informacioni rreth Erasmus+ dhe u diskutua mbi mundësitë për mobilitete nga UE. Studentët u njohën me marrëveshjet që universiteti ynë ka lidhur me universitetet ndërkombëtare për shkëmbimet për studentët, stafin akademik dhe administrativ. Stafi i zyrës së marrëdhënieve me jashtë bashkëbisedoi me studentët e pranishëm mbi hapat dhe kriteret e aplikimeve si dhe i dha përgjigje pyetjeve të tyre. Gjithashtu është vënë re një interesim i konsiderueshëm nga ana e studentëve për programin Erasmus+. Stafi i zyrës së marrëdhënieve me jashtë ka qënë i gatshëm të presë studentë dhe t’i informojë ata për çdo informacion të mundshëm. Gjatë kësaj kohe është komunikuar për të mundësuar finalizimin e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit si dhe janë mbajtur kontakte për vijimin e bashkëpunimit me marrëveshjet ekzistuese.

Gjatë vitit akademik 2019-2020 falë koordinimit të mirë, UE ka arritur të lidhë marrëveshje të reja me 10 universitete të ndryshme si: Bolu Abant Izzet Baysal University, University of Jaen, University of Lisbona, St.Cyril and St.Methodius University of Veliko Tarnovo, Kirklareli University, University



of Klaipeda, University of Florence, University of Palermo, University of Cordoba, University Cote D'azur, Nice etj. Bashkëlidhur gjendet lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të programit ERASMUS + 107 KA1.

Për vitin akademik 2019-2020 Universiteti i Elbasanit ka në fuqi **46 marrëveshje** me **16 shtete** evropiane.

➤ Më poshtë gjendet tabela me marrëveshjet në fuqi për vitin akademik 2019-2020

Nr.	Shteti	Nr. i marrëveshjes	Universiteti
1	Poland	1	Catholic University of Lublin
		2	Nicolaus Copernicus University
		3	Economic University of Cracow
		4	Wroclaw Univeristy
		5	University of Dabrowa Gronicza
2	Czech Republic	6	Mendel University in Brno
3	Turkey	7	Istanbul Technical University
		8	Bolu Abant Izzet Baysal University,
		9	Kirklareli University
		10	Istanbul Sehir University
4	Rumania	11	University Politehnica of Timisoara
		12	University of Pitesti
		13	West University of Timisoara
		14	University of Andrei Saguna
		15	University of Iasi
5	Bulgaria	16	University of Varna
		17	D. A. Tsenov Academy
		18	St.Cyriland St. Methodius, University of Veliko Turnovo
		19	University of National and Word Economy
		20	South - West University "Neofit Rilski"
		21	Sofia University Kliment Ohridski
6	Italy	22	University Politenchnica delle Marche, Ancona
		23	University of Foggia
		24	University of Aquila
		25	University of Palermo
		26	University of Florence
7	United Kingdom	27	University of Staffordshire
8	Germany	28	University of Ludwigshafen
9	Greqi	29	University of Aristotele Thessaloniki
10	Finlandë	30	Abbo Akademi



Nr.	Shteti	Nr. i marrëveshjes	Universiteti
11	Spain	31	A. Coruna
		32	University of Jaen
		33	IES Ribeira Do Louro
		34	CIPFP Luis Suner Sanchis
		35	CIPFP Valle De Elda
		36	Institut Provençana
		37	Institut Joan Brossa
		38	Centro Integrado de Formacion Profesional Sectores Industrial y Servicios la Laboral
		39	Centro especifico de educacion a distancia de la Comunidad Valenciana
		40	Cebem Formacion Profesional SL
		41	University of Cordoba
		42	IES Ricardo Mella
12	Austri	43	College Teacher Education
13	Lituani	44	University of Klaipeda
14	Portugali	45	University of Lisbona
15	Francë	46	University Cote D'azur, Nice

Për vitin akademik 2019-2020 janë realizuar mobilitetet për stafin akademik.

- mobilitete incoming (hyrëse) nga universitetet partnere.
- mobilitete outgoing (dalëse) nga UE drejt universiteteve partnere.
- Janë ekzekutuar 3 mobilitete Erasmus+ (bashkëngjitur tabela)

Nr.	Emër Mbiemër	Fakulteti	Universiteti pritës
1	Arjan Hyka	FSHE	University of Klaipeda, Lituani
2	Edmond Biçoku	FSHE	University of Klaipeda, Lituani
3	Lindita Durmishi	FSHE	South-West University "Neofit Rilski", Bullgari

- Janë ekzekutuar 3 mobilitete Erasmus+ (bashkëngjitur tabela)

Nr.	Emër Mbiemër	Universiteti dërgues	Fakulteti pritës
1	Aleksandar Popkochev	South- West University "Neofit Rilski", Bullgari	FSHE Rektorat
2	Stanislav Grozdanov	South- est University "Neofit Rilski", Bullgari	FSHE Rektorat
3	Galia Nedeltcheva	Sofia University "Kliment Ohridski", Bullgari	FSHN

Veprimtari të tjera në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar:

- a. Pjesëmarrje në aktivitetin "Promovimi në vendet e treta të kushteve të pranimit dhe qëndrimit në Rumani" në muajin Shkurt, Ambasada rumune, Tiranë;
- b. Pjesëmarrje në takime online;
- c. Përgatitja e pyetësorëve *Quality Questions* të dërguar nga universitetet partnere për t'u informuar për të dhënat e përgjithshme për Universitetin e Elbasanit "Aleksandër



Xhuvani" për vitin akademik 2019-2020. Këto pyetësorë na kanë ardhur nga universitetet partnere me të cilët kemi bashkëpunime, por edhe nga universitete të tjera me të cilët kemi shkëmbyer kërkesa për të lidhur marrëveshje të reja.

- d. Përgatitja e *Inter-Institutional Agreement* të dërguar nga universitetet partnere për vitin akademik 2019-2020. Inter-Institutional Agreement na kanë ardhur nga universitetet partnere me të cilët kemi bashkëpunime, por edhe nga universitete të tjera me të cilët kemi shkëmbyer kërkesa për të lidhur marrëveshje të reja.

Konfirmime Diplomimi për ish studentë të UE-së

Gjatë vitit akademik 2019-2020 janë bërë 34 konfirmime diplomash, lista notash dhe plotësime formularësh të studentëve të cilët kanë mbaruar studimet në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Këto konfirmime janë bërë nga kompani, universitete dhe institucione të shteteve të huaja, ku studentët kanë aplikuar për arsye nga më të ndryshmet, si: njohjen e diplomave, regjistrime për studime, regjistrime punësimi etj.

Më poshtë gjeni tabelën me emrat e studentëve të cilëve u janë bërë konfirmimet:

Nr	Emër	Mbiemër	Data	Shteti
1	Esmeralda	Rama (Gjata)		New York, USA
2	Ana	Kukli	18.10.2019	HireRight, USA
3	Dhoksiana	Morava (Zguro)	23.10.2019	HireRight, London, UK
4	Aurora	Sema (Dulla)	24.10.2019	London, UK
5	Elsa	Guzi (Kishta)	07.11.2019	iCOVER, USA
6	Lindita	Capollari (Ziko)	13.11.2019	University of Toronto, Kanada
7	Majlinda	Mema (Taragjini)	20.11.2019	NetForce Global LLC, USA
8	Ermira	Hasa (Yzeiraj)	20.11.2019	InteliMaster Ltd, USA
9	Elona	Nikolli (Deda)	02.12.2019	Elona Nikolli (Deda), Via email
10	Stela	Zyma (Peni)	13.12.2019	University of Toronto, Kanada
11	Matilda	Rina (Ashiku)	13.12.2019	NetForce Global LLC, USA
12	Arjan	Manushi	13.12.2019	iCOVER, USA
13	Raimonda	Suli	17.01.2020	HireRight, London, UK
14	Artur	Marku	25.02.2020	UNHCR-Albania
15	Armand	Haqaqi	25.02.2020	Toronto, Kanada
16	Amarilda	Radovicka	25.02.2020	Toronto, Kanada
17	Raimonda	Suli	17.01.2020	HireRight, Tallin, Estoni
18	Alda	Beqiri	23.01.2020	New York, USA
19	Aida	Sina	03.02.2020	HireRight, London, UK
20	Adenisa	Sula	03.02.2020	DataFlow Group
21	Ana	Kokonozi (Kadillari)	08.05.2020	Qualification Check Ltd
22	Klementina	Mjeshtri	13.05.2020	HireRight, London, UK
23	Anxhela	Kabashi	28.05.2020	Span Tran, The Evaluation Company, Houston, USA
24	Armida	Tola (Priftani)	26.05.2020	Verification Team @Neeyamo
25	Erjana	Kurti	05.06.2020	Span Tran, The Evaluation Company, Houston, USA
26	Entela	Elezi	25.06.2020	New York, USA
27	Amarilda	Musaku	02.07.2020	The Qualification Check Team, UK
28	Erina	Zavalina	09.07.2020	World Education Services, NY, USA
29	Enea	Hila (Vako)	15.07.2020	iCOVER, USA



30	Denisa	Hila (Vako)	02.09.2020	iCOVER, USA
31	Vilma	Kafexhiu	15.09.2020	Florida, USA
32	Aleksandra	Toli/Bezhani	23.09.2020	InteliMaster ltd, USA
33	Arta	Bendaj	29.09.2020	Span Tran, The Evaluation Company, Houston, USA
34	Barije	Nela	02.10.2020	Mbretëri e Bashkuar

Tabela e marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara në vijimësi, të rinovuara ose proces rinovimi

Nr.	Institucioni
1	Forumi i Gruas Elbasan
2	Drejtorja Rajonale e Shëndetit Elbasan
3	Drejtorja Arsimore Rajonale Elbasan
4	Këshilli i Qarkut Elbasan
5	Bashkia Elbasan
6	Zyra e Shërbimit të Provës Elbasan
7	Prefekti i Qarkut Elbasan
8	Bashkia Cerrik
9	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, krijimi i RASH
10	Universiteti i Tiranës
11	Universiteti Politeknik i Tiranës
12	Universiteti Bujqësor i Tiranës
13	Universitetit i Arteve
14	Universiteti i Sporteve të Tiranës
15	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
16	Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
17	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
18	Universiteti "Eqerem Çabej" Gjirokastr
19	Universiteti "Fan S.Noli" Korçë
20	Kirklareli University
21	Autoriteti i Konkurrencës
22	Academic Spin Off "Polyphenosrl"
23	John Paul II Catholic University of Lublin
24	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
25	Kryqi i Kuq Shqiptar
26	Zurich University of Teacher Education
27	Universiteti i Mjekësisë Tiranë
28	University of Florence
29	Universiteti European i Tiranës
30	St. Cyril and St. Methodius University of VelikoTarnovo
31	ProtikInovation Center
32	University of Oviedo
33	University of Bari "Aldo Moro"



Tabela e marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalëshe të nënshkruara

Nr.	Institucioni
1	Instituti "Junus Emre"
2	Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës
3	Albania University
4	Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan (sot Zyra)
5	Drejtoria Rajonale e Shëndetit Elbasan
6	Kuvendi i Shqipërisë
7	Save the Children
8	Zyra e Shërbimit të Provës Elbasan
9	Travelbest
10	Albanian Center for Quality Journalism
11	Unione Italiana Sport per Tutti
12	U.I.S.P Comitato Territoriale Di Bari

Veprimtari të tjera për vitin akademik 2019-2020.

Gjatë këtij viti veprimtaria është fokusuar në organizimin dhe bashkëorganizimin e aktiviteteve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare ku UE ka marrë pjesë sipas metodologjisë së pjesëmarrjes të imponuar nga situata e pandemisë së COVID-19.

- 17 Tetor 2019, Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në programin kombëtar “Debating Economics”, si një program kombëtar afatgjatë, që do të zbatohet nga Junior Achievement of Albania, me mbështetjen financiare të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim AADF, në 80 shkolla të mesme të përgjithshme dhe 12 universitete publike dhe private në të gjithë vendin. Në vitin e tij të parë, programi mbështetet edhe nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.
- 22-23 Tetor 2019, Regional Cluster Meeting, Capacity Building in Higher Education projekts impact in the Western Balkans, Durrës, Shqipëri, ku janë prezantuar projektet për ngritjen e kapaciteteve, T@SK, e_viva dhe TEAVET.
- 24-25 Tetor 2019, Erasmus+ Contact Seminar with the Western Balkans, Tiranë, Shqipëri, ku IRO i Universitetit të Elbasanit iu bashkua 250 përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë nga shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, për të diskutuar dhe krijuar partneritete në mënyrë që të rritet sasia dhe cilësia e aplikimeve të përbashkëta në kuadrin e Erasmus+.
- 8 Dhjetor 2019, UE merr pjesë në 1 st Albania Youth Conference for Future, Elbasan, Shqipëri.
- 17 Dhjetor 2019, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" merr pjesë në info day Erasmus+, organizuar nga Zyra e Erasmus+ në Shqipëri. Synimi i takimit ishte prezantimi i rasteve të suksesit të bashkëpunimit për mobilitetet në UE.
- 25 Qershor 2020, UE dhe Zyra Kombëtare Erasmus+ në Shqipëri, zhvilloi takimin virtual monitorues, mbi Programin "Shkëmbime Studentore dhe Stafi (ICM), Erasmus+", me Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (UE).

c) Informacion mbi kërkimin shkencor në UE ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:

- i) Politikat e kërkimit shkencor;
- ii) Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;
- iii) Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;
- iv) Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.

i) Politikat e kërkimit shkencor.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, krahas misionit të tij të parë, atë të edukimit, përpiqet të realizojë më sukses edhe dy misionet e tjera: *kërkimin shkencor* dhe misionin e tretë tredimensional atë të *bashkëpunimit* me sektorin publik e privat të rajonit përmes transferës së teknologjisë së informacionit, angazhimit social dhe edukimit të vazhdueshëm.

Në zbatim të ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, kërkimi shkencor bazohet, organizohet e zhvillohet mbështetur në politikat mbi arsimin e lartë të ndjekura nga MASR, i orientuar nga reformat në vend, nga tregu i punës si dhe nga standardet e reja të integritimit evropian.

Kërkimi shkencor, si tërësia e veprimtarive që krijojnë dije, përbën një të drejtë të personelit akademik që ushtrohet në kushtet e lirisë akademike, e cila garanton pavarësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Reformimi dhe riorganizimi i kërkimit shkencor në UE konceptohet dhe vlerësohet si faktor themelor për reformimin e veprimtarisë akademike, kërkimore e shkencore dhe njëherazi përcaktues për vendosjen e standardeve evropiane.

Kërkimi shkencor është një nga misionet kryesore të UE-së dhe së bashku me transferimin e teknologjive dhe inovacionin, vlerësohen si faktorë themelorë për një ekonomi të orientuar nga dijet.

Njësitë kryesore dhe bazë që janë pjesë përbërëse të UE-së, sipas natyrës dhe objektivave specifike të institucionit, kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore bazë, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese. Universiteti i Elbasanit është gjithmonë aktiv në politikën e tij të jashtme, duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha universitetet shqiptare, por edhe me universitete të tjera të huaja përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalëshe me to, por gjithashtu edhe përmes bashkëpunimit në kuadër të projekteve të ndryshme.

Prioritet i Universitetit të Elbasanit është përfshirja në programet evropiane dhe bashkëpunimi në programe studimesh të përbashkëta me universitete partnere, si një hap i mëtejshëm në përqafimin e standardeve të kërkuara etj.

Një nga elementët e rëndësishëm të kërkimit shkencor lidhet me shkrimin dhe aplikimin në projekte për ngritjen e kapaciteteve, me financim të huaj. Në këtë kuadër, u aplikuan projektpropozime, për vitin 2020, si në vijim:



Nr.	Titulli i projektit	Akronimi	Lideri i projektit
1	"Academic Internationalization for Strengthening Economic Extroversion -	AISEE"	Aristotle University of Thessaloniki -AUTH
2	Implementation of the Advanced Practice Nurse's programme and scope of practices in Albania based on the international good practice and Hungarian and Polish experiences	ALBAPN	ECSI TUDOMANYEGYETEM - UNIVERSITY OF PECS
3	Integrating Design Thinking Approach in Bridging Academia and Industry in Kosovo and Albania	ACASOL	European University of Tirana
4	Digital Solution Technology	DiSoTec	University "Kadri Zeka"
5	Entrepreneurial skills for a modern education in Albania	EntrAL	University of Turku, UTU
6	Higher Education Resources and Environment for Active Learning with Innovative Technology	HE REALITY	STATE UNIVERSITY OF LIBRARY STUDIES AND INFORMATION TECHNOLOGIES - SULSIT
7	Introducing Dual Education in Western Balkans -	IDEATION	Universiteti i Elbasanit
8	Laboratory of Innovation, Business development and Research in Albania and Kosovo	LIBRAK	SCUOLA SUPERIORE PER MEDIATORI LINGUISTICI CAROLINA ALBASIO
9	Securing Digital Environment through Raising Awareness and Capacity Building	SDE-RACB	LUARASI University
10	Strengthening Academic Initiatives supporting student wellbeing in Albanian HEIs through Organizational Multifunctional Environment"	SAIS-HOME	Mediterranean University of Albania
11	Steering Transition and Advancement of Tertiary Underrepresented Students	STATUS	PRESCHOOL TEACHER TRAINING COLLEGE MIHAÏLO PALOV VRSAC
12	MSc course in STEAM education	STEAMedu	University of Mostar
13	Ailor-made Enhancement and Application of Meaningful Internationalisation Policies and Practices at Western Balkan Universities	TEAM WEB	UNIVERSITY OF NOVI SAD
14	Supporting and fostering the Adoption of UNiversity Internationalization Tools for Eusair Development	SEA-UNITED	UNIADRION
15	Acquis communautaire: hardest burden for integration of Albania	ACHBIA	Universiteti i Elbasanit

Sipas rezultateve, në momentin e hartimit të kësaj analize, rezultojnë fitues projektet e mëposhtme:

Nr.	Titulli i projektit	Akronimi	Lideri i projektit
1.	Entrepreneurial skills for a modern education in Albania	EntrAL	University of Turku, UTU
2.	Acquis communautaire: hardest burden for integration of Albania	ACHBIA	Universiteti i Elbasanit



Mbi projektet ku UE është partner: (vijimësi)

Projektet ERASMUS+ Capacity Building program of the European Union, të cilat janë duke u implementuar aktualisht në UE janë: REBUS, TEAVET, TASK.

Projekti REBUS

“Integrimi dhe vlefshmëria e aftësive praktike të sipërmarrjes në inxhinieri dhe studime të TIK”

“Integrating and validating practical entrepreneurship skills in engineering and ICT studies”

- **Koordinatori i projektit:**

Universiteti i Sarajevës, Fakulteti i Inxhinierisë

- **Partnerët e Projektit:**

1. Bi Hdie Berater, Austria
2. University FH Joanneum Gesellschaft M.B.H, Austria
3. Blended learning institutions' cooperative, Germany
4. University of Duisburg Essen, Germany
5. University of Palermo, Italy
6. University of East Sarajevo, Faculty of Mechanical Engineering, BiH
7. European University of Tirana, Albania
8. University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani", Albania
9. Universum College Prishtinë, Kosovo
10. “KadriZeka” University in Gjiilan, Kosovo
11. Mechanical Engineering Faculty University of Montenegro, MNE
12. Volga State University of Technology, Russia
13. Siberian State University of Telecommunications and Informatics, Russia

Projekti TEAVET

“Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të VET (arsim dhe trajnim profesional) në Shqipëri”.

“Developing teacher competencies for a comprehensive vet system in Albania”.

- Partnerët:
1. Universiteti i Leon, Spanjë (Partneri kryesor);
 2. Kolegji Universitar “Pavarësia Vlorë” (bashkëpartner kryesor);
 3. Universiteti Turku, Finlandë;
 4. Universiteti Danub Krems, Austri;
 5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 6. Universiteti i Vlorës;
 7. Universiteti i Durrësit;
 8. Universiteti i Gjirokastrës;
 9. Universiteti i Korçës;
 10. Universiteti i Shkodrës;
 11. Universiteti i Elbasanit.



Projekti TASK

“Towards increased Awareness, responsibility and shared quality in Social Work”

“Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësisë dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale” .

Koordinator i projektit: Universiteti i Fierenze, Departamenti i shkencave politike dhe sociale.

Partnerët:

1. Universidad Complutense de Madrid
2. Instituto Universitario De Lisboa
3. Universiteti i Tiranës
4. Universiteti i Shkodrës
1.1. Rektorati i Universitetit të Elbasanit me Rektor, Zv/rektor dhe Administrator përbëhet nga 88 personel ndihmësakademik me karakter administrativ dhe personel administrativ të organizuar në drejtori/njësi dhe ku çdo drejtori ka në përbërje sektorë, si më poshtë:

- | | |
|--|--|
| 1.1.1. Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë | - Sektori i burimeve njerëzore |
| - Sektori i koordinimit | - Sektori i protokoll arkiv |
| - Sektori i marrëdhënieve me Jashtë | 1.1.5. Drejtoria Ekonomike |
| 1.1.2. Drejtoria e Standardeve dhe Kurrikulave | - Sektori i menaxhimit të buxhetit |
| - Sektori i standardeve dhe Kurrikulave | - Sektori i shërbimit financiar |
| - Sektori i IT-së | 1.1.6. Drejtoria e Prokurimeve dhe Shërbimeve |
| 1.1.3. Drejtoria Juridike, Këshillimit të karrierës dhe ALUMNI | - Sektori i prokurimeve |
| - Sektori juridik | - Sektori i shërbimeve |
| - Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI | 1.1.7. Biblioteka |
| 1.1.4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore protokoll arkiv | - Sektori i klasifikimit |
| | - Sektori i arkivit |
| | 1.1.8. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë |
| | 1.1.9. Auditi i brendshëm |

1.2. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka në përbërjen e tij 5 (pesë) fakultete të ndara në departamente/qendra kërkimore. Struktura organizative ka në përbërje personel akademik, ndihmësakademik me karakter mësimor/administrativ dhe personel administrativ. Fakultetet e UE-së janë të organizuar në departamente dhe kanë në përbërje krahas personelit akademik edhe personel ndihmës akademik/laborantë, të cilët ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies. Pjesë përbërëse e strukturës së Fakultetit janë edhe sekretarët mësimorë. Njësitë bazë të secilit fakultet:



1.2.1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës:

- Departamenti i Matematikës
- Departamenti i Informatikës
- Departamenti i Fizikës
- Departamenti i Kimisë
- Departamenti i Biologjisë
- Qendra e Zhvillimit Mjedisor

1.2.2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike:

- Departamenti i Infermieristikës
- Departamenti i Lëndëve Paraklinike
- Departamenti i Lëndëve Klinike
- Departamenti i specialiteteve tekniko mjekësore

1.2.3. Fakulteti i Shkencave të Edukimit:

- Departamenti i Psikologjisë
- Departamenti i Shkencave Sociale
- Departamenti i Edukimit Qytetar
- Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve
- Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies
- Qendra për Kërkim dhe Zhvillim në Edukim

1.2.4. Fakulteti i Shkencave Humane:

- Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë
- Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë
- Departamenti i Gjuhësisë
- Departamenti i Gjuhës Angleze dhe Gjermane
- Departamenti i Gjuhës Italiane dhe Frënge
- Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike
- Qendra/Laboratori i medias


1.2.5. Fakulteti Ekonomik:

- Departamenti i Administrim Biznesit
- Departamenti i Ekonomiksit
- Departamenti i Marketing Inxhinierisë
- Departamenti i Financë Kontabilitetit
- Departamenti i së Drejtës
- Qendra për Kërkime dhe Zhvillime Ekonomike

1.3. Autoritetet drejtuese të Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani” janë:

- Rektori
- Administratori
- Drejtues të njësive kryesore – Dekan fakulteti
- Drejtues të njësive: Drejtues departamenti, Drejtues drejtorie.

Fakultetet në vite



Numri i punonjësve në UE për vitin 2019 u parashikua rreth 389 personel akademik dhe jo akademik (ndihmës akademik me karakter mësimor/administrativ dhe personel administrativ).





Për periudhën janar–dhjetor të vitit 2019 mesatarisht kanë punuar 334 punonjës nga të cilët 65% personel akademik dhe 35 % personel ndihmësakademik. Sipas raportimeve statistikore paraqiten të dhëna si më poshtë:

Numri mesatar i punonjësve

Viti 2019

Emertimi	Gjithsej	Meshkuj	Femra	% që zënë femrat
Gjithsej	334	129	205	61%
Drejtues	52	26	26	50%
Specialistë	256	92	164	64%
Nëpunës të thjeshtë	3	3	-	0%
Punëtorë	23	8	15	65%

Për vitin akademik 2018 – 2019 nga personeli akademik mesatarisht 76 % janë me tituj e grada dhe 24 % pa tituj e grada. Raporti që zë personeli akademik me tituj e grada për këtë periudhë është më i ulët nga



parashikimi për vitin 2019. Kjo për arsye të plotësimit të moshës së pensionit të personelit të kualifikuar.

Numri i punonjësve në UE për vitin 2020 u parashikua rreth 389 personel akademik dhe jo



akademik (ndihmës akademikë me karakter mësimor/administrativ dhe personel administrativ).

Për periudhën Janar–Tetor të vitit 2020 mesatarisht kanë punuar mesatarisht 337 punonjës nga të cilët 66% personel akademik dhe 34 % personel ndihmësakademik. Sipas raportimeve statistikore paraqiten të dhëna si më poshtë:

Numri mesatar i punonjësve 10 mujori Viti 2020

Emertimi	Gjithsej	Meshkuj	Femra	% që zënë femrat
Gjithsej	337	127	210	62%
Drejtues	57	29	28	49%
Specialistë	256	91	165	64%
Nëpunës të thjeshtë	1	-	1	100%
Punëtorë	23	7	16	70%

Për vitin akademik 2019 –2020 për periudhën Janar–Tetor 2020 nga personeli akademik mesatarisht 79 % janë me tituj e grada dhe 21 % pa tituj e grada. Raporti që zë personeli akademik me tituj e grada



për këtë periudhë është mesatarisht më i lartë nga parashikimi

për vitin 2020. Kjo për arsye të kualifikimit të punonjësve akademikë dhe plotësimit të punonjësve me të personel të kualifikuar.



2. Të dhëna të përgjithshme mbi: Ciklet e studimit, numri i studentëve, ngarkesa mësimore, shtrirja dhe mjediset

➤ Ciklet e studimit, numri i studentëve.

- Ciklet e studimit


UE për vitin akademik 2018–2019 kishte këto nivele e programe studimi me kohë të plotë:

- Cikli i parë i studimeve dhe dyvjeçare me 43 programe studimi.
- Cikli i dytë i studimeve me 51 programe studimi:
 - o Master profesional me 34 programe studimi,
 - o Master i shkencave me 17 programe studimi.
- Ciklin i tretë me 2 programe studimi.
 - o Doktoratur: 2 programe studimi

Programe studimi në vitet 2005 - 2020													
Nr	Emërtimi	Vitet											
		2005 - 2006	2008 - 2009	2010 - 2011	2011 - 2012	2012 - 2013	2013 - 2014	2014 - 2015	2015 - 2016	2016 - 2017	2017 - 2018	2018 - 2019	2019 - 2020
1	Koha e plotë - Bachelor	20	20	26	28	31	38	38	38	38	38	38	38
2	Koha e plotë - 2 vjeçare	0	0	0	1	1	1	1	1	1	1	5	7
3	Koha pjesëshme - Bachelor	11	11	14	14	14	15	15	15	15	0	0	0
4	Koha e plotë - MP	0	9	14	21	23	27	25	29	29	29	34	34
5	Koha e pjesëshme - MP	0	0	0	3	9	14	14	0	0	0	0	0
6	Koha e plotë - MSH	0	0	4	9	12	17	17	17	17	17	17	17
7	Koha e plotë - Dr	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2

UE për vitin akademik 2019–2020 kishte këto nivele e programe studimi me kohë të plotë:

- Cikli i parë i studimeve dhe programe dyvjeçare me 45 programe studimi.
- Cikli i dytë i studimeve me 51 programe studimi:
 - o Master profesional me 34 programe studimi,
 - o Master i shkencave me 17 programe studimi.
- Ciklin i tretë me 2 programe studimi.
 - o Doktoraturë: 2 programe studimi



- Numri i studentëve

Në UE për vitin akademik 2018–2019 kanë studiuar në të gjithë nivelet e studimeve **13,160** studentë:

- ◇ Në Ciklin e parë të studimit Bachelor dhe programe profesionale dyvjeçare parashikohet të ketë **10,058** studentë.
- ◇ Në Ciklin e dytë të studimit parashikohet të ketë **3,085** studentë nga të cilët:
 - Master profesional do të ketë **1,818** studentë,
 - Master i shkencave do të ketë **1,267** studentë,
- ◇ Në Ciklin e tretë të studimit në doktoraturë parashikohet të ketë **17** studentë të padiplomuar.


Studentët sipas ndryshimeve në sistemet dhe ciklet e shkollimit													
Sistemi shkollimit	vitet												
	1999 - 2000	2003 - 2004	2006 - 2007	2008 - 2009	2011 - 2012	2012 - 2013	2013 - 2014	2014 - 2015	2015 - 2016	2016 - 2017	2017- 2018	2018- 2019	2019- 2020
Cikli i parë : Koha e plotë	1,431	3,963	6,705	5,776	6,640	7,181	7843	7716	8979	8976	8030	10058	10,877
Korrespondenca	1,500	2,350	664	279	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Koha pjesshme	0	1,070	4,352	2,135	3,768	4,188	3540	2334	1631	843	268	0	0
Cikli i dytë: MP koha plotë				310	752	1,507	1683	1929	2350	2002	1455	1818	2,648
MP koha pjesshme					82	337	616	350	0	0	0	0	0
MSH koha e plotë					333	576	739	692	861	1016	1188	1267	1,292
Doktoraturë					0	11	29	29	29	29	19	17	13
Totali i studentëve	2,931	7,383	11,721	8,500	11,575	13,800	14,450	13,050	13,850	12,866	10,960	13,160	14,830

Në UE studiojnë për vitin akademik 2019–2020 në të gjithë nivelet e studimeve **14,830** studentë, duke përfshirë, studentët në vite që nuk janë diplomuar, ose rifillojnë studimet:

- ◇ Në Ciklin e parë studiojnë **10,877** studentë.
 - Në Bachelor studiojnë 9,977 studentë
 - Në programet me karakter profesional 2-vjeçare studiojnë 900 studentë
- ◇ Në Ciklin e dytë studiojnë **3,940** studentë nga të cilët:
 - Master profesional studiojnë **2,648** studentë,
 - Master i shkencave studiojnë **1,292** studentë,
- ◇ Në Ciklin e tretë të studimit në doktoraturë studiojnë **13** studentë të padiplomuar.



Numri i studentëve sipas hapjes së sistemeve dhe cikleve të studimit



➤ Ngarkesa mësimore

Në vitin akademik 2018–2019 janë realizuar gjithsej 371,701 orë mësimore nga të cilat:

- Nga punonjësit efektiv janë realizuar 308,987 orë mësimore,
- Nga punonjësit e jashtëm janë realizuar 48,714 orë mësimore

Në vitin akademik 2018–2019 janë realizuar 137,968 orë mësimore mbi të cilat llogaritet pagesa e tyre, sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”. Nga orët e përllogaritura janë realizuar nga personeli akademik efektivë 89,254 orë mësimore të pagueshme, nga të cilat orë mësimore të normuara 77,747 orë mësimore dhe jashtë auditori të pagueshme 11,507 orë mësimore. Personeli akademik efektiv ka mbuluar, sipas normës së ngarkesës 32,552 orë mësimore, ndërsa orët mbi normë në auditor janë 45,195 orë mësimore dhe jashtë auditori 11,507 orë mësimore, gjithsej 56,702 orë mësimore të pagueshme. Personelit akademik efektiv me Vendim të Bordit të Administrimit nr. 54, datë 20.11.2019 “Për pagesën e orëve suplementare të vitit akademik 2018-2019”, janë paguar 50,876 orë mësimore, për secilin deri në 300 orë mësimore në auditor e jashtë auditori, pasi janë plotësuar minimumi 1,536 orë pune vjetore, ose gjithësej 405,750 orë pune. Nga ky staf akademik janë kryer 64,204 orë për kërkim dhe zhvillim dhe 32,559 orë mbështetëse për institucionin. Personeli akademik i ftuar (të jashtëm) ka realizuar 50,013 orë mësimore, nga të cilat janë paguar deri më 31.12.2019 gjithsej 44,207 orë mësimore, ndërsa janë paguar deri më 30.11.2020 gjithsej 45,457 orë mësimore

Në vitin akademik 2019–2020 janë realizuar 131,403 orë mësimore mbi të cilat llogaritet pagesa e tyre, sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”. Nga orët e përllogaritura janë realizuar nga personeli akademik efektivë 92,656 orë mësimore të pagueshme, nga të cilat orë mësimore të normuara 81,688 orë mësimore dhe jashtë auditori të pagueshme 10,968 orë mësimore. Personeli akademik efektiv ka mbuluar, sipas normës së ngarkesës 32,113 orë mësimore, ndërsa orët mbi normë në auditor janë 49,575 orë mësimore dhe jashtë auditori 10,968 orë mësimore, gjithsej 60,543 orë mësimore të pagueshme. Personelit akademik efektiv me Vendim të Bordit të Administrimit nr. 22, datë 26.09.2020 “Për pagesën e orëve suplementra të vitit akademik 2019-2020”, janë paguar 60,543 orë

mësimore, për secilin deri në 300 orë mësimore në auditor e jashtë auditori, pasi janë plotësuar minimumi 1,536 orë pune vjetore, ose gjithësej 423,737 orë pune. Nga ky staf akademik janë kryer 53,086 orë për kërkim dhe zhvillim dhe 36,401 orë mbështetëse për institucionin. Personeli akademik i ftuar (të jashtëm) ka realizuar 38,747 orë mësimore, nga të cilat janë paguar deri më 30.11.2020 gjithësej 36,810 orë mësimore.



NUMRI I STUDENTEVE DHE NGARKESA MËSIMORE E REALIZUAR - "VITI 2018 - 2019"

Nr	FAKULT ETI	Nr. Student koha normale	Nr. P/Akademik			Mësimdhënie e pagueshme				Orë mësimore gjithsej			Mbulimi me personel akademik						
						E normuar		Jashtë audit. Brend	Gjithsej				Të brendshëm			Norma Jashtë m	Pagesa		
			Brend.	Jash t.	Gjit hsej	Brend.	Jasht.			Norma	Mbi normë	Limiti deri 300 orë	Brend.	Jasht.	Shuma				
1	FE	1,762	39	76	115	14,846	8,078	3,145	26,069	55,097	8,078	63,175	5,845	12,146	11,700	9,120	10,442	6,904	17,346
2	FSHMT	2,396	32	132	164	12,491	13,995	1,485	27,971	52,576	13,995	66,571	4,955	9,021	9,600	15,840	8,130	12,742	20,872
3	FSHE	2,131	45	56	101	15,851	6,429	3,280	25,560	66,801	6,429	73,230	6,555	12,576	13,500	6,720	11,201	5,753	16,954
4	FSHH	1,049	58	118	176	18,287	11,744	1,247	31,278	69,549	11,744	81,293	8,948	10,587	17,400	14,160	10,356	10,998	21,354
5	FSHN	972	43	79	122	16,272	8,468	2,350	27,090	64,964	8,468	73,432	6,250	12,372	12,900	9,480	10,747	7,810	18,557
	TOTALI	8,310	217	461	678	77,747	48,714	11,507	137,968	308,987	48,714	357,701	32,552	56,702	65,100	55,320	50,876	44,207	95,083

Norma mesatare e ngarkesës	150	orë mësimore	Orë të pa mbuluara nga personeli efektiv	112,022	orë mësimore
Norma e ngarkesës të jashtëm	106	orë mësimore	Orë të pagueshme nga personeli efektiv	68,209	orë mësimore
% që mbulon stafi efektiv mbi normë	139	%	Numri i personelit efektiv	518	Punonjës
% që mbulon stafi efektiv gjithsej	56	%	Numri i personelit jo efektiv	461	Punonjës
% që mbulon stafi jashtëm	35	%	Numri i personelit gjithsej	979	Punonjës
			Numri i punonjësve efektiv gjithsej (normën mesatare)	920	Punonjës

NUMRI I STUDENTEVE DHE NGARKESA MËSIMORE - REALIZIMI - "VITI 2019 - 2020"

Nr	FAKULT ETI	Nr. Student koha normale	Nr. P/Akademik		Mësimdhënie e pagueshme					Orë mësimore gjithsej			Mbulimi me personel akademik						
					E normuar		Jashtë audit. Brend	Gjithsej	Të brendshëm				Norma Jashtë m	Pagesa					
			Brend.	Jash t.	Gjit hsej	Brend.			Jasht.	Brend.	Jasht.	Gjithsej		Norma	Mbi normë	Limiti deri 300 orë	Brend.	Jasht.	Gjithse j
			1	FE	1,255	39	74	113	15,048	7,382	3,070	25,500	57,953	7,382	65,335	5,713	12,405	11,700	8,880
2	FSHMT	2,265	37	135	172	14,513	10,825	1,846	27,184	63,777	10,825	74,602	6,087	10,272	11,100	16,200	9,337	10,394	19,731
3	FSHE	1,705	44	49	93	16,325	5,728	2,071	24,124	65,398	5,728	71,126	5,698	12,698	13,200	5,880	11,736	5,197	16,933
4	FSHH	665	60	64	124	19,150	6,113	1,611	26,874	78,264	6,113	84,377	8,642	12,119	18,000	7,680	11,706	5,791	17,497
5	FSHN	977	42	77	119	16,652	8,699	2,370	27,721	66,555	8,699	75,254	5,973	13,049	12,600	9,240	11,064	8,307	19,371
	TOTALI	6,867	222	399	621	81,688	38,747	10,968	131,403	331,947	38,747	370,694	32,113	60,543	66,600	47,880	54,765	36,810	91,575

Norma mesatare e ngarkesës efektiv	145	orë mësimore	Orë të pa mbuluara nga personeli efektiv	108,423	orë mësimore
Norma e ngarkesës të jashtëm	120	orë mësimore	Orë të pagueshme nga personeli efektiv	71,511	orë mësimore
% që mbulon stafi efektiv mbi normë	179	%	Numri i personelit efektiv	565	Punonjës
% që mbulon stafi efektiv gjithsej	69	%	Numri i personelit jo efektiv	323	Punonjës
% që mbulon stafi jashtëm	31	%	Numri i personelit gjithsej	888	Punonjës
			Numri i punonjësve efektiv gjithsej (normën mesatare)	908	Punonjës



NGARKESA MËSIMORE E PUNONJËSVE AKADEMIKË TË JASHTËM - "REALIZUAR VITI AKADEMIK 2018 - 2019"

Nr	FAKULTETI	Nr. P/Akademik jashtëm		Orë mësimore në auditor									Nga këto		
		Me vendim	Fakt	Bachelor			Msc			Mp			Shuma	Të paguara brenda normës	Mbi normë
				Leksione	Sem. Ushtr. Lab.	Totali	Leksione	Sem. Ushtr. Lab.	Totali	Leksione	Sem. Ushtr. Lab.	Totali			
1	FE	95	60	1289	5399	6688	907	834	1741	93	246	339	8768	7564	1204
2	FSHMT	148	119	2484	9433	11917	463	456	919	884	569	1453	14289	13024	1265
3	FSHE	63	54	1062	3097	4159	190	517	707	342	1221	1563	6429	5746	683
4	FSHH	126	113	2210	8124	10334	323	315	638	323	674	997	11969	11223	746
5	FSHN	82	79	1035	5402	6437	185	170	355	824	942	1766	8558	7900	658
	TOTALI	514	425	8080	31455	39535	2068	2292	4360	2466	3652	6118	50013	45457	4556

NGARKESA MËSIMORE E PUNONJËSVE AKADEMIKË TË JASHTËM - "REALIZUAR VITI AKADEMIK 2019 - 2020"

Nr	FAKULTETI	Nr. P/Akademik jashtëm		Orë mësimore në auditor									Nga këto		
		Me vendim	Fakt	Bachelor			Msc			Mp			Shuma	Të paguara brenda normës	Mbi normë
				Leksione	Sem. Ushtr. Lab.	Totali	Leksione	Sem. Ushtr. Lab.	Totali	Leksione	Sem. Ushtr. Lab.	Totali			
1	FE	96	74	653	4713	5366	879	654	1533	153	330	483	7382	7121	261
2	FSHMT	142	135	2020	6108	8128	531	477	1008	1106	583	1689	10825	10394	431
3	FSHE	51	49	1031	3036	4067	157	313	470	109	1082	1191	5728	5197	531
4	FSHH	75	64	840	4208	5048	204	91	295	364	406	770	6113	5791	322
5	FSHN	81	77	878	5395	6273	120	195	315	936	1175	2111	8699	8307	392
	TOTALI	445	399	5422	23460	28882	1891	1730	3621	2668	3576	6244	38747	36810	1937



b) Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit.

1. P/Buxheti afatmesëm vitet 2021-2023

Hartimi i p/buxhetit të vitit 2021 është bazuar në projektet e paraqitura deri në momentin e hartimit të tij, në ecurinë e realizimit të pritshëm të buxhetit për vitin 2019 dhe në ndryshimet në: strukturën organizative dhe numrin e punonjësve, programet e studimit, numrit të studentëve të pritshëm, në nivelin e financimit nga Buxheti i Shtetit. Nga strukturat bazë të Universitetit janë paraqitur kërkesa për projektet afatmesme 2021 – 2023, si për procesin e veprimtarisë kryesore të këtyre njësive edhe për atë kërkimore e shkencore, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë.

Financimi i p/buxhetit për vitet 2021 – 2023 paraqitet si më poshtë:

PBA për vitet 2021 - 2023				
Nr	Emërtimi i projektit	2021 000/lekë	2022 000/lekë	2023 000/lekë
1	Grante dhe transfertat	1,134,749	1,000,636	969,013
2	Financime të huaja	15,435	7,142	6,665
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuara	240,000	241,000	257,000
TOTALI		1,390,184	1,248,778	1,232,677

Grante për vitin 2021 - 2023				
Nr	Emërtimi i projektit	2021 000/lekë	2022 000/lekë	2023 000/lekë
1	Grante për shpenzime korente dhe Transferta	832,865	859,696	888,073
2	Grante për investime	300,000	140,940	80,940
3	Kërkim shkencor	0	0	0
4	TVSH-projekte të huaja	1,884	0	0
TOTALI		1,134,749	1,000,636	969,013

Të ardhura të institucionit për vitin 2021 - 2023				
Nr	Emërtimi i projektit	2021 000/lekë	2022 000/lekë	2023 000/lekë
1	Fondet nga të ardhurat për shpenzime korente	88,650	94,529	93,922
2	Fonde nga të ardhurat për investime	89,559	33,770	103,547
3	Kostot Lokale për Projektet me Financim të Huaj	0	0	0
4	Fonde nga të ardhurat për projekte e k. shkencor	61,791	112,701	59,531
TOTALI		240,000	241,000	257,000

Tërësia e financimeve dhe përdorimi i tyre për mbarëvajtjen e aktivitetit të Universitetit përbën PBA – në e viteve 2021-2023.

Planifikimi në këto nivele do të mundësojë përballimin e shpenzimeve në rritje në disa zëra, si: energji, ujë, telefon; në shërbimet që dalin të detyruara, si p.sh. shpenzimet për rojet private,



shpenzimet për internetin si dhe shpenzime për mirëmbajtje. Vendosja e sistemit të ngrohjes qendrore në tërë godinat do të paraqesë nevojën për shpenzime për lëndë djegëse. Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga fakti i artikujve të vitit të kaluar, nga realizimi i pritshëm i këtij viti, si dhe nga kërkesat për disa lloj shpenzimesh.

Artikulli	Emertimi	Fakti i vitit 2019		I pritshmi i vitit 2020		Parashikimi për vitin 2021			Parashikimi 2022	Parashikimi 2023
		Buxheti	Nga te ardhurat	Buxheti	Nga te ardhurat	Limiti	Kerkesa	Nga te ardhurat	Kerkesa	Kerkesa
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
602.0	Materiale zyre dhe te pergjithshme	0	5,945	4,026	7,320	7,320	1,560	5,760	7,320	7,320
602.1	Materiale dhe sherbime speciale	0	1,245	0	11,300	10,460	8,180	2,280	9,060	9,060
602.2	Sherbime nga te trete	34,434	23,359	70,384	7,320	81,540	79,940	1,600	85,920	85,920
602.3	Shpenzime transporti	0	2,745	5,640	640	6,240	6,000	240	6,240	6,240
602.4	Shpenzime udhetimi	0	7,931	9,010	0	14,500	13,500	1,000	16,000	16,000
602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	0	9,701	6,036	8,904	14,440	14,200	240	14,400	14,400
602.6	Shpenzime per qiramarrje	0	3,237	3,480	0	3,480	3,000	480	3,480	3,480
602.9	Shpenzime te tjera operative	8,530	5,827	14,460	1,480	17,020	14,620	2,400	17,580	17,580
	Totali	42,964	59,991	113,036	36,964	155,000	141,000	14,000	160,000	160,000

- c) **Realizimi faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.**

1. Realizimi i buxhetit viti 2019

Për vitin 2019 buxheti i akorduar është në vlerën **1,048,744** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

BUXHETI viti 2019								
Nr	Fonde të hyra				Shpenzime			
	Emërtimi i programit	<i>Buxheti vjetor</i>	<i>Akorduar</i>	<i>në %</i>	Emërtimi i programit	<i>Çelur për përdorim</i>	<i>fakt</i>	<i>në %</i>
1	Grant konkurrues	0	0	0.00	Grant konkurrues	0	0	0.00
2	Grant kërkimi shkencor	14,850,000	6,850,000	46.13	Grant kërkimi shkencor	6,850,000	0	0.00
3	Buxhet -TVSH projekte	412,369	412,369	100.00	Buxhet -TVSH projekte	412,369	412,369	100.00
I	Buxheti i brendshëm	15,262,369	7,262,369	47.58	Buxheti i brendshëm	7,262,369	412,369	5.68
1	Grant mësimdhënie	698,140,068	698,140,068	100.00	Grant mësimdhënie	698,140,068	654,832,924	93.80
II	Grant	698,140,068	698,140,068	100.00	Grant	698,140,068	654,832,924	93.80
1	Të ardhurat e trashëguara viti 2018	161,495,940	161,495,940	100.00	Të ardhurat e trashëguara viti 2018	0	0	0.00
2	Të ardhura jashtë limiti viti 2019	200,000,000	168,460,555	84.23	Të ardhura	191,485,691	111,950,136	58.46
III	Të ardhura	361,495,940	329,956,495	91.28	Të ardhura	191,485,691	111,950,136	58.46
1	Projekti të huaja	25,821,573	13,384,720	51.84	Projekti të huaja	24,362,073	14,271,487	58.58
IV	Projekti të huaja	25,821,573	13,384,720	51.84	Projekti të huaja	24,362,073	14,271,487	58.58
	Totali	1,100,719,950	1,048,743,652	95.28	Totali	921,250,201	781,466,916	84.83

- Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) **7,262,369** lekë, ose 47.58 %
- Projekte të huaja **13,384,720**lekë, ose 51.84 %
- Grant mësimdhënie **698,140,068** lekë, ose 100.00 %
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) **329,956,495** lekë, ose 91.28 %

Ndarë në artikuj dhe sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë në pasqyrat: “BUXHETI viti 2019”, “TË ARDHURAT PËR VITIN 2019 - fakti”, “REALIZIMI I BUXHETIT PER VITIN 2019 – fakti”

1.1. Hyrjet e fondeve

Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2019 të ndara sipas financimeve kanë qenë: Granti konkurrues, TVSH për projekte, kërkimi shkencor – buxheti i brendshëm: financimi i tij është realizuar në vlerën 7,262 mijë lekë. Ky fond përbëhet:

- Për financimin e investimeve - Granti konkurrues 0 lekë.
- Për kërkimin shkencor nga Buxheti i Shtetit, financimi prej 6,850 mijë lekë.
- TVSH për projekte në vlerën 412 mijë lekë

Projektet e huaja: financimi i tyre është realizuar 51.84 % në vlerën 13,385 mijë lekë.

Grant mësimdhënie: financimi i tij është realizuar 100 % në vlerën 698,140mijë lekë.



Fonde të kushtëzuar – të ardhurat e UE - së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar 91.28 % në vlerën 329,956 mijë lekë. Këto të ardhura janë grumbulluar gjatë vitit deri në 31 dhjetor 2019 në vlerën 168,461 mijë lekë me realizim plani vjetor 84.23 %, ndërsa janë trashëguar nga viti 2018 të ardhura të grumbulluara të papërdorura në vlerën 161,495 mijë lekë. Vlera e trashëguar i përket planit të vitit 2018, pasi janë kryesisht tarifat e shkollimit të vitit akademik 2018-2019

TE ARDHURAT PER VITIN 2019 - fakti


Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	200,000,000	168,460,555	84.2
1	Qera	520,000	377,472	72.6
2	Bachelor e programe profesionale	74,768,000	62,721,866	83.9
3	M. Profesional	53,740,000	47,953,492	89.2
4	M. Shkencor	48,936,000	41,348,808	84.5
5	Doktoraturë	0	108,000	0.0
6	Libreza Diplloma etj.	4,961,000	4,171,005	84.1
7	Lëshim dokumenti	5,000,000	3,713,705	74.3
8	Taksë regjstrimi	5,036,000	5,272,000	104.7
9	Tarifa konkurrimi	500,000	415,000	83.0
10	Tjera - shërbime	1,539,000	1,747,000	113.5
11	Pjesm. konferenca	5,000,000	0	0.0
12	Sponsorizime	0	632,207	0.0
B	Të ardhura të trashguara	161,495,940	161,495,940	100.0
1	Trashguar nga 2018	161,495,940	161,495,940	100.0
Totali		361,495,940	329,956,495	91.3

Plani i grumbullimit të të ardhurave dhe fakti i realizimit të tyre për vitin 2019 u bazua në:

- programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor),
- programet e studimit të ciklit të dytë (MP e MSH),
- numrin e studentëve për çdo program studimi,
- nivelin e tarifave të vendosura me VBA për çdo program studimi, sipas tavaneve të vendosura me VKM-t për çdo rast.

Realizimi i këtij plani është si rezultat:

- Grumbullimi i një pjese të tarifave të shkollimit të planifikuara për vitin 2019 në tetor – dhjetor 2018. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për t'u realizuar në vitin 2018. Pjesa e papërdorur kanë kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2019.



Në zërat e të ardhurave të grumbulluara, peshën kryesore e zënë:

- Tarifat e shkollimit rreth 90.6 % ndaj totalit ose 85.9 % ndaj parashikimit, grumbullimi i të cilave është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria ekonomike dhe fakultetet. Këto të ardhura përbëhen nga:
 - tarifa e shkollimit në Bachelor dhe programe profesionale dyvjeçare me rreth 90.6 % ndaj totalit ose 85.9 % ndaj parashikimit
 - tarifa e shkollimit në Ciklin e dytë të studimeve me rreth 53.00 % nga e cila Master profesional rreth 28.5 % ndaj totalit ose 89.2 % ndaj parashikimit, ndërsa Master i shkencave 24.5 % ndaj totalit ose 84.5 % ndaj parashikimit,
 - tarifa e shkollimit në Ciklin e tretë të studimeve me rreth 0.4 % ndaj totalit
- Libreza e diploma me rreth 2.5 % ndaj totalit ose 84.1 % ndaj parashikimit,
- Taksë regjistrimi me rreth 3.1 %, ndaj totalit ose 104.7 % ndaj parashikimit
- Tarifë konkurrimi me rreth 0.2 %, ndaj totalit ose 83.00 % ndaj parashikimit
- Shërbime të ndryshme ndaj studentëve dhe të tretë-ve rreth 5.7 %, ndaj totalit ose 113.5 % ndaj parashikimit
- Qira mjedise me rreth 0.2 %, ndaj totalit ose 72.6 % ndaj parashikimit


Në realizimin e të ardhurave kanë ndikuar edhe efekte në ulje:

- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit, në zbatim të VKM – s dhe Vendimit të BA – së për përjashtim nga pagesa e tarifës së shkollimit të studentëve të Ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe programe profesionale dy vjeçare dhe ulje tarife vjetore e shkollimit . Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës të plotë i tarifës së shkollimit të studentëve të Ciklit të dytë të studimeve - Master. Sipas aplikimeve të kryera nga studentët për këtë qëllim përfitimi i tyre është 49,926 mijë lekë sipas tabelës së mëposhtme:
- Mosshlyerja në kohë e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve.
- Moshapja e disa programeve në MP e MSH për vitin e parë si rezultat i mosplotësimit të numrit minimal të regjistrimeve. Për këto programe është planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.
- Moshapja e disa programeve në Bachelor me kohë të plotë për vitin e parë për shkak të numrit minimal të regjistrimeve.
- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi. Për këto programe ishte planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.

Të ardhurat janë çelur për përdorim sipas ndarjeve në Buxhetin e vitit 2019 për Universitetin, mbështetur në domosdoshmërinë për shpenzim për çdo artikull dhe kontratave të lidhura e të realizuara në investime e shpenzime operative, si dhe për shpenzime të tjera korente. Të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2019 janë 168,461mijë lekë, nga të cilat janë çelur për përdorim 29,990 mijë lekë dhe janë derdhur në Buxhet 38 mijë lekë (10 % e të ardhurave nga qiratë). Të ardhura të çelura për përdorim nga viti 2018 janë 161,496 mijë lekë. Tërësia e çeljeve (të trashëguara nga viti 2018 dhe të çelura nga të ardhurat e vitit 2019) përbëjnë planin e thesarit prej 191.486 mijë lekë.

Përjashtim reduktim tarife 2018-2019			
Viti	Tarifa	Nr st	Vlera
I	25,000	455	11,375,000
II	25,000	524	13,100,000
III	25,000	617	15,425,000
Totali Cikli I		1,596	39,900,000
I	60,000	114	3,420,000
II	60,000	69	2,070,000
Master Profesional		183	5,490,000
I	72,000	40	1,440,000
II	72,000	86	3,096,000
Master i Shkencave		126	4,536,000
Totali Cikli II		309	10,026,000
TOTAL		349	49,926,000





Siç paraqitet në grafik këto të ardhura janë përdorur:

- për investime 24.5 %,
- për investime projekte të huaja 1.1 %,
- për studim projekte 3.1 %
- për kërkimin shkencor 11.5 %
- për paga e shpërblime 0.0% - me termin shpërblime janë: pagesa e orëve

mbi normë në sistemin me kohë të plotë,

- për sigurime shoqërore 0.0 %
- për shpenzime operative 53.6 %,
- për transferta tek individët 6.1 %
- për transferta me jashtë 0.1 %

1.2. Shpenzimet

Gjatë vitit 2019 shpenzimet gjithsej janë realizuar 72.1. % e financimit vjetor.

- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Sipas formave të financimit <ul style="list-style-type: none"> - Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, TVSH - projekte, kërkimi shkencor nga buxheti) janë realizuar 5.68 %, - Projekti të huaja 58.6 % - Shpenzimet nga Granti mësimdhënies është realizuar 93.8%. - Shpenzimet nga të ardhurat e institucionit janë realizuar 31 %. | <ul style="list-style-type: none"> ○ Sipas zërave të shpenzimit: <ul style="list-style-type: none"> - Shpenzimet për Paga e shpërblime 87 % - Shpenzimet për Sigurime shoqërore 92.4 % - Shpenzimet për Shpenzime operative 73.0 % - Transferta me jashtë 16.9 % - Transferta tek individët 34.2 % - Bursat për studentët 100 % - Shpenzimet për Kërkimi shkencor 50.2 % nga të cilat: Buxheti 0 % , Të ardhurat 68.4 % - Shpenzimet për Investimet 16.0 % - Projektet e huaja 57.3 % |
|--|--|

Më i detajuar realizimi i buxhetit 2019 sipas formave të financimit dhe ndarjes së zërave të shpenzimeve paraqitet në tabelën “*REALIZIMI I BUXHETIT PER VITIN 2019 Fakti_12 mujorit*”

➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600**

Pagat për vitin 2019 janë mbuluar kryesisht me fondet nga Granti për mësimdhënie dhe nga të ardhurat në masën 87 %.

- Paga nga Granti për mësimdhënie prej 91.6 %
- Paga nga të ardhurat e institucionit 0.2 %

Me këtë fond page janë përballuar ndryshimet e pagës sipas kualifikimit të personelit akademik. Ndërsa i marrë në tërësi paga e honorarë (orë mësimore mbi normë, orë pedagogë të jashtëm):

- Pagat e punonjësve 87.9 %
- Pagesa e orëve suplementare dhe pedagogë të jashtëm 83.3 %

Pjesën më të madhe në zërin paga e shpërblime nga të ardhurat e Universitetit e zë pagesa e orëve suplementare (honorarëve) të zhvilluara në vitin 2018 – 2019 e kryesisht: pagesa e personelit akademik të brendshëm për orët e zhvilluara në sistemin me kohë të plotë deri në 100 % të normës vjetore të normuar, si dhe orët e zhvilluara nga personeli akademik i ftuar (pedagogë të jashtëm). Të dhënat më të detajuara rezultojnë si në tabelën “Pagesa e orëve mësimore për vitin 2018 - 2019”.

Pagesa e orëve mësimore për vitin 2018 - 2019 për 12-m					
Nr	Lloji shpenzimit	Plan		Fakt	
		Orë	Lekë	Orë	Lekë
1	Orë mësimore për punonjës të brendshëm	51,400	49,632,000	50,876	49,959,965
2	Orë mësimore për punonjës të jashtëm	53,760	52,578,117	44,207	35,216,351
	Fondi gjithsej	105,160	102,210,117	95,083	85,176,316

➤ **Fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601**

Fondi për sigurime shoqërore është shpenzuar për likuidimin e detyrimeve që institucioni ka ndaj Degës së Sigurimeve Shoqërore, si kontribut për punonjësit e vet. Ky zë është realizuar në masën 92.4 % për fondin e planifikuar nga granti. Nga ky fond është përballuar fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore i llogaritur për pagesat e kryera për pedagogët e jashtëm për orët mësimore që këta të fundit kanë zhvilluar për vitin akademik 2018 – 2019, detyrime këto të përcaktuara sipas rekomandimeve të DRT Elbasan.

➤ **Shpenzime operative – Artikulli 602**

Shpenzimet operative për vitin 2019 janë përballuar nga të ardhurat dhe Granti për mësimdhënie në masën prej 73.0 %.

- Shpenzimet operative nga Granti për mësimdhënie prej 93.4 %
- Shpenzimet operative nga të ardhurat e institucionit 63.1 %

Shpenzimet operative për vitin 2019, janë realizuar kryesisht për:

- ujë, energji, telefon e tjera të kontraktuara,
- karburant për ngrohje dhe mjetet e transportit,
- materiale për mbrojtje personale dhe shërbime dezinfektimi nga Covid19,



- buletini shkencor, kancelari, furnizime të ndryshme materiale mësimore e tjera,
- udhëtim e diteta të ndryshme (transport e hotel për ekspeditat e praktika mësimore në terren).
- shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë së godinave,
- mirëmbajtje të objekteve ndërtimore dhe mjedise të jashtme,
- riparime e mirëmbajtje të ndryshme pajisjesh,

Rritje të ndjeshme në shpenzimet operative kanë disa zëra të domosdoshëm që i shërbejnë procesit mësimor. Krahës kësaj, rritje të ndjeshme kanë pagesat për rojet (ruajtjen e sigurimin e objekteve) duke marrë në konsideratë rritjen e pagës minimale për kontribut nga një vit më parë. Në formë të përmbledhur jepen në tabelën “Shpenzime për mallra dhe shërbime (602) Viti 2019”. Përqindja e realizimit në këtë tabelë është llogaritur me planin e miratuar gjatë vitit 2019 nga Bordi i administrimit për kryerjen e shpenzimeve operative për të gjitha objektet, pavarësisht nga çelja në degën e thesarit. Ky zë shpenzimesh është realizuar në total 73 %. Në disa zëra, mosrealizimi i shpenzimeve operative të planifikuara ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të disa prokurimeve për shkak të anulimit të procedurave, si dhe procedurat e prokurimit janë filluar në afatet e kërkuara, nuk janë përfunduar në afat.

Kodi llog	Grup shpenzimi	Grant			Të ardhura			Totali		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	0	0	0.0	7,320	5,945	81.2	7,320	5,945	81.2
6021	Materiale dhe shërbime speciale	0	0	0.0	9,390	1,245	13.3	9,390	1,245	13.3
6022	Shërbime nga te trete	36,100	34,434	95.4	37,360	23,359	62.5	73,460	57,794	78.7
6023	Shpenzime transporti + lëndë djegese	0	0	0.0	6,120	2,745	44.9	6,120	2,745	44.9
6024	Shpenzime udhetimi	0	0	0.0	12,500	7,931	63.5	12,500	7,931	63.5
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	0	0	0.0	10,680	9,701	90.8	10,680	9,701	90.8
6026	Shpenzime per qiramarrje	0	0	0.0	3,360	3,237	96.4	3,360	3,237	96.4
6029	Shpenzime te tjera operative	9,900	8,530	86.2	8,270	5,827	70.5	18,170	14,357	79.0
	Totali	46,000	42,964	93.4	95,000	59,991	63.1	141,000	102,956	73.0

Zëri i shpenzimeve operative “Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes” për vitin 2019 zë 40.2 % të shpenzimeve operative gjithsej, kjo për faktin se sipas VKM- s për këtë qëllim paga e punonjësve të sigurisë llogaritet me 1.5 herë të pagës minimale në shkallë vendi (nga 24,000 lek/ muaj në 36,000 lek/ muaj). Mbi këtë pagë llogaritet edhe kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore që paguan punëdhënësi. Në vitin 2019 në likuidimin e kreditorëve për shpenzimet operative nuk pati probleme në afatin e likuidimit. Kjo për arsye të grumbullimit të të ardhurave në mënyrë periodike dhe fondeve në dispozicion nga Granti për mësimdhënie.

➤ **Shpenzime operative për transferta me jashtë – Artikulli 605**

Transferta me jashtë është realizuar 16.9 % e fondit të çelur për këtë qëllim. Ky shpenzim është planifikuar për pagesën e pjesëmarrjes në institucione apo organizata ndërkombëtar. Është kryer vetëm një pagesë për Laboratorin kërkimor të FSHN për kryerjen e testeve të analizave në Institucione të akredituara ndërkombëtare, për procesin e akreditimit të këtij laborator

➤ **Transferta tek individët – Artikulli 606**

Shpenzimet për transferta tek individët janë realizuar 34.2 % , ndërsa bursat e studentëve 100 % të fondit të akorduar. Këto fonde ndahen:

- **Rimbursim të pagesave të studentëve.** Fondi prej 1,940 mijë është përdorur për rimbursim të pagesave të kryera nga studentët që kanë paguar tarifat e shkollimit, por që i përkasin shtresave sociale apo rezultateve të vitit paraardhës në bazë të akteve ligjore për këtë qëllim.



- **Transfertat për rastet e fatkeqësive dhe ndihmës ndaj personelit.** Në vitin 2019 janë kryer pagesa për vlerën 190 mijë lekë për 3 raste fatkeqësie dhe 2 rast sëmundje e rëndë.
- **Transfertat për rastet e daljes në pension.** Për shpërblimin e personelit të UE-së që kanë dalë në pension për vlerën 726 mijë lekë. Ky fond është marrë nga fondi i veçantë pjesë e fondit të pagave dhe ka kaluar në këtë artikull rast pas rasti.
- **Transfertat për komisione add-hoc.** Për shpërblimin e personelit të UE-së që kanë marrë pjesë në komisione add-hoc të krijuara me vendim të Senatit akademik dhe të Bordit të administrimit për vlerën 3,988 mijë lekë. Ky fond është marrë nga fondi i veçantë pjesë e fondit të pagave dhe ka kaluar në këtë artikull rast pas rasti.
- **Bursat e studentëve.** Për vitin 2019 fondi i bursave të studentëve është realizuar 100 % e fondit të akorduar. Në këtë artikull siç është theksuar përfshihen bursat e studentëve (transferta tek individët) për Ciklin e parë të studimeve. Fondi gjithsej është **114,395 mijë** lekë dhe përbëhet nga bursat e studentëve. Ky fond është akorduar në Grantin për bursat e studentëve në fillim të vitit në vlerën prej 44,795 mijë lekë. Procedura e trajtimit me bursë të studentëve ka kaluar në disa faza nga fillimi i vitit akademik. Trajtimi i studentëve me bursë deri më 31.12.2018 është bazuar në Vendimet e Këshillave Bashkiake për vitin e parë dhe me Vendim të Bordit të Administrimit në vitin e dytë e të tretë. Nga dhjetori 2018 e në vijim, Këshilli i Ministrave ka ndryshuar vendimin për bursat e studentëve. Universiteti në zbatim të këtyre ndryshimeve ka ndjekur të gjitha procedurat për aplikime dhe trajtim me bursë financiare të studentëve nga 01.01.2019 e në vijim.

Studentët që përfitojnë bursa për vitin akademik 2018-2019									
Përshkrimi	Nr stud					mu aj	Fondi		
	½ bursë	Plotë			Vazhd ojnë 2019		1/2 bursë	Plotë	Totali
		Me- satare	Kriter e tjera	Totali					
Me bursë deri 31.12.2018	1017	83	132	215	0	2.5	12,713	5,375	18,088
Bursë pas 31.12.2018(ish-1/2)	0	0	765	765	765	6.5	0	49,725	49,725
Bursë e plotë (nga 2018)	0	0	132	132	132	6.5	0	8,580	8,580
Me mesatare pas (ish-2018)	0	67	0	67	67	6.5	0	4,355	4,355
Me mesatare (nga 01.01.2019)	0	37	0	37	37	6.5	0	2,405	2,405
Me kriter e tjera (nga 1.01.2019)	0	0	289	289	289	6.5	0	18,785	18,785
Në pritje për trajtim (nga 1.01.2019)	0	0	192	192	192	6.5	0	12,480	12,480
Shuma				1,697	1,482	9	12,713	101,705	114,418

Janë trajtuar me bursë me vendime të organeve vendimmarrëse të përcaktuara në VKM nr. 903, datë 21.12.2016, që i përkasin periudhës nga 15 tetori 2018 deri më 31.12.2018 gjithsej 1,232 studentë me efekt financiar 18,062,500 lekë, e llogaritur me masën e ndryshuar të bursës:

- Me ½ bursë 1,017 studentë
- Me bursë të plotë sipas kriterëve për studentët në nevoja ekonomike gjithsej 132 studentë.
- Me mesatare me notën 9-të e lart gjithsej 83 studentë.

Numri i bursave financiare për 1,482 studentë janë llogaritur sipas përcaktimeve në VKM nr. 39 datë 23.01.2019, si më poshtë:

- Janë miratuar me vendime të Bordit të Administrimit kërkesat e 765 studentëve, të cilët kanë përfituar deri më 31.12.2018 me ½ burse dhe vazhdojnë të përfitojnë bursë financiare.
- Janë miratuar me vendime të organeve vendimmarrëse të përcaktuara në VKM nr. 903, që i përkasin periudhës nga 15 tetori 2018 deri më 31.12.2018 dhe vazhdojnë të trajtohen me bursë financiare për periudhën në vijim gjithsej 132 studentë.



- Janë miratuar me vendime të Bordit të Administrimit 104 studentë që përfitojnë bursë financiare sipas rezultateve (mesatare e ponderuar 9 – të e lart e vitit paraardhës për vitin e dytë e të tretë, mesatare e ponderuar 9 – të e lart e shkollës së mesme për vitin e parë).
 - Janë miratuar me vendime të Bordit të Administrimit kërkesat e 289 studentëve që përfitojnë bursë financiare
 - Janë në pritje të konfirmimeve të dokumenteve kërkesat e 192 studentëve
- Nuk janë miratuar për dhënie burse deri në mbledhjen e fundit të Bordit të Administrimit kërkesat për 55 studentë nga të cilët:
- nuk përfitojnë bursë financiare 28 studentë, sepse nuk plotësojnë kriteret sipas konfirmimeve të njëjësive përkatëse
 - nuk përfitojnë bursë financiare 27 studentë, sepse vazhdojnë studimet jashtë kohës normale.

➤ **Shpenzime për investime - artikulli 230/231**

Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen në formën e:

- **Financimi i brendshëm (Buxheti) përbëhet nga Grant konkurrues për investime, tvsh për projektet e huaja.**

Grant konkurrues për investime, që janë fondet që përballohen nga buxheti i shtetit. Deri në këto momente nuk janë akorduar fonde. Nga Universiteti është dërguar për konkurrim 1 objekt, vlera totale e të cilit është **699,455** mijë lekë me bashkëfinancim në vlerën 210,000 mijë lekë nga të ardhurat e Universitetit, ndërsa për vitin 2019 fondi i planifikuar për konkurrim 140,000 mijë lekë nga të ardhurat.

TVSH për projekte të huaja është realizuar pjesërisht nga buxheti pasi një pjesë e tyre për vitin 2019 janë planifikuar dhe realizuar nga të ardhurat. Nga buxheti u realizua financimi i TVSH-s për një projekt të huaj në vlerën 412 mijë lekë ose 100 % e financimit.

- **Investimeve nga të ardhurat e vetë institucionit** me fond 196,800 mijë lekë. Këto investime ndahen në:

- **Studime e projekte – artikulli 230**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për studime e projekte, të cilat për vitin 2019 janë parashikuar 6 objekte me vlerë 3,434 mijë lekë dhe janë realizuar 6 objekte me vlerë 3,425 mijë lekë.

- **Investimet - Artikulli 231:**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për investime për: ndërtim e rikonstrukcione objektesh, blerje pajisje për auditorë e zyra, blerje pajisje laboratorike për laboratorët mësuesorë e shkencorë, fond libri etje. Projektet e investimeve të financuara paraqiten në tabelën “Investime viti 2019 - të ardhurat e institucionit” dhe janë realizuar 16.29%. Treguesit e realizimit të investimeve janë relativisht të ulëta, pasi në investimet e planifikuara vetëm një objekt zë 71.14 % të investimeve. Objekti “Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane - ish materniteti” nuk është realizuar, pasi nuk është konfirmuar miratimi i financimit të këtij objekti nga KZHR.

- Ndërtim, rikonstrukcion objekte ndërtimore janë të ndara në dy nëngrupe. Ndërtim të reja me vlerë 140,000 mijë lekë është objekti “Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane - ish materniteti” nuk është realizuar, pasi nuk është konfirmuar miratimi i financimit të këtij objekti nga KZHR. Rikonstrukcion objekte ndërtimore dhe instalime rrjete janë realizuar në vlerën 11,700 mijë lekë ose 34.13 %. Në këtë grup është realizuar vetëm një objekt “Instalim rrjeti dhe vendosje kamera sigurie në godinat e UE”, ndërsa objektet e tjera nuk janë realizuar , pasi nuk u kryen procedurat brenda vitit 2019.



- Pajisjet janë realizuar me vlerë 15,677 mijë lekë ose 95.71% të investimit të planifikuar për vitin 2019.
- TVSH për projekte të huaja është realizuar pjesërisht nga të ardhurat në vlerën 1,249 mijë lekë ose 46.18 % të fondeve të parashikuara për financim nga të ardhurat. Këto fonde do të rimbursohen me financimin nga Buxheti i Shtetit.

Investime viti 2019 - të ardhurat e institucionit				
Nr.	Emërtimi i projektit	Fondi 000/ lekë		
		Plani	fakti	%
I	Studime e projekte	3,434	3,425	99.76
1	Projekt + preventiv "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor"	422	422	100.00
2	Projekt + preventiv "Rikonstruksion amfiteatri Korpusi kryesor, Salla 120 FSHMT, Salla 101 Fakulteti ekonomik"	801	801	100.00
3	Projekt + preventiv "Rikonstruksion laboratorit Kërkimor FSHN"	780	780	100.00
4	Projekt + preventiv "Aspirim kondicionim Laboratori Anatomisë FSHMT"	470	470	100.00
5	Projekt + preventiv "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor - fasada xhamit"	480	478	99.50
6	Projekt + preventiv "Shkallë emergjence godinat e UE"	480	474	98.75
II	Ndërtime të reja	140,000	0	0.00
1	Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane - ish materniteti	140,000	0	0.00
III	Rikonstruksione	34,282	11,700	34.13
1	Instalim rrjeti dhe vendosje kamera sigurie në godinat e UE	12,660	11,700	92.42
2	"Rikonstruksion salla 120 FSHMT, salla 101 FE"	12,590	0	0.00
3	Mbikqyerje - "Rikonstruksion salla 120 FSHMT, salla 101 FE"	326	0	0.00
4	Kolaudim - "Rikonstruksion salla 120 FSHMT, salla 101 FE"	25	0	0.00
5	"Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	960	0	0.00
6	Mbikqyerje - "Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	40	0	0.00
7	Kolaudim - "Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	9	0	0.00
8	"Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	7,450	0	0.00
9	Mbikqyerje - "Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	204	0	0.00
10	Kolaudim - "Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	19	0	0.00
IV	Pajisje	16,380	15,677	95.71
1	Pajisje kompjuterike e fotokopje	9,000	8,756	97.29
2	Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra	5,040	4,790	95.03
3	Pajisje laboratorike	960	953	99.25
4	Pajisje e audiovizive, U. Elbasan	0	0	0.00
5	Fond libri biblioteka	960	763	79.46
6	Pajisje pune	420	416	98.95
V	Mjete transporti	0	0	0.00
1	Mjete tjera transp	0	0	0.00
VI	Projekte të huaja	2,704	1,249	46.18
1	Pagesë TVSH për investime	2,704	1,249	46.18
2	Pajisje për projektet e huaja	0	0	0.00
	Shuma	196,800	32,051	16.29



REALIZIMI I BUXHETIT PER VITIN 2019 Fakti_12 mujorit														
Nr.	Emërtimi	Artikulli	Financim i brendshëm			Granti			Të ardhura			Total Buxheti		
			Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%
1	Paga e shperblime	600	0	0	0.0	475,445,068	435,296,992	91.6	25,000,000	45,684	0.2	500,445,068	435,342,676	87.0
-	Pagat		0	0	0.0	398,235,068	350,166,360	87.9	0	0	0.0	398,235,068	350,166,360	87.9
-	Honorare - oret		0	0	0.0	77,210,000	85,130,632	110.3	25,000,000	45,684	0.2	102,210,000	85,176,316	83.3
2	Sig. Shoqërore	601	0	0	0.0	62,300,000	62,176,479	99.8	5,000,000	0	0.0	67,300,000	62,176,479	92.4
3	Shpenzime operative	602	0	0	0.0	46,000,000	42,964,453	93.4	95,000,000	59,991,465	63.1	141,000,000	102,955,918	73.0
4	Transf. me jashtë	605	0	0	0.0	0	0	0.0	900,000	152,273	16.9	900,000	152,273	16.9
5	Transf._individit	606	0	0	0.0	0	0	0.0	20,000,000	6,844,299	34.2	20,000,000	6,844,299	34.2
6	Bursa	606	0	0	0.0	114,395,000	114,395,000	100.0	0	0	0.0	114,395,000	114,395,000	100.0
7	Kërkimi shkencor		6,850,000	0	0.0	0	0	0.0	18,796,338	12,865,133	68.4	25,646,338	12,865,133	50.2
-	Kërkimi shkencor	230	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Kërkimi shkencor	231	6,850,000	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	6,850,000	0	0.0
-	Kërkimi shkencor	602	0	0	0.0	0	0	0.0	18,796,338	12,865,133	68.4	18,796,338	12,865,133	68.4
8	Investime	230 - 231	412,369	412,369	100.0	0	0	0.0	194,095,602	30,802,500	15.9	194,507,971	31,214,869	16.0
a	Stud. Projekt.	230	0	0	0.0	0	0	0.0	3,433,800	3,425,400	99.8	3,433,800	3,425,400	99.8
b	Investime trupëz.	231	412,369	412,369	100.0	0	0	0.0	190,661,802	27,377,100	14.4	191,074,171	27,789,469	14.5
-	Ndërtime të reja	231	0	0	0.0	0	0	0.0	140,000,000	0	0.0	140,000,000	0	0.0
-	Rikonstruksione	231	0	0	0.0	0	0	0.0	21,621,802	0	0.0	21,621,802	0	0.0
-	Instalime rrjete	231	0	0	0.0	0	0	0.0	12,960,000	11,700,000	90.3	12,960,000	11,700,000	90.3
-	Makineri teknologjike	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Paisje profesionale	231	0	0	0.0	0	0	0.0	960,000	952,800	99.3	960,000	952,800	99.3
-	Paisje inventar ekonomik	231	412,369	412,369	100.0	0	0	0.0	15,120,000	14,724,300	97.4	15,532,369	15,136,669	97.5
-	Mjete transporti	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
9	Projekti huaja	230-231	24,362,073	14,271,487	58.6	0	0	0.0	2,704,000	1,248,782	46.2	27,066,073	15,520,269	57.3
-	Grante korente	604	10,842,073	5,942,448	54.8	0	0	0.0	0	0	0.0	10,842,073	5,942,448	54.8
-	Investime	231	13,520,000	8,329,039	61.6	0	0	0.0	2,704,000	1,248,782	46.2	16,224,000	9,577,821	59.0
	Totali		24,362,073	14,683,856	60.3	698,140,068	654,832,924	93.8	361,495,940	111,950,136	31.0	1,083,998,081	781,466,916	72.1



➤ Fondet dhe projektet për kërkimin shkencor

Për kërkimin shkencor ka dy forma financimi:

- Fondi për kërkimin shkencor me Grant konkurrues.
- Fondi për kërkimin shkencor nga të ardhurat.
- Fondi për kërkimin shkencor me Grant konkurrues.
Për vitin 2019 me Grant konkurrues, u miratuan një projekt “Krijimi i Laboratorit Digital të anatomisë”, nga projektet e dërguara për konkurrim tek AKKSHI me objekt ngritja dhe funksionimi i laboratorit digital të anatomisë (tavolina e Anatomisë) në FSHMT në UE. Ky laborator do të jetë në shërbim të stafit akademik, stafit ndihmës akademik, studentëve dhe personelit mjeksor në Spitalin Rajonal “Xhaferr Kongoli”, duke shërbyer për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, diagnostifikimit dhe kërkimit shkencor.
Me Vendim të Bordit të AKKSHI-it nr. 12, datë 08.08.2019 është miratuar fondi prej 14,850,000 lekë me të cilin UE është bazuar për të kryer procedurat e prokurimit dhe lidhjen e kontratës së furnizimit. Ky fond u çel në Degën e Thesarit nga MFE me shkresë nr.16430/1, date 27.09.2019 shtese fondi ne vlere 14.850.000 leke. Po nga MFE me nr.17343/138, date 04.11.2019 pakesim fondi ne vlere 8.000.000 leke. Për vitin 2019 nuk u lidh kontrata për blerjen e pajisjeve të projektit, pasi nuk u realizua brenda vitit procedura e prokurimit publik.
- Fondi për kërkimin shkencor me të ardhurat e vetë institucionit me vlerë 18,796 mijë lekë. Aplikimi për këto projekte do të bëhet në Rektorat brenda 6 – mujorit të parë të vitit, sipas formatit të AKTI-t. Me shqyrtimin e këtyre projekteve realizohet nga komision i caktuar nga Senati Akademik.

Projekte Kërkimi shkencor - UE

000 lekë

Nr.	Emërtimi i projektit	Financimi viti 2019			Financimi pas vitit 2019
		Plan	Fakt	%	
I	Financim - Buxheti	6,850	0	0.00	14,850
1	Ndërtimi i Database-s së Universitetit për menaxhimin e të dhënave - mirembajtje EMS	6,850	0	0.00	14,850
II	Financim - Të ardhurat	18,796	12,865	68.44	2,788
1	Ndërtimi i Database-s së Universitetit për menaxhimin e të dhënave - mirembajtje EMS	12,000	9,590	79.92	2,410
2	"Konferenca e 11-të Mjekesore Ndërkombëtare në Specialitete"	2,300	0	0.00	0
3	"Punëtorë" të shquar të Albanologjisë"	350	262	74.86	0
4	"Roli i edukimit dhe sportit në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqënies sociale"	630	520	82.50	0
5	"Kostot dhe Përfitimet e Ndërkombëtarizimit të Universiteteve"	800	741	92.56	0
6	"Konferenca e I-rë në Logopedi dhe Fizioterapi"	800	763	95.33	0
7	"Konferenca e V-te Kombetare Infermierore në Specialitete"	800	614	76.78	126
8	"Sfidat dhe Arritjet e Profesionit të Punës Sociale në Shqipëri"	800	376	46.96	0
9	"Konferenca e 8-të ndërkombëtare"	316	0	0.00	252
	Shuma	25,646	12,865	50.16	17,638



➤ Projektet e Huaja

Projektet e huaja janë në vazhdim nga vitet e mëparshme si dhe ka aplikime nga departamentet për këto projekte si më poshtë:

Projekte të huaja - UE											
Nr.	Emërtimi i projektit	Viti i		Statusi	Financimi 000/ lekë						
		Filli mit	Mbari mit		Të ardhura viti 2019			Shpenzime viti 2019			Gjend je në fund
					Gjendj a ne banke	Dizbur simi	Total	Koren te	Kapit ale	TVSH	
1	SATIS - Bashkepunimi Evropian ne fushen e kerkimit dhe te edukimit me vendet e Ballkanit Perendimor"	2013	2016	I mbyllur	1	0	1	1	0	0	0
2	EUROËEB - Perdorimi i burimeve lokale per zhvillimin e mikrorajoneve, agrobiznesit dhe turizmit te qendrueshem ne Ballkanin Jugor" - eshte nje projekt i tipit Tempus.	2013	2018	I mbyllur	134	0	134	134	0	0	0
3	Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit	2013	2016	Ka përfunduar, nuk është mbyllur	689	0	689	7	0		681
4	Sunbeam - Mobilitete te strukturuara midis Balkanit dhe Evropes per Makrorajonin e Adriatikut dhe Jonit	2015	2018	I mbyllur	203	0	203	203	0	0	0
5	Përmirësimi i sigurimit të cilësisë dhe Akreditimit në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri: Aplikimi i Metodologjisë të Procesit dhe Rezultateve	2014	2016	Ka përfunduar, nuk është mbyllur	0	0	0	0	0	0	0
6	REBUS - Ngritja e biznesit - Integrimin dhe vlerësimi i aftësive praktike të ndërmarrësisë në inxhinieri dhe TIK	2016	2019	Në vazhdim	1,854	0	1,854	1,848	0	0	6
7	TEA VET-Zhvillimi kompetencave të mësimdhënies në Shqipëri	2017	2020	Në vazhdim	133	3,337	3,469	958	1,633	327	878
8	T@SK - Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësisë dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale	2017	2020	Në vazhdim	5,416	5,884	11,300	1,863	4,634	922	4,803
9	E-VIVA-Përmirësimi dhe vlerësimi i kompetencave të lidhura me shërbime në mjedis të ndryshme të të mësuarit në Universitetet e Ballkanit Perëndimor	2019	2021	Në vazhdim	0	4,164	4,164	931	2,062	412	1,171
	Shuma				8.430	13.385	21.815	5.947	8.329	1.661	7.539

Universiteti për vitin 2019 ka 9 projekte të huaja me gjendje monetare në bankë ose pritjet të financohen. Nga projektet e huaja në bankën e nivelit të dytë janë gjendje 8,795 mijë lekë. Për vitin 2019 u parashikuan të financohen 130,975 euro ose 17,027 mijë lekë. Gjatë vitit 2019 u parashikua të shpenzohen 13,520 mijë lekë investime dhe 10,842 mijë lekë shpenzime operative. Për investimet është parashikuar 2,704 mijë lekë nga të ardhurat për likuidimin e TVSH-s.

Nga procedurave të zbatimit të buxhetit TVSH-ja përballohet nga Buxheti i Shtetit. Për të zbatuar afatet e përcaktuara në likuidimin e faturave ndaj të tretëve, TVSH-ja është planifikuar të përballohet nga të ardhurat e institucionit dhe do të kërkohet rimbursimi i saj nga Buxheti i Shtetit.

Situata e projekteve:



- Tre nga këto projekte janë mbyllur nga fillimi i vitit 2019, pasi në to kishte shpenzime minimale të palikuiduara.
- Projekti “Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit” ka përfunduar, është me gjendje monetare në bankë. Këto vlera do të kalojnë në të ardhurat e Universiteti, pasi janë disbursuar për mbulimin e shpenzimeve që janë kryer nga të ardhurat e institucionit gjatë zbatimit të projektit.
- Projekti “Përmirësimi i sigurimit të cilësisë dhe Akreditimit në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri: Aplikimi i Metodologjisë të Procesit dhe Rezultateve” ka përfunduar. Nuk është mbyllur, pasi pritet disbursimi i investimeve të projektit në vlerën prej 1,460 mijë lekë. Për blerjen e pajisjeve në kuadër të projektit në vitin 2016 është kryer procedura e investimeve për pajisje kompjuterike bazuar në kërkesat e BE për vlerën 1,751,400 lekë (ose 12771 Euro). Në vitin 2016 nga Universiteti është likuiduar TVSH-ja për vlerën 291,900 lekë. Vlera prej 1,459,500 lekë nuk është likuiduar për subjektin kontraktues, pasi donatori (BE) nuk ka bërë disbursimin e vlerës. Për çdo procedurë është njoftuar Donatori (lideri i projektit) për disbursimin e vlerës së projektit. Në vitin 2018 mbështetur në Udhëzimin nr. 2/2 datë 14.09.2018 “për një shtesë dhe ndryshim në Udhëzimin plotësues nr.2 datë 19.02.2018 ‘për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018’” pika 3, vlera prej 1,459,500 lekë u krijua mundësia për likuidimin nga të ardhurat e institucionit. Ky financim në momentin e disbursimit rikthehet si e ardhur në Degën e Thesarit.
- Katër projekte (REBUS, TEAVET, T@SK, e-VIVA) janë në proces me disbursime dhe shpenzime sipas tabelës së paraqitur.

2. Realizimi i buxhetit Janar–Tetor 2020

Për vitin 2020 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **1,260,379** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për 10 mujorin viti 2020				lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2019	Financimi viti 2020	Buxheti 10 mujori viti 2020
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfertat)	43,307,144	836,752,437	880,059,581
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	7,558,438	10,396,469	17,954,907
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuara	217,968,511	144,396,087	362,364,598
TOTALI		268,834,093	991,544,994	1,260,379,086

- Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfertat) Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) **880,059,581** lekë
- Projekte të huaja **17,954,907** lekë,
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) **362,364,598** lekë,

2.1. Hyrjet e fondeve për 10 mujorin e vitit 2020

Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2020 (10 mujori) buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **1,260,379** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Nr	Fonde të hyra “Buxheti 10 mujori viti 2020”			
	Emërtimi i programit	Buxheti vjetor	Akorduar	në %
1	Grant konkurrues	0	0	0.00
2	Grant kërkimi shkencor	14,850,000	10,575,605	71.22
3	Buxhet -TVSH projekte	2,805,151	1,333,146	47.52
I	Buxheti i brendshëm	17,655,151	11,908,751	67.45
1	Grant mësimdhënie e bursat e studentëve	868,150,830	868,150,830	100.00
II	Grant	868,150,830	868,150,830	100.00
1	Të ardhurat e trashëguara viti 2019	217,968,511	217,968,511	100.00
2	Të ardhura jashtë limiti viti 2020	240,000,000	144,396,087	60.17
III	Të ardhura	457,968,511	362,364,598	79.12
1	Projekti të huaja	31,593,192	17,954,907	56.83
IV	Projekti të huaja	31,593,192	17,954,907	56.83
	Totali	1,375,367,684	1,260,379,086	91.64

- Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) në vlerën **11,908,751** lekë, ose 67.45 %
- Projekte të huaja **17,954,907** lekë, ose 56.83 %
- Grant mësimdhënie e bursat e studentëve në vlerën **868,150,830** lekë, ose 100.00 %
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) në vlerën **362,364,598** lekë, ose 79.12 %



Ndarë në artikuj dhe sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë në pasqyrat: “Buxheti 10 mujori viti 2020”, “Të Ardhurat për 10 mujorin viti 2020 - fakti”, “Realizimi i Buxhetit për vitin 2020 - Fakti i 10 mujorit”

Fondet të kushtëzuar – të ardhurat e UE - së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 362,365 mijë lekë ose 79.1 % të krahasuara me planin vjetor të tyre, ndërsa të ardhurat për tu grumbulluar në vitin 2020 janë realizuar në vlerën 144,396 mijë lekë ose 60.2 % të krahasuara me planin vjetor të tyre. Këto të ardhura janë grumbulluar gjatë vitit deri në 31 Tetor të vitit 2020

Të Ardhurat për 10 mujorin viti 2020 - fakti

Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	240,000	144,396	60.2
1	Qera	520	120	23.1
2	Bachelor, programe prof	109,754	66,340	60.4
3	M. Profesional	66,610	38,078	57.2
4	M. Shkencor	40,680	29,014	71.3
5	Doktoraturë	0	0	0.0
6	Libreza Diploma etj.	4,357	2,878	66.1
7	Lëshim dokumenti	5,000	1,854	37.1
8	Taksë regjistrimi	5,550	3,779	68.1
9	Tarifa konkurrimi	500	485	97.0
10	Tjera - shërbime	2,029	1,659	81.7
11	Pjesm. konferenca	5,000	5	0.1
12	Sponsorizime	0	185	0.0
B	Të ardhura të trashguara	217,969	217,969	100.00
1	Trashëguar nga viti 2019	217,969	217,969	100.00
Totali		457,969	362,365	79.1

Realizimi prej 79.1 % është rezultat i grumbullimi i një pjese të tarifave të shkollimit të planifikuara për vitin 2020 në tetor–dhjetor 2019. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2019. Pjesa e papërdorur ka kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2020.

Në zërat e të ardhurave për t'u grumbulluar gjatë periudhës janar–gusht 2019, grumbullimi i të cilave është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria ekonomike dhe fakultetet, peshën kryesore e zënë:

- Tarifat e shkollimit Bachelor rreth 60.4 %,
- Tarifat e shkollimit MP rreth 57.2 % ,
- Tarifat e shkollimit MSH rreth 71.3 % ,
- Libreza e diploma me rreth 66.1 % ,
- Lëshim dokumenti me rreth 37.1 % ,
- Tarifa regjistrimi me rreth 68.1 % ,
- Tarifa konkurimi me rreth 97 % ,
- Shërbime të ndryshme ndaj studentëve dhe të tretë-ve rreth 81.7 % ,
- Pjesmarrje në konferenca rreth 0.1 % ,
- Sponsorizime janë trajtuar financimet e Universiteteve të huaja për shpenzime operative në kudër të bashkëpunimit.

Në realizimin e të ardhurave kanë ndikuar edhe efekte në ulje:

- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit për Ciklin e parë të studimeve dhe ulja e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, në zbatim të VKM – s dhe Vendimeve të BA – së. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës të plotë të tarifës së shkollimit.
- Sipas aplikimeve të kryera nga studentët për këtë qëllim përfitimi i tyre është 81,041 mijë lekë sipas tabelës së mëposhtme

- Mosshlyerja në kohë e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve.
- Moshapja e disa programeve në MP e MSH për vitin e parë si rezultat i mos plotësimit të numrit minimal të regjistrimeve. Për këto programe është planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.
- Moshapja e disa programeve në Bachelor me kohë të plotë për vitin e parë për shkak të numrit minimal të regjistrimeve.
- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi. Për këto programe ishte planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.

Të ardhurat janë çelur për përdorim sipas ndarjeve në Buxhetin e vitit 2020 për Universitetin, mbështetur në domosdoshmërinë për shpenzim për çdo artikull dhe kontratave të lidhura e të realizuara në investime e shpenzime operative, si dhe për shpenzime të tjera korente.

Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2019-2020								
DEGA	I parë		I dytë		I tretë		Total	
	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
Reduktim tarife me 50% Viti I	1,682	21,025,000	0	0	0	0	1,682	21,025,000
Reduktim tarife me 50% me mesatare mbi 6 Viti II + III	0	0	425	5,312,500	432	5,400,000	857	10,712,500
Përjashtimet nga tarifat e shkollimit me rezultate	33	825,000	22	550,000	50	1,250,000	105	2,625,000
Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kritere tjera	530	13,250,000	489	12,225,000	467	11,675,000	1,486	37,150,000
Ciklë parë i studimeve Totali	2,245	35,100,000	936	18,087,500	949	18,325,000	4,130	71,512,500
Reduktim tarife me 50% me rezultate	6	180,000	13	390,000	0	0	19	570,000
Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	103	3,090,000	60	1,800,000	0	0	163	4,890,000
Total MP	109	3,270,000	73	2,190,000	0	0	182	5,460,000
Reduktim tarife me 50% me rezultate	11	396,000	21	756,000	0	0	32	1,152,000
Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	61	2,196,000	20	720,000	0	0	81	2,916,000
Total MSH	72	2,592,000	41	1,476,000	0	0	113	4,068,000
Ciklë dytë i studimeve Totali	181	5,862,000	114	3,666,000	0	0	295	9,528,000
Total UE	2,426	40,962,000	1,050	21,753,500	949	18,325,000	4,425	81,040,500

2.2. Shpenzimet

Gjatë 10- muorit të vitit 2020 shpenzimet gjithsej janë realizuar 53.67 % e financimit vjetor.

Nr	Shpenzime të fondeve të çelura (akorduara)			
	Emërtimi i programit	Çelur për përdorim	fakt	në %
1	Grant konkurrues	0	0	0.00
2	Grant kërkimi shkencor	10,575,605	10,575,605	100.00
3	Buxhet -TVSH projekte	1,333,146	1,309,813	98.25
I	Buxheti i brendshëm	11,908,751	11,885,418	99.80
1	Grant mësimdhënie dhe bursat e studentëve	868,150,830	523,937,818	60.35
II	Grante	868,150,830	523,937,818	60.35
1	Të ardhura jashtë limiti viti 2020	232,968,511	65,917,225	28.29
III	Të ardhura	232,968,511	65,917,225	28.29
1	Projekti të huaja	17,954,907	5,287,583	29.45
IV	Projekti të huaja	17,954,907	5,287,583	29.45
	Totali plan buxheti i çelur	1,130,982,999	607,028,044	53.67

Plan buxheti i çelur për përdorim (Plan Thesari) në vlerën **607,028,044**lekë, ose 53.67 %



○ Sipas formave të financimit

- Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, TVSH projekte, kërkimi shkencor nga buxheti) janë realizuar 99.8%
- Granti për mësimdhënie dhe bursat e studentëve për shpenzime korente është realizuar 60.35 %.
- Projekte të huaja gjithësej 29.45 %
- Shpenzimet nga të ardhurat e institucionit janë realizuar 28.29 %.

○ Sipas zërave të shpenzimit:

- Shpenzimet për Paga e shpërblime 50.4 %
- Shpenzimet për Sigurime shoqërore 66.3 %
- Shpenzimet për Shpenzime operative 52.7 %
- Transferta me jashtë 38.2 %
- Transferta tek individët 59.0 %
- Bursat për studentët 87.3 %
- Shpenzimet për kërkimin shkencor 47.2% nga të cilat: Buxheti i çelur 100 %, Të ardhurat 32.9 %
- Shpenzimet për investimet 11.9 %
- Projektet e huaja 17.5 %

Më i detajuar realizimi i buxhetit sipas formave të financimit dhe ndarjes së zërave të shpenzimeve paraqitet në tabelën “Realizimi i buxhetit për vitin 2020 Fakti i 10 mujorit”

➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600**

Pagat për periudhën Janar-Tetor 2020 janë mbuluar kryesisht me fondet nga Granti për shpenzime korente në masën 52.9 % të planit vjetor, ose 64 % të parashikimit të 10-mujorit. Plani vjetor i pagave përfshin edhe mbulimin nga të ardhurat, nga të cilat për 10-mujorin janë çelur 28,113 mijë lekë nga i cili janë realizuar 0.0%.

Me këtë fond page janë përballuar ndryshimet e pagës sipas kualifikimit të personelit akademik. Pjesën më të madhe në zërin paga e shpërblime e zënë pagat mujore në masën 98.7 % të realizimit, ndërsa pagesa e honorarëve për orët mësimore të zhvilluara në vitin 2019 – 2020 e kryesisht pagesa e personelit akademik i ftuar (pedagogë të jashtëm) në masën 1.3% të fondit të realizuar. Të dhënat më të detajuara rezultojnë si në tabelën “Pagesa e orëve mësimore për vitin 2019 – 2020 për 10-mujorin”.

Pagesa e orëve mësimore për vitin 2019 – 2020 për 10-mujorin							
Nr	Lloji shpenzimit	Plan		Realizuar		Paguar	
		Orë	Lekë	Orë	Lekë	Orë	Lekë
1	Orë mësimore për punonjës të brendshëm	64,250	82,328	54,941	53,193,100	0	0
2	Orë mësimore për punonjës të jashtëm	16,603	17,732	37,599	28,665,509	3,334	3,988,528
	Fondi gjithsej	80,853	100,060	92,540	81,858,609	3,334	3,988,528

➤ **Fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601**

Fondi për sigurime shoqërore është shpenzuar për likuidimin e detyrimeve që institucioni ka ndaj Degës së Sigurimeve Shoqërore, si kontribut për punonjësit e vet. Ky zë është realizuar në masën 66.3 % për fondin e planifikuar vjetor dhe nga granti është realizuar 79.5 % të fondit të planifikuar për 10-mujorin.



➤ Shpenzime operative – Artikulli 602

Për vitin 2020 shpenzimet operative janë parashikuar të përballohen nga granti për shpenzime korente dhe nga të ardhurat. Këto shpenzime janë realizuar për periudhën Janar-Tetor 2020 në masën 52.7 % e fondit të çelur për këtë qëllim: nga granti 64.3 % dhe nga të ardhurat 17.4 % e planit vjetor. Shpenzimet operative për vitin 2020, janë realizuar kryesisht për: ujë, energji, telefon, karburant, buletini shkencor, kancelari, furnizime të ndryshme materiale, rojet e godinave, lyerje godine, riparime të ndryshme pajisjesh, veprimtari pritje-përcjellje, udhëtim e hotel për ekspeditat etje. Rritje të ndjeshme në shpenzimet operative kanë disa zëra të domosdoshëm që i shërbejnë procesit mësimor. Krahas kësaj, rritje të ndjeshme kanë pagesat për rojet (ruajtjen e sigurimin e objekteve), uji, energjia elektrike, karburanti për ngrohje etje. Në formë të përmbledhur jepen në tabelën “Shpenzime për mallra dhe shërbime (602) Janar-Tetor 2020”. Ky zë shpenzimesh është realizuar për periudhën Janar-Tetor 2020 në masën 52.7 % e fondit të çelur për këtë qëllim: nga granti 64.3 % dhe nga të ardhurat 17.4 % e planit 10-mujor. Mosrealizimi i shpenzimeve operative të planifikuara ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të disa prokurimeve për shkak të anulimit të procedurave, ndërkohë që procedurat e prokurimit janë filluar në afatet e kërkuara, por nuk janë përfunduar në afat.

Shpenzime për mallra dhe shërbime (602) Janar-Tetor 2020										
Kodi llog	Grup shpenzimi	Grant			Të ardhura			Totali		
		Plan vjetor	Fakt	%	Plan vjetor	Fakt	%	Plan vjetor	Fakt	%
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	3,026	1,152	38.1	8,320	1,679	20.2	11,346	2,831	24.9
6021	Materiale dhe shërbime speciale	6,600	2,503	37.9	4,700	117	2.5	11,300	2,620	23.2
6022	Shërbime nga te trete	62,864	50,285	80.0	7,320	706	9.6	70,184	50,991	72.7
6023	Shpenzime transporti + lëndë djegese	2,540	192	7.6	3,740	3,366	90.0	6,280	3,558	56.7
6024	Shpenzime udhëtimi	9,110	2,082	22.8	400	37	9.2	9,510	2,118	22.3
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	9,456	1,748	18.5	4,484	205	4.6	13,940	1,954	14.0
6026	Shpenzime per qiramarrje	3,000	2,443	81.4	480	0	0.0	3,480	2,443	70.2
6027	Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale	3,200	3,190	99.7	980	0	0.0	4,180	3,190	76.3
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
6029	Shpenzime te tjera operative	13,240	9,103	68.8	6,540	303	4.6	19,780	9,406	47.6
	Totali	113,036	72,698	64.3	36,964	6,414	17.4	150,000	79,112	52.7

Në shpenzimet për ekspeditat e studentëve në vitin 2020 reflektohet ulje e tyre. Për periudhën e analizuar ky zë është realizuar 29.97 % e vlerës së planifikuar, ose 21.26 % e numrit të studentëve të planifikuar. Kjo për faktin se këtë vit mësimi u zhvillua online për shkak të pandemisë së Covid19. Ekspedita është realizuar në fillim të janarit 2020 nga programi i studimit të Ciklit të parë “Bachelor në edukim fizik dhe sporte”, viti i parë, për praktikimin e sportit të skive.

FAKTI-EKSPEDITAVE VITI SHKOLLOR 2019 - 2020										
	Cikli	Programi	Stud.	Pedag +Lab.	Stude. Pedag +Lab.	Lëvizizja Km	Vlera Udhëtimit lekë	Netë	Vlera Fjetjes lekë	Total lekë
Totali Plan	I+II	11	348	45	393	10,112	1,044,440	54	5,024,400	6,068,840
Totali Fakt	I	1	74	7	90	284	64,800	10	1,754,300	1,819,100
%			21.26	15.56	22.90	2.81	6.20	18.5	34.92	29.97



➤ **Shpenzime operative për transferta me jashtë – Artikulli 605**

Transferta me jashtë është realizuar 38.2 % e fondit vjetor të planifikuar ose është realizuar 98.9 % e fondit të çelur për këtë qëllim. Ky shpenzim është planifikuar për pagesën e pjesëmarrjes në institucione apo organizata ndërkombëtare. Është kryer vetëm një pagesë për Laboratorin kërkimor të FSHN për kryerjen e testeve të analizave në Institucione të akredituara ndërkombëtare, për procesin e akreditimit të këtij laborator

➤ **Transferta tek individët bursat e studentëve– Artikulli 606**

Bursat e studentëve. Për vitin 2020 fondi i bursave të studentëve është realizuar 87.3 % e fondit vjetor të planifikuar. Në këtë artikull përfshihen bursat financiare të studentëve (transferta tek individët) për Ciklin e parë të studimeve. Fondi është akorduar në Grantin për bursat e studentëve në fillim të vitit gjithsej **114,223 mijë** lekë. Sipas procedurës së përcaktuar nga BA në zbatim të VKM-ve për këtë qëllim, kanë paraqitur kërkesat për bursë financiare e përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 1,749 studentë.

Nga kërkesat e paraqitura janë miratuar me vendim BA-së të trajtohen me bursë financiare 1,335 studentë me fond 135,180 mijë lekë

Miratuar me Vendim Bordi Administrimi për vitin akademik 2019-2020								
Emërtimi	Viti i parë		Viti i dytë		Viti i tretë		Totali	
	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
Trajtohen me rezultate	33	2,970,000	22	1,980,000	50	4,500,000	105	9,450,000
Trajtohen kritere tjera	515	46,350,000	459	41,310,000	423	38,070,000	1,397	125,730,000
Shuma	548	49,320,000	481	43,290,000	473	42,570,000	1,502	135,180,000

Në zbatim të vendimeve për bursat janë kaluar në bankë në llogaritë e 1,216 studentëve vlera 23,738,893 lekë nga fondet e vitit 2019, ndërsa në llogaritë e 1,487 studentëve vlera 99,709,091lekë nga fondet e vitit 2020

Bursa të paguar në bankë për vitin akademik 2019-2020								
Emërtimi	Viti i parë		Viti i dytë		Viti i tretë		Totali	
	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
Trajtohen me rezultate	30	2,569,570	22	1,886,344	50	4,289,570	102	8,745,484
Trajtohen kritere tjera	508	41,284,248	457	37,971,667	423	35,446,586	1,388	114,702,501
Shuma	538	43,853,818	479	39,858,011	473	39,736,156	1,490	123,447,984
Me fondet e vitit 2019	382	6,043,839	410	8,652,688	424	9,042,366	1,216	23,738,893
Me fondet e vitit 2020	538	37,809,979	477	31,205,323	472	30,693,790	1,487	99,709,091

Nga kërkesat e miratuara nuk janë kaluar në bankë bursat financiare për 12 studentë nga të cilët 6 studentë nuk frekuentojnë në auditor ose online dhe 6 studentë nuk kanë paraqitur llogari bankare.

Bursa të papaguara në bankë për vitin akademik 2019-2020								
Emërtimi	Viti i parë		Viti i dytë		Viti i tretë		Totali	
	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
Trajtohen me rezultateNuk ka nr llogarie	2						2	
Trajtohen me rezultateNuk frekuenton	1						1	
Trajtohen me rezultate	3	0	0	0	0	0	3	0
Trajtohen kritere tjera Nuk ka nr llogarie	3		1		0		4	
Trajtohen kritere tjera Nuk frekuenton	4		1		0		5	
Trajtohen kritere tjera	7	0	2	0	0	0	9	0
Shuma	10	0	2	0	0	0	12	0

Transfertat e tjera tek individët . Për vitin 2020 janë planifikuar rimbursimi i tarifave vjetore të shkollimit që i kanë paguar studentët, ndërkohë që përfitojnë sipas vendimarrjes së Bordit të



Administrimit në zbatim të VKM-s për këtë qëllim. Fondi i transfertave i planifikuar është 7,761 mijë lekë ndërkohë që janë çelur për përdorim 13,156 mijë lekë. Ky zë shpenzimi është realizuar 59 %. Janë paguar kryesisht: rimbursimi i pagesave të tarifave nga studentët, raste fatkeqësie familjare, dalje në pension të punonjësve, sëmundje të rënda.

Transferta tek individët deri 31.10.2020			
Nr.	Lloji i transfertës	Nr rasteve	Fondi 000 lekë
1	Rimbursim tarifa shkollimi	65	1,105
2	Fatkeqësi familjare	2	60
3	Sëmundje të rënda	1	50
4	Dalje në pension	4	425
5	Tjera transferta	71	6,121
	TOTALI	100	7,761

➤ Shpenzime për investime - artikulli 230/231

Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen në formën e:

- Grant konkurrues që janë fondet që përballohen nga buxheti i shtetit. Deri në këto momente nuk janë akorduar fonde. Nga Universiteti është dërguar për konkurrim 1 objekt, vlera totale e të cilit është **699,455** mijë lekë me bashkëfinancim në vlerën 210,000 mijë lekë nga të ardhurat e Universitetit, ndërsa për vitin 2020 fondi i planifikuar për konkurrim 140,000 mijë lekë nga të ardhurat.

Është realizuar dhe TVSH për projekte të huaja në vlerën 1310 mijë lekë ose 46.7% të fondeve të parashikuara për financim, ndërsa është realizuar 98.2 % të fondeve të akorduara (çelura në Degën e Thesarit)

- Investimeve nga të ardhurat e vetë institucionit me fond 334,998 mijë lekë. Këto investime ndahen në:

- Studime e projekte – artikulli 230

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për studime e projekte, të cilat për vitin 2020 janë parashikuar 1 objekt me vlerë 4,000 mijë lekë. Deri në periudhën e analizuar është realizuar procedura e prokurimit.

- Investimet - Artikulli 231: Ndërtime, rikonstrukcion objekte ndërtimore, pajisje

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për investime për: ndërtime e rikonstrukcione objekte, blerje pajisje për auditorët e zyrat, blerje pajisje laboratorike për laboratorët mësimorë e shkencorë, fondit për librin etje.

Projektet e investimeve të financuara paraqiten në tabelën “Investime Janar-Tetor viti 2020 - të ardhurat e institucionit” dhe janë realizuar 11.7 %.

Treguesit e realizimit të investimeve janë në nivele të ulëta pasi në investimet e planifikuara vetëm një objekt zë 42.3 % të investimeve. Objekti “Ndërtim i godinës Fakultetit shkencave humane - ish materniteti” nuk është realizuar, pasi nuk është konfirmuar miratimi i financimit të këtij objekti nga KZHR.

Investimit të planifikuara për vitin 2020 janë realizuar:

Ndërtimet e reja janë realizuar 0.00 %

Rikonstrukcione janë realizuar 33.6 %

Pajisjet profesionale (laboratorike) janë realizuar 0.00 %

Pajisjet (inventar ekonomik) janë realizuar 22.00 %.

Objektet e tjera janë në proces prokurimi, ose realizimi të kontratave të lidhura. Më e detajuar paraqiten të dhënat në tabelën: “Investime Janar-Tetor viti 2020 - të ardhurat e institucionit”

➤ **Fondi për kërkimin shkencor**

Në Buxhetin e Univesitetit për kërkimin shkencor për vitin 2020 janë parashikuar në Plan Buxhetin e ndryshuar dhe të çelur fondi prej 49,536 mijë lekë nga:

- Granti konkurrues për kërkim shkencor nga Buxheti i Shtetit në vlerën 10,576 mijë lekë.
- Fondet për kërkimin shkencor nga të ardhurat e institucionit 38,960 mijë lekë.

✓ Projektet e kërkimit shkencor nga Buxheti i Shtetit

Projektet e kërkimit shkencor të financuara nga Granti konkurrues i Buxheti i Shtetit nga projektet që janë dërguar për konkurim pranë AKKSHI-t është “Krijimi i Laboratorit Digital të Anatomisë”, i cili është financiar në vlerën 10,576 mijë lekë ose 72.2 % e vleres së projektit të miratuar me Vendim të Bordit të AKKSHI-it prej 14,850 mijë lekë.

Projekte Kërkimi shkencor - UE Buxheti						
Nr.	Emërtimi i projektit	Financimi 000/ lekë				
		AKSHII	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi	Artik
1	Krijimi i Laboratorit Digital të Anatomisë	14,850	10,576	10,576	100.00	231
	Shuma	14,850	10,576	10,576	100.00	

✓ Projektet e kërkimit shkencor me të ardhurat e institucionit

Fondi për kërkimin shkencor me të ardhurat e institucionit është planifikuar në vlerën 38,960 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 12,825 mijë lekë ose 32.9 %. Gjatë periudhës së trajtuar në analizë janë realizuar vetëm 2 projekte me vlerë 12,447 mijë lekë: “Ndërtimi i Database-s së Universitetit për menaxhimin e të dhënave - mirembajtje” me vlerë 8,197 mijë lekë, “Krijimi i Laboratorit Digjital të Anatomisë” me vlerë 4,250 mijë lekë, pjesë e projektit të pafinancuar nga buxheti i Shtetit. Dy projekte të tjera janë realizuar në dhjetor të vitit 2019 dhe janë likuiduar në vitin 2020 me vlerë 378 mijë lekë. Më të detajuar projektet janë në tabelën “Projekte Kërkimi shkencor viti 2020 - të ardhura”

➤ **Projektet e Huaja**

Universiteti për vitin 2020 ka 6 projekte të huaja me gjendje monetare në bankë. Nga projektet e huaja në bankën e nivelit të dytë janë gjendje 7,558 mijë lekë. Për periudhën Janar-Tetor 2020 janë disbursuar 82,461.21 Euro ose 10,396 mijë lekë. Gjatë kësaj periudhe janë shpenzuar 5,288 mijë lekë ose 17.5 % të fondeve të parashikuara të ndara: për investime vlera 1,850 mijë lekë dhe shpenzime operative vlera 3,468 mijë lekë. Situata e projekteve:

- Projekti “Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit” ka përfunduar, është me gjendje monetare në bankë. Për gjendjen e mbetur, pritet konfirmim nga donatori për të vepruar. Ky fond mund të rikthehet tek donatori ose do të kalojnë në të ardhurat e Universiteti, për mbulimin e shpenzimeve që janë kryer nga të ardhurat e institucionit gjatë zbatimit të projektit.



- Projekti “Përmirësimi i sigurimit të cilësisë dhe Akreditimit në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri: Aplikimi i Metodologjisë të Procesit dhe Rezultateve” ka përfunduar. Nuk është mbyllur, pasi pritët disbursimi i investimeve të projektit në vlerën prej 1,460 mijë lekë, e cila është financuar nga të ardhurat e institucionit për likuidimin e blerjes së pajisjeve të pajisjet e projektit.
- Projekti “REBUS - Ngritja e biznesit - Integrimin dhe vlerësimi i aftësive praktike të ndërmarrësisë në inxhinieri dhe TIK” , ka përfunduar në vitin 2019. Gjatë kësaj periudhe janë disbursuar dhe shpenzuar disa shërbime të përfunduara.
- Projekti “TEA VET-Zhvillimi kompetencave të mësimdhënies në Shqipëri” , përfundon në vitin 2020. Gjatë kësaj periudhe kanë mbetur disa shërbime të papërfunduara për vlerën 637 mijë lekë .
- Projekti “T@SK - Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësisë dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale” përfundon në vitin 2020. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shpenzime për investime në vlerën 615 mijë lekë dhe shpenzime operative 895 mijë lekë. Ky projekt ka në në fund të periudhës vlerën 3,293 mijë lekë .
- Projekti “E-VIVA-Përmirësimi dhe vlerësimi i kompetencave të lidhura me shërbime në mjedise të ndryshme të të mësuarit në Universitetet e Ballkanit Perëndimor” përfundon në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shpenzime për investime në vlerën 1,235 mijë lekë dhe shpenzime operative 1,336 mijë lekë. Ky projekt ka në në fund të periudhës vlerën 2,090 mijë lekë .
- Projekti “BEKSTONE-Platforma e sipërmarrjeve të Arsimit të lartë për nxitjen, modernizimin dhe rritjen e qëndrueshme në industrinë e gurit natyror në vendet e Ballkanit Perëndimor” ka filluar në vitin 2020 dhe përfundon në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe nuk janë kryer shpenzime për investime dhe shpenzime operative. Ky projekt ka në në fund të periudhës vlerën 4,519 mijë lekë .
- Projekti “VALEU-X,-Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare” ka filluar në vitin 2020 dhe përfundon në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shpenzime për investime , të cilat nuk janë likuiduar ndërsa shpenzime operative në vlerën 2 mijë lekë. Ky projekt ka në në fund të periudhës vlerën 1,434 mijë lekë .

Më të detajuara projektet e huaja paraqiten në tabelën “Projekte huaja - UE Janar - Tetor 2020”

Realizimi i Buxhetit për vitin 2020 Fakti i 10 mujorit

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Financim i brendshëm			Granti			Të ardhura			Total Buxheti		
			Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%
1	Paga e shperblime	600	0	0	0.0	571,587	302,364	52.9	28,113	0	0.0	599,701	302,364	50.4
-	Pagat	600	0	0	0.0	496,481	298,375	60.1	0	0	0.0	496,481	298,375	60.1
-	Honorare - oret	600	0	0	0.0	75,106	3,989	5.3	28,113	0	0.0	103,219	3,989	3.9
2	Sig. Shoqërore	601	0	0	0.0	69,305	49,167	70.9	4,876	0	0.0	74,182	49,167	66.3
3	Shpenzime operative	602	0	0	0.0	113,036	72,698	64.3	36,964	6,414	17.4	150,000	79,112	52.7
4	Transf. me jashtë	605	0	0	0.0	0	0	0.0	900	344	38.2	900	344	38.2
5	Transf._individët	606	0	0	0.0	0	0	0.0	13,156	7,761	59.0	13,156	7,761	59.0
6	Bursa	606	0	0	0.0	114,223	99,709	87.3	0	0	0.0	114,223	99,709	87.3
7	Kërkimi shkencor	0	10,576	10,576	100.0	0	0	0.0	38,960	12,825	32.9	49,536	23,401	47.2
-	Kërkimi shkencor	230	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Kërkimi shkencor	231	10,576	10,576	100.0	0	0	0.0	4,250	4,250	100.0	14,826	14,826	100.0
-	Kërkimi shkencor	602	0	0	0.0	0	0	0.0	33,793	8,575	25.4	33,793	8,575	25.4
-	Kërkimi shkencor	606	0	0	0.0	0	0	0.0	917	0	0.0	917	0	0.0
8	Investime	0	1,333	1,310	98.2	0	0	0.0	334,998	38,573	11.5	336,331	39,883	11.9
a	Stud. Projekt.	230	0	0	0.0	0	0	0.0	4,000	0	0.0	4,000	0	0.0
b	Investime trupëz.	231	1,333	1,310	98.2	0	0	0.0	330,998	38,573	11.7	332,331	39,883	12.0
-	Ndërtime të reja	231	0	0	0.0	0	0	0.0	194,676	0	0.0	194,676	0	0.0
-	Rikonstruksione	231	0	0	0.0	0	0	0.0	99,475	33,427	33.6	99,475	33,427	33.6
-	Instalime rrjete	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Makineri teknologjike	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Paisje profesionale	231	0	0	0.0	0	0	0.0	13,470	0	0.0	13,470	0	0.0
-	Paisje inventar ekonomik	231	0	0	0.0	0	0	0.0	23,378	5,146	22.0	23,378	5,146	22.0
-	TVSH projekte pajisje	231	1,333	1,310	98.2	0	0	0.0	0	0	0.0	1,333	1,310	98.2
-	Mjete transporti	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
9	Projekti huaja	0	30,134	5,288	17.5	0	0	0.0	0	0	0.0	30,134	5,288	17.5
-	Grante korente	604	16,108	3,438	21.3	0	0	0.0	0	0	0.0	16,108	3,438	21.3
-	Investime	231	14,026	1,850	13.2	0	0	0.0	0	0	0.0	14,026	1,850	13.2
	Totali		42,042	17,173	40.8	868,151	523,938	60.4	457,969	65,917	14.4	1,368,162	607,028	44.4



Projekte huaja - UE Janar - Tetor 2020

Nr.	Emërtimi i projektit	Viti i		Statusi	Financimi lekë										1 €=127 lekë			
		Filli- mit	Mbari- mit		Gjendja ne banke 01.01.20 20	Parashikuar për vitin 2020				Disbursuar		Total në Lekë	Shpenzime e realizuara (ne leke)			Gjendj e në bankë 31.10. 2020		
						Gjendj e + disburs im	Shpenz ime korente	Shpenzi me kapitale	Total	në EUR	në Lekë		Shpen zime korent e	Shpen zime kapita le	Total			
1	Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit	2013	2016	Ka përfunduar, nuk është mbyllur	701	701	701	0	701	0	0	701	6	0	6	695		
2	Përmirësimi i sigurimit të cilësisë dhe Akreditimit në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri: Aplikimi i Metodologjisë të Procesit dhe Rezultateve	2014	2016	Ka përfunduar, nuk është mbyllur	0	1,460	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
3	REBUS - Ngritja e biznesit - Integrimin dhe vlerësimi i aftësive praktike të ndërmarrësisë në inxhinieri dhe TIK	2016	2019	Në vazhdim	6	1,075	1,075	0	1,075	7,489	951	957	957	0	957	0		
4	TEA VET-Zhvillimi kompetencave të mësimdhënies në Shqipëri	2017	2020	Në vazhdim	878	3,079	1,664	1,415	3,079	0	0	878	241	0	241	637		
5	T@SK - Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësisë dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale	2017	2020	Në vazhdim	4,803	6,711	6,711	0	6,711	0	0	4,803	895	615	1,510	3,293		
6	E-VIVA-Përmirësimi dhe vlerësimi i kompetencave të lidhura me shërbime në mjedise të ndryshme të të mësuarit në Universitetet e Ballkanit Perëndimor	2019	2021	Në vazhdim	1,171	4,851	1,422	3,429	4,851	28,083	3,490	4,661	1,336	1,235	2,571	2,090		
7	BEKSTONE-Platforma e sipërmarrjeve të Arsimit të lartë për nxitjen, modernizimin dhe rritjen e qëndrueshme në industrinë e gurit natyror në vendet e Ballkanit Perëndimor	2020	2021	Fillon	0	5,811	1,810	4,001	5,811	35,583	4,519	4,519	0	0	0	4,519		
8	VALEU-X,-Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare	2020	2021	Fillon	0	7,907	2,725	5,182	7,907	11,307	1,436	1,436	2	0	2	1,434		
	Shuma	0	0	0	7.558	31.593	16.108	14.026	30.134	82.461	10.396	17.955	3.438	1.850	5.288	12.667		



Projekte Kërkimi shkencor viti 2020 - të ardhura000/Lekë

Nr.	Emërtimi i projektit	Plan	Fakt	%	Art
1	Ndërtimi i Database-s së Universitetit për menaxhimin e të dhënave - mirembajtje	12,000	8,197	68.31	602
2	Kërkim shkencor - projekte te ndryshme 2019	138	0	0.00	602
3	Kërkim shkencor - projekte te ndryshme	917	0	0.00	606
4	Kërkim shkencor - projekte te ndryshme	0	0	0.00	230
5	Përdorimi i testeve ekotoksikologjike në hartimin e strategjive të përshtatshme të mbrojtjes së mjedisit	505	0	0.00	602
6	Përcaktimi i cilësive fiziko - kimike të tokave	720	0	0.00	
7	"Geogebra - një mënyrë dinamike për të shpjeguar dhe mësuar matematikë në arsimin parauniversitar	600	0	0.00	602
8	"Vlerësimi i ndotjes së ajrit nga metalet e rënda në zonën e Elbasanit"	370	0	0.00	602
9	"Vlerësimi i diversitetit ekologjik në disa mjedise serpentinore në Rajonin e Elbasanit"	640	0	0.00	
10	"Vlerësimi i toksicitetit të ujit të lumit shkumbin në jetën e organizmave ujorë si pjesë e strategjive në mbrojtjen e mjedisit"	1,100	0	0.00	602
11	"Kongresi i 12-të Ndërkombëtar në Specialitetet Mjekësore"	700	0	0.00	602
12	"Ndergjegjësimi, diagnostikimi dhe trajtimi i hershem i patologjive malinje te traktit gastrointestinal dhe patologjive interne"	700	0	0.00	602
13	"Fjale dhe shprehje për çdo rast"	800	0	0.00	602
14	"Konferenca e II e Ballkanit përëndimor mbi shkencat matematike "	1,300	0	0.00	602
15	"Studimi efikasitetit dhe realizimi i përdorimit të sistemeve fotovoltaike në mjedise të ndryshme"	600	0	0.00	602
16	"Kijimi i laboratorit të pedagogjisë që integron teknologjinë e informacionit dhe komunikimit"	500	0	0.00	602
17	"Zhvillimi i tërësisë së kompetencave të studentit në mjedisin shkollor dhe i perceptimeve të tij për praktikat profesionale"	500	0	0.00	602
18	"Kompetenca digitale si kërkesë e kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar dhe realiteti shkollor"	150	0	0.00	602
19	"Kontributi i flamurit të Arbërit 1887 - 1917 pas 130 vjetësh"	630	0	0.00	602
20	"Figura të njohura të historiografisë në Elbasan"	500	0	0.00	602
21	"Vlerat turistike të monumenteve të kulturës në trevën e Elbasanit"	500	0	0.00	602
22	"Studim mbi përpunueshmërinë e planeve mësimore që ofron Financë - kontabiliteti me nevojat që ka tregu"	500	0	0.00	602
23	"Identifikimi i potencialit që ofron agroturizmi në zonën e Dumresë"	400	0	0.00	602
24	"E drejta e krahasuar e vendeve të Europës Juglindore"	500	0	0.00	602
25	"Promovimi i programeve të studimit për studentët e FE (Ditët e hapura)"	500	0	0.00	602
26	"Gjuha rome në trevat shqipfolëse"	830	0	0.00	602
27	"Krijimi i laboratorit të pedagogjisë që integron teknologjinë e informacionit dhe komunikimit"	600	0	0.00	602
28	"Konferencë për edukimin qytetar"	400	0	0.00	602
29	"Krijimi i zyrës së këshillimit që integron teorinë dhe praktikën e ushtrimit të psikologjisë"	500	0	0.00	602
30	"Krijimi dhe vënia në funksion e Qendrës Audio si kusht për zhvillimin e laboratorit analitik"	700	0	0.00	602
31	"Konferencë për shkencat sociale"	500	0	0.00	602
32	"Ëorkshop - edukimi fizik e sportet"	300	0	0.00	602
33	"Konferencë shkencore ndërkombëtare në psikologji"	450	0	0.00	602
34	"Bashkëpunimi ekonomik rajonal dhe harmonizimi i legjislacionit si premisë e integritetit evropian të shteteve të Ballkanit Perëndimorë" - Konferenca e 8-të Ndërkombëtare	520	0	0.00	
35	"Kujtesa kolektive në letërsi dhe media"	400	0	0.00	602
36	"Musa Vyshka-një zë i spikatur në poezinë e sotme shqipe"	354	0	0.00	602
37	"Konferenca e 6-të Ndërkombëtare infermiore në Specialitete"	700	126	18.07	602
38	"Konferenca e II-të ndërkombëtare në Logopedi dhe Fizioterapi"	700	0	0.00	602
39	"Kontributi i Austrisë në mjedisin intelektual elbasanas "	886	0	0.00	602
40	"Elbasani në vitet 1945-1955 -dokumente arkivore "	200	0	0.00	602
41	"Dora D'Istra-portreti i një princeshe të harruar"	200	0	0.00	602
42	"Konferenca e I-rë ndërkombëtare studentore në UE"	700	252	35.98	602
43	"Krijimi i Laboratorit Digjital të Anatomisë"	4250	4,250	100.00	602
	Shuma	38,960	12,825	32.92	



Investime Janar-Tetor viti 2020 - të ardhurat e institucionit				
Nr.	Emërtimi i projektit	Fondi 000/ lekë		
		Plani	fakti	%
I	Studime e projekte	4,000	0	0.00
1	Projekt + preventiv "Ndertim i godinës Fakultetit shkencave humane " - ish materniteti" - ndryshim projekti	4,000	0	0.00
II	Ndërtime të reja	194,676	0	0.00
1	"Ndertim i godinës Fakultetit shkencave humane " - ish materniteti	180,000	0	0.00
2	Mbikqyrje "Ndertim i godinës Fakultetit shkencave humane" - ish materniteti	4,368	0	0.00
3	Kolaudim "Ndertim i godinës Fakultetit shkencave humane" - ish materniteti	0	0	0.00
4	"Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	960	0	0.00
5	Mbikqyrje - "Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	17	0	0.00
6	Kolaudim - "Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	2	0	0.00
7	Ndërtim - "Shkallë emergjence godinat e UE"	9,149	0	0.00
8	Mbikqyrje - "Shkallë emergjence godinat e UE"	161	0	0.00
9	Kolaudim - "Shkallë emergjence godinat e UE"	19	0	0.00
III	Rikonstruksione	99,475	33,427	33.60
1	Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim Godina A , Korpusi Kryesor - fasada xhamit"	12,866	0	0.00
2	Mbikqyrje - "Aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit"	258	0	0.00
3	Kolaudim - "Aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit"	31	0	0.00
4	"Rikonstruksion salla 120 FSHMT, salla 101 FE"	36,805	32,875	89.32
5	Mbikqyrje - "Rikonstruksion salla 120 FSHMT, salla 101 FE"	556	493	88.71
6	Kolaudim - "Rikonstruksion salla 120 FSHMT, salla 101 FE"	67	59	88.71
7	"Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	7,150	0	0.00
8	Mbikqyrje - "Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	143	0	0.00
9	Kolaudim - "Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	17	0	0.00
10	"Rikonstruksion laboratorit Kërkimor FSHN"	19,125	0	0.00
11	Mbikqyrje - "Rikonstruksion laboratorit Kërkimor FSHN"	330	0	0.00
12	Kolaudim - "Rikonstruksion laboratorit Kërkimor FSHN"	40	0	0.00
13	Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	21,648	0	0.00
14	Mbikqyrje - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	393	0	0.00
15	Kolaudim - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	47	0	0.00
IV	Paisje inventar ekonomik	23,378	5,146	22.01
1	Pajisje kompjuterike e fotokopje	13,000	5,042	38.79
2	Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra	9,000	0	0.00
3	Fond libri biblioteka	1,258	0	0.00
4	Pajisje pune	120	104	86.58
V	Paisje profesionale	13,470	0	0.00
1	Pajisje laboratorike	13,470	0	0.00
2	Pajisje e audiovizive, U. Elbasan	0	0	0.00
VI	Mjete transporti	0	0	0.00
1	Mjete tjera transp	0	0	0.00
VII	Projekte të huaja	0	0	0.00
1	Pagesë TVSH për investime	0	0	0.00
2	Pajisje për projektet e huaja	0	0	0.00
	Shuma	334,998	38,573	11.51



3. Plani buxhetor njëvjeçar viti 2021

P/Buxhetin për vitin 2021 po e paraqesim në mënyrë analitike si më poshtë:

3.1 Të ardhura - hyrjet e fondeve

3.2 Shpenzimet

3.1. Të ardhura – hyrjet e fondeve

Të ardhura për universitetin – hyrjet e fondeve në institucione, bëjnë pjesë: Granti për shpenzime korente, Granti konkurrues, bursat finaciare të studentëve dhe të ardhurat e vetë institucionit, të cilat janë:

➤ Granti (Fonde të pakushtëzuara) + Financime të huaja

Nr	Emërtimi i projektit	000/lekë
I	Grante	1,134,749
1	Grante për shpenzime korente	832,865
2	Grante për investime	300,000
3	Kërkim shkencor	0
4	TVSH-projekte të huaja	1,884
II	Financime të huaja	15,435
1	Financime të huaja	15,435
TOTALI		1,150,184

Financimi i pritshëm nga Grantet për vitin 2021 dhe financimet e huaja parashikohen në vlerën **1,150,184mijë** lekë, me burime financimi:

- Grante me vlerë 1,134,749mijë lekë të cilët ndahen:
- Granti dhe bursat e studentëve është me vlerë 832,865mijë lekë nga e cila;
 1. Grante korente, për të mbuluar shpenzimet e aktivitetit të institucionit me vlerë 696,065 mijë lekë
 2. Bursat me vlerë 136,800mije lekë
- Grant konkurrues – fondet për investime. Ky fond është parashikuar 300,000 mijë lekë për të cilin do të paraqiten projektet për konkurrim.
- Kërkimi shkencor me vlerë 0 mijë lekë
- TVSH-projekte të huaja me vlerë 1,884 mijë lekë
- Fond nga financime të huaja me vlerë 15,435 mije lekë

➤ **Të ardhura të institucionit**


Fonde të kushtëzuar – të ardhurat e institucionit për vitin 2021 parashikohen 240,000 mijë lekë.

Në tabelë paraqiten më të detajuara burimet e krijimit të tyre dhe përdorimi.


TE ARDHURAT E INSTITUCIONIT PER VITIN 2021						
KRIJIMI			SHPERNDARJA			
Nr.	Emërtimi	000/Lekë	Emërtimi		000/Lekë	
1	Qeratë	520	Totali		240,000	
2	Bach. koha plotë	79,859	A. Përdorimi	Studim projekte	230	0
3	M. Profesional	91,115		K. shkencor - 230	230	24,600
4	M. Shkencor	44,574		K. shkencor - 231	231	0
5	Doktoraturë	1,041		K. shkencor - 602	602	36,524
6	Libreza Diploma etj.	4,287		Investime	231	667
7	Lëshim dokumenti	5,000		Paga e shpërblime	600	89,559
8	Taksë regjstrimi	5,979		Sigurime shoqërore	601	50,000
9	Tarifa konkurimi	500		Shpenzime operative	602	5,000
10	Të tjera	3,125		Transf. jashtë	605	14,000
11	Pjesm. konferenca	4,000		Transf. tek individë	606	900
			B. Pa përdorur			0
	TOTALI	240,000	C. Trashëgohen			0



Të ardhurat - viti 2021



Mbledhja e të ardhurave është llogaritur duke u bazuar në të dhënat e parashikuara për numrin e studentëve që do të vazhdojnë studimet në vitin akademik 2020 – 2021; për studentët në vazhdim, parashikimin e regjistrimeve për vitin e parë. Gjithashtu janë llogaritur edhe studentët të cilët janë regjistruar në vitet e mëparshme dhe nuk kanë përfunduar (studentët përsëritës). Përlllogaritjet janë bazuar në Vendimet e Bordit të Administrimit për tarifat e shkollimit në Bachelor, tarifat për kredit në Ciklin e dytë Master, tarifat e konkurimit, tarifat e regjistrimit për vitin akademik 2020 – 2021.



Peshën specifike më të madhe në të ardhurat e zenë

- tarifat e shkollimit rreth 90.3 % nga të cilat:
 - Bachelor 33.3 %
 - M. Profesional 38.0 %
 - M. i Shkencave 18.6 %
 - Doktoraturë 0.4 %
- Tarifat e regjistrimit 2.5 %
- Tarifa konkurimi 0.2 %




- Qira 0.2 %
- Të ardhura të tjera 6.8 % (lëshim dokumenti, libreza, diploma, pagesa pjesmarrje në konferenca)

Nga zbatimi i akteve nënligjore për shtresave të ndryshme sociale në Universitet përfitojnë afërsisht nga 1,988 deri në 2,006 studentë në çdo vit akademik me një efekt rreth 44,489 mijë – 45,093 mijë lekë, gjë e cila ndikon në një realizim më të ulët të të ardhurave.

Shpërndarja – përdorimi i të ardhurave mund të përmbledhet në këto grupe kryesore

Grupimet kryesore të financimit nga të ardhurat		
Nr	Emërtimi i projektit	Fondi në 000 lekë
1	Fondet të kushtëzuara për shpenzime korente	88,650
2	Fonde të kushtëzuara për investime	89,559
3	Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj	0
4	Fonde të kushtëzuara për projekte e kërkim shkencor	61,791
TOTALI		240,000



Përdorimi i të ardhurave, viti 2021

3.2 Shpenzimet

Fondet e hyra në Universitet nga Granti, transfertat, të ardhurat që krijon vetë institucioni projektet e huaja, duke i ndarë sipas zërave të shpenzimeve buxhetore përbëjnë P/Buxhetin e shpenzimeve të vitit 2021.

<i>P/BUXHETI PER VITIN 2021</i>						
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi shpenzimit</i>	<i>Artik.</i>	<i>Grant</i>	<i>Projekte huaja</i>	<i>Të ardhura institucionit</i>	<i>Total Buxheti</i>
1	Paga e shperblime	600	490,982	0	50,000	540,982
-	Pagat		375,691	0	50,000	425,691
-	Honorare - oret		115,291	0	0	115,291
2	Sig. Shoqërore	601	64,084	0	5,000	69,084
3	Shpenzime operative	602	141,000	0	14,000	155,000
4	Transf. me jashtë	605	0	0	900	900
5	Transf. individet	606	0	0	18,750	18,750
6	Bursa	606	136,800		0	136,800
7	Kërkimi shkencor		0	0	61,791	61,791
-	Kërkimi shkencor	230	0	0	24,600	24,600
-	Kërkimi shkencor	231	0	0	0	0
-	Kërkimi shkencor	602	0	0	36,524	36,524
-	Kërkimi shkencor	606	0	0	667	667
8	Investime	230 - 231	300,000	0	89,559	389,559
a	Stud. Projekt.	230	0	0	0	0
b	Investime trupëz.	231	300,000	0	89,559	389,559
-	Ndërtime të reja	231	300,000	0	31,559	331,559
-	Rikonstruksione	231	0	0	0	0
-	Instalime rrjete	231	0	0	0	0
-	Makineri teknologjike	231	0	0	0	0
-	Paisje profesionale	231	0	0	25,000	25,000
-	Paisje inventar ekonomik	231	0	0	33,000	33,000
-	Mjete transporti	231	0	0	0	0
9	Projekte të huaja	230-231-602	1,884	15,435	0	17,319
-	Shpenzime korente	604	1884	6,016	0	7,900
-	Shpenzime Investime	231	0	9,419	0	9,419
-	Rimbursim të ardhura	231	0	0	0	0
	Totali		1,134,749	15,435	240,000	1,390,184

➤ Për artikullin paga e shpërblime – Art. 600

Për Universitetin nevojitet fond page rreth 540,982 mijë lekë mbështetur në llogaritjet, sipas ecurisë së numrit mesatar të punonjësve, numrit të punonjësve sipas strukturës së miratuar nga BA dhe realizimit të pritshëm të pagave për vitin 2020. Këtu përfshihet edhe fondi i veçantë, i llogaritur mbi fondin e pagave. Në fondin e pagave është marrë në konsideratë efekti i pagesës së orëve të punës mbi kohën normale, për menaxhimin e procesit mësimor, i cili zhvillohet jashtë kohës normale të punës. Llogaritjet janë vetëm për stafin mbështetës (punonjësit e shërbimeve).

Fondi i përgjithshëm i pagave në vlerën 540,982 mijë lekë është i përbërë nga:

- Fondi i pagave nga Granti për shpenzime korente në vlerën 490,982 mijë lekë.
- Fondi i pagave nga të ardhurat e institucionit në vlerën 50,000 mijë lekë.



Në fondin e pagave përfshihet edhe shpërblimi për orët suplementare që do të zhvillohen nga punonjësit akademikë efektivë dhe pagesa e pedagogëve të jashtëm, sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”,

Nr	Emërtimi i pagesës	Orë	lek/orë	Vlera	Sig. Shoq.	Shuma
				000/lekë	000/lekë	000/lekë
1	Pagesa e pedagogëve brendshëm	70,334	1059	74,514	12,444	86,958
2	Pagesa e pedagogëve jashtëm	22,926	1059	24,279	4,055	28,333
	Totali fondi për orë	93,260		98,793	16,498	115,291

➤ **Për artikullin fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore Art. 601**

Fondi i llogaritur për sigurime shoqërore e shëndetësore prej 69,084 mijë lekësh përballon nevojat deri në fund të vitit. Ky fond është parashikuar në vlerën 64,084 mijë lekë të përballohet nga granti , ndërsa në vlerën 5,000 mijë lekë nga të ardhurat.

➤ **Për artikullin shpenzime operative Art. 602**

Shpenzimet operative janë planifikuar në vlerën 155,000 mijë lekë dhe do të përballohen nga:

- Nga Granti në vlerën 141,000 mijë lekë.
- Të ardhurat e vetë institucionit në vlerën 14,000 mijë lekë.

Planifikimi në këto nivele do të mundësojë përballimin e shpenzimeve në rritje në disa zëra, si: energji, ujë, telefon; në shërbimet që dalin të detyruara, si p.sh. shpenzimet për rojet private, shpenzimet për internetin si dhe shpenzime për mirëmbajtje. Vendosja e sistemit të ngrohjes qendrore në tërë godinat do të paraqesë nevojën për shpenzime për lëndë djegëse. Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga fakti i artikujve të vitit të kaluar, nga realizimi i pritshëm i këtij viti, si dhe nga kërkesat për disa lloj shpenzimesh.

Nevoja për ekspedita është shumë më e lartë, megjithatë kemi parashikuar nivelin e ditëve për ekspedita të viteve, duke përballuar rritjet që vijnë nga ndryshimet e numrit të studentëve..

Në zërat e shpenzimeve operative janë përfshirë edhe shpenzimet që mbështesin zhvillimin e konferencave të ndryshme (pritje përcjellje, fjetje në hotel e të huajve, mbajtjen e kumtesave). Ky zë është parashikuar nga eksperiencia e mëparshme, si dhe kërkesat e njëjësive bazë. Gjithashtu në shpenzimet operative janë llogaritur dhe udhëtim e dieta me jashtë vëndit, në kuadër të zbatimit të marrëveshje të lidhura me Universitete të huaja.

Artikulli	Emertimi	Fakti i vitit 2019		I pritshmi i vitit 2020		Parashikimi për vitin 2021			Parashikimi 2022	Parashikimi 2023
		Buxheti	Nga te ardhurat	Buxheti	Nga te ardhurat	Limiti	Kerkesa	Nga te ardhurat	Kerkesa	Kerkesa
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
602.0	Materiale zyre dhe te pergjithshme	0	5,945	4,026	7,320	7,320	1,560	5,760	7,320	7,320
602.1	Materiale dhe sherbime speciale	0	1,245	0	11,300	10,460	8,180	2,280	9,060	9,060
602.2	Sherbime nga te trete	34,434	23,359	70,384	7,320	81,540	79,940	1,600	85,920	85,920
602.3	Shpenzime transporti	0	2,745	5,640	640	6,240	6,000	240	6,240	6,240
602.4	Shpenzime udhetimi	0	7,931	9,010	0	14,500	13,500	1,000	16,000	16,000
602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	0	9,701	6,036	8,904	14,440	14,200	240	14,400	14,400
602.6	Shpenzime per qiramarrje	0	3,237	3,480	0	3,480	3,000	480	3,480	3,480
602.9	Shpenzime te tjera operative	8,530	5,827	14,460	1,480	17,020	14,620	2,400	17,580	17,580
	Totali	42,964	59,991	113,036	36,964	155,000	141,000	14,000	160,000	160,000



➤ **Për artikullin transferta të jashtme Art. 605**

Ky artikull është planifikuar për përballimin e shpenzimeve të anëtarësimit në institucionet ndërkombëtare, si për universitetin ashtu dhe për fakultetet. Parashikimi i këtij zëri është kryer në mënyrë të përafërt vetëm nga eksperiencia e viteve, pasi nuk janë paraqitur kërkesa për transferta të tilla nga zbatimi i marrëveshjeve me Universitete të huaja apo institucione kërkimore – shkencore ndërkombëtare

➤ **Për artikullin bursat e studentëve dhe transferta tek individët Art. 606**

Në këtë artikull siç është theksuar përfshihen transferta tek individët. Fondi gjithsej është **155,550 mijë** lekë dhe përbëhet nga:

- **Bursat e studentëve.** Fondi i parashikuar për bursat e studentëve – financimi transferta tek individët është 136,800 mijë lekë. Universiteti parashikon për të trajtuar me bursë financiare rreth 1,520 studentë duke ju referuar gjendjes aktuale të vitit në vazhdim. Ky fond përballohet nga buxheti i shtetit.
- **Rimbursime të pagesave të studentëve.** Sikurse u theksua në përlogaritjen e të ardhurave, nga zbatimi i akteve nënligjore për shtresave të ndryshme sociale në Universitet përfitojnë afërsisht nga 1,738 deri në 2,006 studentë në çdo vit akademik të ciklit të parë të studimeve, si dhe reduktimi i tarifave në ciklin e dytë të studimeve për vitin aktual. Nëse këto tarifa do të paguhen paraprakisht nga studentët, para aplikimit për përfitimin e kësaj tarife, Universiteti e rimburson këtë pagesë. Nga eksperiencat e viteve për rimbursimin e tarifave ky fond është planifikuar rreth 18,750 mijë lekë.

➤ **Për artikullin investime Art. 230/231**

Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen në formën e:

- Investimeve nga Granti konkurrues.
Për investime nga Granti konkurrues është parashikuar një objekt për vitin 2020-2021 “Ndërtim i godinës Fakultetit shkencave humane’ - ish materniteti” me vlerë të përgjithshme 699,455 mijë lekë: vlera 210,000 mijë lekë të përballohet nga të ardhurat, ndërsa vlera prej 489,455 mijë lekë nga granti konkurrues.

Financim	Emërtimi projektit	Fondi 000 lekë		
		Total	2020	2021
Të ardhura	"Ndërtim i godinës Fakultetit shkencave humane " - ish materniteti	210,000	180,000	30,000
Buxhet	"Ndërtim i godinës Fakultetit shkencave humane " - ish materniteti	489,455	189,455	300,000
	Ndërtim i godinës Fakultetit shkencave humane " - ish materniteti	699,455	369,455	330,000

- Investimeve nga të ardhurat e vetë institucionit.
Objektet me financim nga të ardhurat për vitin 2021 janë kryesisht:
 - Ndërtime të reja në vlerën 31,559 mijë lekë:
 - “Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane’ - ish materniteti” është parashikuar nga buxheti i shtetit në vlerën 489,455 mijë lekë dhe me pjesëmarrjen e universitetit në vlerën 210,000 mijë lekë. Për vitin 2021 fondi është llogaritur 30,000 mijë lekë.



- Mbikqyrje-"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane' - ish materniteti". Për objektin e mësipërm është llogaritur fondi për subvencionimin në vlerën 6,718 mijë lekë, sikurse kërkohet në aktet nënligjore për ndërtimin. Për këtë kontratë është parashikuar fondi 5,998 mijë lekë për vitin 2020 dhe fondi 720 mijë lekë për vitin 2020.
- Kolaudim -"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane' - ish materniteti". Për objektin e mësipërm është llogaritur fondi për kolaudimin në vlerën 839 mijë lekë, sikurse kërkohet në aktet nënligjore për ndërtimin. Për këtë kontratë është parashikuar fondi 839 mijë lekë për vitin 2021.
- Pajisje në vlerën 26,636 mijë lekë.
 - "Pajisje kompjuterike e fotokopje" me fond rreth 15,000 mijë lekë; kryesisht për përmirësimin pajisjeve kompjuterike për stafin akademik, krijimin e laboratorëve të rinj nëpër fakultete si dhe përmirësimin e laboratorëve ekzistues.
 - "Pajisje e orendi për auditore laboratorë e zyra" me fond rreth 15,000 mijë lekë, kryesisht për përmirësimin pajisjeve ekzistuese për stafin akademik, mjediseve mësimore nëpër fakultete.
 - Pajisje laboratorike rreth 25,000 mijë lekë. Ky fond është parashikuar për të përballuar kërkesat e departamenteve me projekte për laboratorë mësimorë.
- Fond libri për bibliotekën rreth 3,000 mijë lekë për pasurimin me fond libri të Bibliotekës Qendrore dhe bibliotekave në fakultete, sipas kërkesave të departamenteve.

Investimet në vitet 2021-2023

000/lekë

Financimi	Emertimi i projektit te investimit	Vlera e projektit	Buxheti 2020	Projektbuxheti 2021	Projektbuxheti 2022	Projektbuxheti 2023
	Ndërtime të reja	881,167	385,761	331,559	81,710	82,138
Ardhura	"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti	210,000	180,000	30,000	0	0
Buxhet	"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti	489,455	189,455	300,000	0	0
Ardhura	Mbikqyrje "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane" - ish materniteti	6,718	5,998	720	0	0
Ardhura	Kolaudim "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane" - ish materniteti	839	0	839	0	0
Ardhura	"Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	960	960	0	0	0
Ardhura	Mbikqyrje - "Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	17	17	0	0	0
Ardhura	Kolaudim - "Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	2	2	0	0	0
Ardhura	Ndërtim - "Shkallë emergjence godinat e UE"	9,149	9,149	0	0	0
Ardhura	Mbikqyrje - "Shkallë emergjence godinat e UE"	161	161	0	0	0
Ardhura	Kolaudim - "Shkallë emergjence godinat e UE"	19	19	0	0	0
Buxhet	Ndërtim Fakulteti ekonomik, Godina C + parkim nëntoksor	161,879	0	0	80,940	80,940
Ardhura	Mbikqyrje kolaudim "Ndërtim Fakulteti ekonomik, Godina C + parkim nëntoksor"	1,968	0	0	770	1,198
	Rikonstruksione	120,324	99,475	0	0	20,849
Ardhura	Rrethim Kampusi universitar (Krasta)	20,434	0	0	0	20,434
Ardhura	Mbikqyrje kolaudim Rrethim Kampusi universitar (Krasta)	415	0	0	0	415
Ardhura	Rikonstruksion - "Rikonstruksio aspirim kondicionim Godina A , Korpusi Kryesor - fasada xhamit"	12,866	12,866	0	0	0
Ardhura	"Rikonstruksion salla 120 FSHMT, salla 101 FE"	36,805	36,805	0	0	0
Ardhura	Mbikqyrje - "Rikonstruksion salla 120 FSHMT, salla 101 FE"	556	556	0	0	0
Ardhura	Kolaudim - "Rikonstruksion salla 120 FSHMT, salla 101 FE"	67	67	0	0	0



Ardhura	Mbikqyerje - "Rikonstruksio aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit"	258	258	0	0	0
Ardhura	Kolaudim - "Rikonstruksio aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit"	31	31	0	0	0
Financimi	Emertimi i projektit te investimit	Vlera e projektit	Buxheti 2020	Projektbuxheti 2021	Projektbuxheti 2022	Projektbuxheti 2023
Ardhura	"Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	7,150	7,150	0	0	0
Ardhura	Mbikqyerje - "Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	143	143	0	0	0
Ardhura	Kolaudim - "Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	17	17	0	0	0
Ardhura	"Rikonstruksion laborator Kërkimor FSHN"	19,125	19,125	0	0	0
Ardhura	Mbikqyerje - "Rikonstruksion laborator Kërkimor FSHN"	330	330	0	0	0
Ardhura	Kolaudim - "Rikonstruksion laborator Kërkimor FSHN"	40	40	0	0	0
Ardhura	Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	21,648	21,648	0	0	0
Ardhura	Mbikqyerje - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	393	393	0	0	0
Ardhura	Kolaudim - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	47	47	0	0	0
	Paisje inventar ekonomik	122,378	23,378	33,000	23,000	43,000
Ardhura	Pajisje kompjuterike e fotokopje	58,000	13,000	15,000	10,000	20,000
Ardhura	Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra	54,000	9,000	15,000	10,000	20,000
Ardhura	Fond libri biblioteka	10,258	1,258	3,000	3,000	3,000
Ardhura	Pajisje pune	120	120	0	0	0
	Paisje profesionale	86,970	13,470	25,000	10,000	38,500
Ardhura	Pajisje laboratorike	86,970	13,470	25,000	10,000	38,500

➤ Për fondin e kërkimit shkencor

Fondi për kërkimin shkencor është parashikuar, sipas të dhënave të dërguara nga fakultetet për PBA 2021 – 2023 për kërkimin shkencor ku janë reflektuar draft projektet me emërtimet dhe vlerat e përafërta të përcaktuara prej drejtuesve kërkimorë. Deri në përgatitjen e Buxhetit 2021 nga secili prej drejtuesve do të paraqiten projektet sipas modelit të përcaktuar nga AKKSHI duke plotësuar të gjitha rubrikat përfshirë edhe planin financiar të detajuar sipas kërkesave të akteve në zbatim të ligjit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin. Më të detajuara fondet e kërkimit shkencor janë në tabelë:

Kërkimi shkencor në vitet 2021-2023

000/lekë

Financimi	Emertimi i projektit te investimit	Vlera e projektit	Buxheti i 2020	Projekti 2021	Projekti 2022	Projekti 2023	Artikulli
Ardhura	"E drejta e krahasuar e vendeve të Europës Juglindore"	500	500	0	0	0	602
Ardhura	"Identifikimi i potencialit që ofron agroturizmi në zonën e Dumresë"	400	400	0	0	0	602
Ardhura	"Impakti i pasurisë së paprekshme në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit"	700	0	700		0	602
Ardhura	"Njëzet vite të kushtetutës në Shqipëri: Ndryshimet kushtetuese dhe reformat ligjore"	60	0	60	0	0	602
Ardhura	"Promovimi i programeve të studimit për studentët e FE (Ditët e hapura)."	500	500	0	0	0	602
Ardhura	"Studim mbi përpuethshmërinë e planeve mësimore që ofron Financë - kontabiliteti me nevojat që ka tregu"	500	500	0	0	0	602
Ardhura	"Thellime në biznes financë dhe ligj" - Konferenca e 9-të Ndërkombëtare	600	0	600		0	602
Ardhura	"Bashkëpunimi ekonomik rajonal dhe harmonizimi i legjisllacionit si premisë e integrimit evropian të shteteve të Ballkanit Perëndimorë" - Konferenca e 8-të Ndërkombëtare	520	520	0	0	0	602
Ardhura	"Hartimi i Kuadrit të kompetencave të mësuesit fillestar"	120	0	120		0	602
Ardhura	"Kijimi i laboratorit të pedagogjisë që integron teknologjinë e informacionit dhe komunikimit"	500	500	0	0	0	602



Ardhura	"Kompetenca digitale si kërkesë e kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar dhe realiteti shkollor"	500	150	350	0	0	602
Ardhura	"Konferencë për edukimin qytetar"	400	400	0	0	0	602
Financimi	Emertimi i projektit te investimit	Vlera e projektit	Buxhet i 2020	Projekt t 2021	Projekt 2022	Projekt 2023	Artikulli
Ardhura	"Konferencë për shkencat sociale"	500	500	0	0	0	602
Ardhura	"Konferencë shkencore ndërkombëtare në psikologji"	450	450	0	0	0	602
Ardhura	"Krijimi dhe vënia në funksion e Qendrës Audio si kusht për zhvillimin e laboratorit analitik"	700	700	0	0	0	602
Ardhura	"Krijimi i laboratorit didaktik në funksion të zhvillimit profesional të mësuesve"	600	0	600		0	602
Ardhura	"Krijimi i laboratorit të pedagogjisë që integron teknologjinë e informacionit dhe komunikimit"	600	600	0	0	0	602
Ardhura	"Krijimi i zyrës së këshillimit që integron teorinë dhe praktikën e ushtrimit të psikologjisë"	500	500	0	0	0	602
Ardhura	"Sfidat e Kërkimit Shkencor në Psikologjinë e Aplikuar dhe Edukimit"	800	0	800		0	602
Ardhura	"Vlerësimi nevojave të tregut për shërbime psikologjike, kërkesat e tregut"	300	0	300	0	0	602
Ardhura	"Ërkshop - edukimi fizik e sportet"	300	300	0	0	0	602
Ardhura	"Zhvillimi i tërësisë së kompetencave të studentit në mjedisin shkollor dhe i perceptimeve të tij për praktikat profesionale"	500	500	0	0	0	602
Buxhet	"Studimi mbi të miturit në vështirësi - migrimi dhe emigrimi i tyre"	8,590	8,590	0	0	0	230
Buxhet	"Studimi mbi të miturit në vështirësi - migrimi dhe emigrimi i tyre."	1,410	1,410	0	0	0	231
Ardhura	"Albania" e Faik Konicës dëshmi e kulturës publicistike shqiptare"	700	0	700		0	602
Ardhura	"Figura dhe personalitete të Albanologjisë në Elbasan"	400	0	400		0	602
Ardhura	"Figura të njohura të historiografisë në Elbasan"	500	500	0	0	0	602
Ardhura	"Fjale dhe shprehje për çdo rast"	800	800	0	0	0	602
Ardhura	"Gjuha rome në trevat shqipfolëse"	830	830	0	0	0	602
Ardhura	"Kontributi i flamurit të Arbërit 1887 - 1917 pas 130 vjetësh"	630	630	0	0	0	602
Ardhura	"Vlerat turistike të monumenteve të kulturës në trevën e Elbasanit"	500	500	0	0	0	602
Ardhura	"Dora D'Istra-portreti i një princeshe të harruar"	400	200	200	0	0	602
Ardhura	"Elbasani në dokumentet arkivore 1912-1914 "	400	0	400		0	602
Ardhura	"Elbasani në dokumentet Osmane në shekujt XV-XIX"	1,000	0	0	1,000	0	602
Ardhura	"Elbasani në vitet 1945-1955 -dokumente arkivore "	460	200	260	0	0	602
Ardhura	"Elbasani në vitet 1955-1965 -dokumente arkivore "	500	0	0	500	0	602
Ardhura	"Kontributi i Austrisë në mjedisin intelektual elbasanas " - Prof. As. Dr. Majlinda Peza	886	886	0	0	0	602
Ardhura	"Kujtesa kolektive në letërsi dhe media" - Prof. As. Dr.Ema Kristo	400	400	0	0	0	602
Ardhura	"Musa Vyshka-një zë i spikatur në poezinë e sotme shqipe"	708	354	354	0	0	602
Ardhura	"Studim për tipat kumtuesore të fjalive në gjuhën Shqipe"	400	0	0	400	0	602
Ardhura	"Konferenca e I-rë ndërkombëtare studentore në UE"	700	700	0	0	0	602
Buxhet	"Krijimi i Laboratorit Digjital të Anatomisë", Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	14,850	14,850	0	0	0	231
Ardhura	"Ndergjegjesimi, diagnostikimi dhe trajtimi i hershem i patologjive malinje te traktit gastrointestinal dhe patologjive interne"	700	700	0	0	0	602
Ardhura	"Konferenca e 6-të Ndërkombëtare infermiore në Specialitete"	700	700	0	0	0	602
Ardhura	"Konferenca e II-të ndërkombëtare në Logopedi dhe Fizioterapi	700	700	0	0	0	602
Ardhura	"Kongresi i 12-të Ndërkombëtar në Specialitetet Mjekësore"	5,300	700	2,300	2,300	0	602
Buxhet	"Matja e temperaturës së trupit: krahasimi i teknikave më të përdorura në moshat pediatrike në Shqipëri dhe Itali"	2,000	2,000	0	0	0	230
Buxhet	"Matja e temperaturës së trupit: krahasimi i teknikave më të përdorura në moshat pediatrike në Shqipëri dhe Itali"	210	210	0	0	0	231
Ardhura	"Bujqësia dhe impakti i saj në cilësinë e Tokës dhe të Ujërave"	1,972	0	1,972		0	602
Ardhura	"Geogebra - një mënyrë dinamike për të shpjeguar dhe mësuar matematikë në arsimin parauniversitar	600	600	0	0	0	602
Ardhura	"Impakti i aktivitetit human në biodiversitetin e trupave ujore në Shqipëri"	1,100	0	1,100		0	602
Ardhura	"Konferenca e II e Ballkanit përëndimor mbi shkencat matematike "	1,300	1,300	0	0	0	602
Ardhura	"Studimi efikasitetit dhe realizimi I përdorimit të sistemeve fotovoltaike në mjedise të ndryshme"	600	600	0	0	0	602
Buxhet	"Studimi i aktivitetit anti-tumor të ekstrakteve të bimëve mjekësore në Shqipëri dhe në Rajonin e Pulias, Itali."	2,300	2,300	0	0	0	230
Buxhet	"Studimi i aktivitetit anti-tumor të ekstrakteve të bimëve mjekësore në Shqipëri dhe në Rajonin e Pulias, Itali."	1,325	1,325	0	0	0	231
Ardhura	"Vlerësimi i diversitetit ekologjik në disa mjedise serpentinore në Rajonin e Elbasanit"	390	390	0	0	0	231
Ardhura	"Vlerësimi i diversitetit ekologjik në disa mjedise serpentinore në Rajonin e Elbasanit"	640	640	0	0	0	602



Ardhura	"Vlerësimi i ndotjes së ajrit nga metalet e rënda në zonën e Elbasanit	370	370	0	0	0	602
Ardhura	"Vlerësimi i toksicitetit të ujit të lumit shkumbin në jetën e organizmave ujorë si pjesë e strategjive në mbrojtjen e mjedisit	1,100	1,100	0	0	0	602
Financimi	Emertimi i projektit te investimit	Vlera e projektit	Buxhet i 2020	Projek t 2021	Projekt 2022	Projekt 2023	Artik ulli
Ardhura	Përcaktimi i cilësive fiziko - kimike të tokave	230	230	0	0	0	231
Ardhura	Përcaktimi i cilësive fiziko - kimike të tokave	720	720	0	0	0	602
Ardhura	Përdorimi i testeve ekotoksikologjike në hartimin e strategjive të përshtatshme të mbrojtjes së mjedisit	505	505	0	0	0	602
Ardhura	Digitalizimi i Bibliotekës	31,185	0	0	31,185	0	230
Ardhura	Digitalizimi i Bibliotekës	36,364	0	0	36,364	0	231
Ardhura	Digitalizimi i Bibliotekës	21,861	0	0	21,861	0	602
Ardhura	Kerkim shkencor - projekte te ndryshme	52,200	2,000	15,000	3,400	31,800	230
Ardhura	Kerkim shkencor - projekte te ndryshme	32,869	138	13,308	3,692	15,731	602
Ardhura	Kerkim shkencor - projekte te ndryshme	1,584	917	667	0	0	606
Ardhura	Modul "Edukim ne distancë"	9,600	0	9,600		0	230
Ardhura	Ndërtimi i Database-s së Universitetit për menaxhimin e të dhënave - mirembajtje	48,000	12,000	12,000	12,000	12,000	602

➤ Projektet e Huaja

Projektet e huaja në proces financimi janë si më poshtë:

Projekte huaja - UE											
Nr.	Emërtimi i projektit	Financimi 000/ lekë									
		Viti fillimit	Viti Mbarimit	Kosto Totale e Projektit	Shpenz. Derinë v. 2019	Shpenz. Pritshm. per v. 2020	Kosto lokale + TVSH 2020	Financim per vitin 2021	Kosto lokale + TVSH 2021	Financim per vitin 2022	Financim per vitin 2023
1	Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit	2013	2016	13,981	13,279	701	0	0	0	0	0
2	REBUS - Ngritja e biznesit - Integrimin dhe vlerësimi i aftësive praktike të ndërmarrësisë në inxhinieri dhe TIK	2016	2019	9,525	8,450	1,075	0	0	0	0	0
3	TEA VET-Zhvillimi kompetencave të mësimdhënies në Shqipëri	2017	2020	8,007	4,928	3,079	283			0	0
4	T@SK - Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësive dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale	2017	2020	14,922	8,211	6,711	0	0	0	0	0
5	E-VIVA-Përmirësimi dhe vlerësimi i kompetencave të lidhura me shërbime në mjedise të ndryshme të të mësuarit në Universitetet e Ballkanit Perëndimor	2019	2021	8,715	2,993	4,851	686	872	0	0	0
6	BEKSTONE-Platforma e sipërmarrjeve të Arsimit të lartë për nxitjen, modernizimin dhe rritjen e qëndrueshme në industrinë e gurit natyror në vendet e Ballkanit Perëndimor	2020	2021	7,621	0	5,811	800	1,810	0	0	0
7	VALEU-X,-Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare	2020	2022	10,378	0	7,907	1,036	1,994	51	477	0
8	DICSO-Krijimi i destinacioneve për të rinjtë në zonat ndërkufitare	2020	2022	15,210	0	0	0	5,070	1,014	5,070	5,070
9	REPRAISA-Vlerësimi dhe përmirësimi i Performancës së	2020	2022	8,879	0	0	0	5,690	819	1,595	1,595



	Kërkimit në Shqipëri dhe Kosovë										
	Shuma			97,238		30,134	2,805	15,435	1,884	7,142	6,665

UE ka disa vite që është përfshirë në përfitimet e fondeve nga projektet e huaja në kauadër të akteve ligjore e nënligjore që Qeveria Shqiptare ka me Bashkimin Europian. Përfshirja në këto projekte ka ndikuar si në krijimin e infrastrukturës akademike, në laboratorë e zyra edhe në mobilitet e personelit akademik e studentëve. Këto projekte financohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me Institucionin e Arsimit të lartë që aplikon, ndërkohë që menaxhimi i tyre realizohet në zbatim të procedurave të menaxhimit të buxhetit në Shqipëri.

Në tabelën e mësipërme janë të listuara 9 projekte të huaja, nga i cili projekti i parë kanë përfunduar në afatet kohore të financimit të tij. Projekti “REBUS” përfundon në fund të vitit 2019, ndërkohë që ka akoma një pjesë fondi të padisbursuar dhe shpenzuar. Projektet: “TEA VET”, “T@SK”, “e-VIVA” janë në proces. Projektet: “BKSTONE”, “VALEU-X” pritet të disbursohen së shpejti, janë hapur llogaritë speciale të tyre.

Personeli akademik ka aplikuar në disa projekte të huaja. Sipas të dhënave të paraqitura janë 2 projekte nga të cilët janë reflektuar në pasqyrën e mësipërme: “DICO” dhe “REPRAISA”.

4. Tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim

Bordi i Administrimit me Vendim nr.3 datë 12.02.2020 “Për vendosjen e tarifave të shkollimit në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani””, i ndryshuar, ka vendosur tarifën e shkollimit dhe tarifën tjetër që do të aplikohen në vitin në vijim mbështetur në relacionet si më poshtë:

1. Tarifa konkurrimi

Këtë tarifë e paguajnë kryesisht studentët në “Bachelor edukim fizik e sporte”, në fazën para regjistrimit. E veçanta në këtë program studimi është se krahas kritereve të përgjithshme për regjistrim, zhvillohen edhe konkurse. Vlerësimi në konkurrim zë 60 % të pikëve të aplikantit. Duke qenë se me këtë proces do të angazhohen strukturat e universitetit (Rektorat, Fakultet, Departament), aplikohet pagesa e tarifës së konkurrit që do të paguajë çdo aplikant në kohën e regjistrimit për konkurrim. Kjo tarifë do të jetë 5,000 lekë për aplikant.

2. Tarifë regjistrimi

a. Tarifë regjistrimi cikli i parë i studimeve – bachelor dhe programe studimi me karakter profesional dyvjeçar.

Këtë tarifë e paguan çdo kandidat që del fitues dhe regjistrohet në një program studimi në UE. Kjo tarifë do të jetë 1,600 lekë. E ardhura nga tarifa e regjistrimit do të shërbejë për të mbuluar kostot e angazhimeve të strukturave të UE – së me procesin e regjistrimit të studentëve (renditja e kandidatëve, regjistrimi në regjistrat themeltar, hartimi i listave për matrikullin etje.). Tarifa e regjistrimit që paguhet nga kandidatët për student, të cilët regjistrohen në një program studimi në UE, por që çregjistrohen në një fazë të mëvonshme nga ky program studimi, për tu regjistruar në një program tjetër brenda UE – së, të paguhet vetëm njëherë. Për kandidatët për student të regjistruar në një program studimi në UE dhe që çregjistrohen për t’u regjistruar në një Universitet tjetër, të jetë e pakthyeshme.

b. Tarifë regjistrimi cikli i dytë – Master profesional, Master shkencor.

Kjo tarifë do të jetë 2,500 lekë. E ardhura nga tarifa e regjistrimit do të shërbejë për të mbuluar kostot e angazhimeve të strukturave të UE – së me procesin e konkurrit,



regjistrimit të studentëve (renditja e kandidatëve, regjistrimi në regjistrat themeltar, hartimi i listave për matrikullin etje.). Tarifa e regjistrimit do të paguhet nga kandidatët për student, për secilin program që kandidati regjistrohet për konkurrim në ciklit e dytë – Mp, Msh në UE. Në momentin që del fitues në një program studimi, nuk do të ketë tarifë tjetër regjistrimi.

3. Tarifë shkollimi

3.1 Tarifat e shkollimit për të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të jenë:

- a) Në Ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë tarifa vjetore e shkollimit të jetë:
- Për program të parë studimi 25,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi 60,000 lekë.
 - Për vitin akademik 2019-2020 e në vijim, studentët në program të parë studimi, që regjistrohen në vitin e parë akademik të paguajnë tarifën vjetore 12,500 lekë.
 - Për vitin akademik 2019-2020 e në vijim, studentët në program të parë studimi, që studiojnë në vitin e dytë e të tretë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore 12,500 lekë. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore 25,000 lekë.
- b) Në Ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master profesional”, tarifa për çdo kredit të jetë:
- Për program të parë studimi 1,000 lekë/kredit.
 - Për program të dytë studimi 1,200 lekë/kredit.

Tarifa për kredit dhe e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë sipas tabelës nr.1.

- c) Në Ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i shkencave”, tarifa për çdo kredit të jetë:
- Për program të parë studimi 1,200 lekë/kredit.
 - Për program të dytë studimi 1,400 lekë/kredit.

Tarifa për kredit dhe e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë sipas tabelës nr.2.

3.2 Studenti i Ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë i shpallur sipas rregullores së Universitetit si përsëritës në vitin e parë dhe vitin e dytë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajë:

- Për program të parë studimi 25,000 lekë.
- Për program të dytë studimi 80,000 lekë.

3.3 Studenti që nuk përfundon studimet në fund të vitit të tretë për sistemin Bachelor apo në fund të vitit të dytë në Programin e studimeve profesionale, nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin pasardhës, por do të paguajë vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):

- për program të parë studimi 400 lekë/ kredit,
- për program të dytë studimi 1,300 lekë/ kredit.

3.4 Studenti i Ciklit të dytë të studimeve që nuk përfundon studimet brenda kohëzgjatjes së caktuar, pagan tarifën për kreditet e lëndëve të vlerësuara jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator).



- 3.5 Vlera e krediteve të mbartura të paguhet për vlerën totale të lëndëve të vlerësuara jo kaluese, menjëherë para fillimit të sezonit të parë të shlyerjes së detyrimeve mësimore. Kreditet e lëndëve të vlerësuara jo kaluese të krijuara në vijim, pas vitit të fundit akademik (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator), i shtohen detyrimeve të prapambetura dhe paguhet para shlyerjes së detyrimeve mësimore, të vitit pasardhës akademik.
- 3.6 Tarifa vjetore e shkollimit për Ciklin e parë të studimeve të paguhet para fillimit të shlyerjes së detyrimeve mësimore, ndërsa për Ciklin e dytë të studimeve, tarifa e përgjithshme të paguhet me këste para shlyerjes së detyrimeve mësimore të çdo semestri.
- 3.7 Studenti i Ciklit të parë që ka pezulluar studimet apo kërkon të çregjistrohet (nuk ka vijuar në mësim dhe nuk ka shlyer asnjë detyrim mësimor), të mos paguajë tarifë vjetore shkollimi për këtë periudhë. Ky fakt të vërtetohet me dokument nga fakultetet.
- 3.8 Studenti i Ciklit të dytë i pajisur me numrin e matrikullimit që kërkon të çregjistrohet nga ky program studimi nuk do paguajë asnjë detyrim financiar, në rast se nuk ka frekuentuar dhe nuk i është shërbyer për shlyerjen e detyrimeve mësimore. Ky fakt të vërtetohet me dokument nga fakultetet

Tabela nr. 1: Tarifat e përgjithshme të shkollimit në “Master profesional”

Nr	Emërtimi i programit	Kredit	Tarifat për kredit		Tarifa e përgjithshme	
			Program të parë	Program të dytë	Program të parë	Program të dytë
1	Administrim biznesi	60	1,000	1,200	60,000	72,000
2	Drejtim dhe administrim arsimit	60	1,000	1,200	60,000	72,000
3	Ekonomia dhe drejta në sektorin publik	60	1,000	1,200	60,000	72,000
4	Financë	60	1,000	1,200	60,000	72,000
5	Fizioterapi	60	1,000	1,200	60,000	72,000
6	Gazetar reporter	60	1,000	1,200	60,000	72,000
7	Gazetari sportive	60	1,000	1,200	60,000	72,000
8	Infermieri kirurgjikale	60	1,000	1,200	60,000	72,000
9	Informatikë Ekonomike	60	1,000	1,200	60,000	72,000
10	Kontabilitet	60	1,000	1,200	60,000	72,000
11	Logopedi	60	1,000	1,200	60,000	72,000
12	Marketing	60	1,000	1,200	60,000	72,000
13	Menaxhim infermior	60	1,000	1,200	60,000	72,000
14	Psikolog në institucione	60	1,000	1,200	60,000	72,000
15	Punonjës social me fëmijët dhe familjen	60	1,000	1,200	60,000	72,000
16	Redaktim	60	1,000	1,200	60,000	72,000
17	Shërbimi i provës	60	1,000	1,200	60,000	72,000
18	Teknik imazherie	60	1,000	1,200	60,000	72,000
19	Teknik laborator	60	1,000	1,200	60,000	72,000
20	Analist prodhimi	120	1,000	1,200	120,000	144,000
21	Analizë të dhënash	120	1,000	1,200	120,000	144,000
22	Mësuesi në Arsim e Mesëm të Ulët për Matematikë-Informatikë me profil minor në Fizikë	120	1,000	1,200	120,000	144,000
23	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët për Biologji-Kimi me profil minor në Edukim Shëndetësor dhe Mjedisor	120	1,000	1,200	120,000	144,000
24	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët për Edukatë Qytetare-Histori, me profil minor Gjeografi	120	1,000	1,200	120,000	144,000
25	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët për Edukatë Qytetare-Gjeografi me profil minor Histori	120	1,000	1,200	120,000	144,000
26	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët për Gjuhë shqipe dhe Letërsi	120	1,000	1,200	120,000	144,000



27	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët për Gjuhë të Huaj Anglisht me profil minor në Gjuhë Shqipe	120	1,000	1,200	120,000	144,000
28	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët për Gjuhë të Huaj Frënge, me profil minor në Gjuhë Shqipe	120	1,000	1,200	120,000	144,000
29	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët për Gjuhë të Huaj Gjermane, me profil minor në Gjuhë Shqipe	120	1,000	1,200	120,000	144,000
30	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët për Gjuhë të Huaj Italisht me profil minor në Gjuhë Shqipe	120	1,000	1,200	120,000	144,000
31	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët për Histori-Gjeografi me profil minor në Edukatë Qytetare	120	1,000	1,200	120,000	144,000
32	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët për Matematikë-Fizikë, me profil minor në Informatikë	120	1,000	1,200	120,000	144,000
33	Mësuesi në Edukim Fizik e Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor	120	1,000	1,200	120,000	144,000
34	Teknologjitë e informacionit	120	1,000	1,200	120,000	144,000

Tabela nr. 2: Tarifat e përgjithshme të shkollimit në “Master i shkencave”

Nr	Emërtimi i programit	Kredit e	Tarifat përkredit		Tarifa e përgjithshme	
			Programi tëparë	Programi tëdytë	Programi tëparë	Programi tëdytë
1	Gjuhësi	120	1,200	1,400	144,000	168,000
2	Trashëgimi kulturore	120	1,200	1,400	144,000	168,000
3	Studime letrare	120	1,200	1,400	144,000	168,000
4	Studime historike	120	1,200	1,400	144,000	168,000
5	Studime gjeografike	120	1,200	1,400	144,000	168,000
6	Matematike e zbatuar	120	1,200	1,400	144,000	168,000
7	Mbrojtje mjedisi	120	1,200	1,400	144,000	168,000
8	Ekonomiadhe e drejta në tregjet ndërkombëtare	120	1,200	1,400	144,000	168,000
9	Marketing	120	1,200	1,400	144,000	168,000
10	Drejtim bankar	120	1,200	1,400	144,000	168,000
11	Menaxhim	120	1,200	1,400	144,000	168,000
12	Kontabilitet dhe Auditim	120	1,200	1,400	144,000	168,000
13	Psikologji edukimi	120	1,200	1,400	144,000	168,000
14	Shërbime sociale	120	1,200	1,400	144,000	168,000
15	Infermieri	120	1,200	1,400	144,000	168,000
16	Mami	120	1,200	1,400	144,000	168,000
17	Mësuesi për Arsimin Fillor	120	1,200	1,400	144,000	168,000

4. Tarifa të tjera për studentët.

Burimet e tjera të të ardhurave: qira, programe mësimore, diploma, librezë studenti, vërtetim diplomimi, certifikatë notash, shërbime laboratorit etj. zënë një peshë të vogël në strukturën e të ardhurave, kjo për faktin e tarifave që aplikohen për këto shërbime.

Përveç tarifave të mësipërme, propozojmë tarifat për shërbimet e tjera që kryhen në universitet.

Tarifat e shërbimit të tjera			
Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Çmimi
1	Vërtetime diplomimi (para marrjes diplomës)	lekë	500
2	Certifikatë notash (dublikatë)	lekë	500
3	Programe mësimore	lekë/ program	200
4	Librezë studenti	lekë	500



5	Diplomë me suportin e saj	lekë	1000
7	Pjesëmarrje në Konferencë Shkencore	lekë	5,000

d) Dokumentacioni i shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Detyrimet tatimore, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore e sigurimi suplementar dhe shlyerja e tyre.

Në zbatim të akteve ligjore e nënligjore për detyrimet tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrimet e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për çdo muaj janë deklaruar dhe likuiduar rregullisht detyrimet.

Universiteti ka likuiduar detyrimet tatimore brenda afateve të përcaktuara dhe për tetëmujorin nuk ka detyrime të palikuiduara, sikurse konfirmohet nga pamja e sistemit të tatimeve:

e) Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.

Projektet e huaja 2020

Universiteti për vitin 2020 ka 9 projekte të huaja. Nga projektet e huaja në bankën e nivelit të dytë janë gjendje 7,558 mijë lekë. Për periudhën Janar-Tetor 2020 janë disbursuar 82,461.21 Euro ose 10,396 mijë lekë. Gjatë kësaj periudhe janë shpenzuar 5,288 mijë lekë ose 17.5 % të fondeve të parashikuara të ndara: për investime vlera 1,850 mijë lekë dhe shpenzime operative vlera 3,468 mijë lekë. Situata e projekteve:

- Projekti “Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit” ka përfunduar, është me gjendje monetare në bankë. Për gjendjen e mbetur, pritet konfirmim nga donatori për të vepruar. Ky fond mund të rikthehet tek donatori ose do të kalojnë në të ardhurat e Universiteti, për mbulimin e shpenzimeve që janë kryer nga të ardhurat e institucionit gjatë zbatimit të projektit.
- Projekti “Përmirësimi i sigurimit të cilësisë dhe Akreditimit në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri: Aplikimi i Metodologjisë të Procesit dhe Rezultateve” ka përfunduar. Nuk është mbyllur, pasi pritet disbursimi i investimeve të projektit në vlerën prej 1,460 mijë lekë, e cila është financuar nga të ardhurat e institucionit për likuidimin e blerjes së pajisjeve të pajisjet e projektit.
- Projekti “REBUS - Ngritja e biznesit - Integrimin dhe vlerësimi i aftësive praktike të ndërmarrësisë në inxhinieri dhe TIK”, ka përfunduar në vitin 2019. Gjatë kësaj periudhe janë disbursuar dhe shpenzuar disa shërbime të papërfunduara.
- Projekti “TEA VET-Zhvillimi kompetencave të mësimdhënies në Shqipëri”, përfundon në vitin 2020. Gjatë kësaj periudhe kanë mbetur disa shërbime të papërfunduara për vlerën 637 mijë lekë.
- Projekti “T@SK - Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësisë dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale” përfundon në vitin 2020. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shpenzime për investime në vlerën 615 mijë lekë dhe shpenzime operative 895 mijë lekë. Ky projekt ka në fund të periudhës vlerën 3,293 mijë lekë.



- Projekti “E-VIVA-Përmirësimi dhe vlerësimi i kompetencave të lidhura me shërbime në mjedise të ndryshme të të mësuarit në Universitetet e Ballkanit Perëndimor” përfundon në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shpenzime për investime në vlerën 1,235 mijë lekë dhe shpenzime operative 1,336 mijë lekë. Ky projekt ka në në fund të periudhës vlerën 2,090 mijë lekë .
- Projekti “BEKSTONE-Platforma e sipërmarrjeve të Arsimit të lartë për nxitjen, modernizimin dhe rritjen e qëndrueshme në industrinë e gurit natyror në vendet e Ballkanit Perëndimor” ka filluar në vitin 2020 dhe përfundon në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe nuk janë kryer shpenzime për investime dhe shpenzime operative. Ky projekt ka në në fund të periudhës vlerën 4,519 mijë lekë .
- Projekti “VALEU-X,-Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare” ka filluar në vitin 2020 dhe përfundon në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shpenzime për investime , të cilat nuk janë likujduar ndërsa shpenzime operative në vlerën 2 mijë lekë. Ky projekt ka në në fund të periudhës vlerën 1,434 mijë lekë .


Projekte huaja - UE janar - Tetor 2020													
Nr.	Emërtimi i projektit	Viti i		Statusi	Financimi lekë							1 €=127 lekë	
		Filli mit	Mbar imit		Gjend ja ne banke 01.01. 2020	Disbursuar		Total në Lekë	Shpenzime e realizuara (ne leke)			Gjendj e në bankë 31.10. 2020	
						në EUR	në Lekë		Shpe nzim e koren te	Shpen zime kapita le	Total		
1	Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit	2013	2016	Ka përfun duar	701	0	0	701	6	0	6	695	
2	Përmirësimi i sigurimit të cilësisë dhe Akreditimit në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri: Aplikimi i Metodologjisë të Procesit dhe Rezultateve	2014	2016	Ka përfun duar	0	0	0	0	0	0	0	0	
3	REBUS - Ngritja e biznesit - Integrimin dhe vlerësimi i aftësive praktike të ndërmarrësisë në inxhinieri dhe TIK	2016	2019	Në vazhdi m	6	7,489	951	957	957	0	957	0	
4	TEA VET-Zhvillimi kompetencave të mësimdhënies në Shqipëri	2017	2020	Në vazhdi m	878	0	0	878	241	0	241	637	
5	T@SK - Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësisë dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale	2017	2020	Në vazhdi m	4,803	0	0	4,803	895	615	1,510	3,293	
6	E-VIVA-Përmirësimi dhe vlerësimi i kompetencave të lidhura me shërbime në mjedise të ndryshme të të mësuarit në Universitetet e Ballkanit Perëndimor	2019	2021	Në vazhdi m	1,171	28,083	3,490	4,661	1,336	1,235	2,571	2,090	
7	BEKSTONE-Platforma e sipërmarrjeve të Arsimit të lartë për nxitjen, modernizimin dhe rritjen e qëndrueshme në industrinë e gurit natyror në vendet e Ballkanit Perëndimor	2020	2021	Në vazhdi m	0	35,583	4,519	4,519	0	0	0	4,519	
8	VALEU-X,-Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare	2020	2021	Në vazhdi m	0	11,307	1,436	1,436	2	0	2	1,434	
0	Shuma	0	0	0	7,558	82,461	10,396	17,955	3,438	1,850	5,288	12,667	



- f) Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, në bashkëpunim me Senatin Akademik të institucionit të arsimit të lartë.

1. Të dhëna për infrastrukturën mjedisore.

UE e ushtron veprimtarinë e tij mësimore pothuajse në të gjithë territorin e qytetit të Elbasanit, edhe në periferi të tij (Njësia Administrative Bradashesh).



Aktualisht UE ka në administrim (vlerë kontabël) 12 godina dhe është kryer procedura e kalimit në pronësi të universitetit dhe regjistrimi i tyre në ZVRPP. Janë regjistruar godinat së bashku me truallin tek FSHMT. Është regjistruar godina e FSHH (ish materniteti), Laboratorit (metalurgji) dhe Krasta. Po vazhdon puna për legalizimin e shtesave dhe regjistrimin e godinave ekzistuese. Sipërfaqja e mjediseve mësimore për student sipas godinave paraqitet:

Fakultetet	Sipërfaqja m²		Nr. Studentëve	Sipërfaqja m² për student
	Gjithsej	mësimore		
Godina e Korpusit Kryesor	7,127	3,403		0.0
Godina e Laboratorit Shkencor	1,884	1,180		0.0
Godina e akademikëve	865	81		0.0
Godina e Bibliotekës	1,680	972		0.0
FSHN+FSHH	11,556	5,636	1,642	3.4
Godina e Fakultetit shk. Edukimit	3,023	1,709		0.0
Objekt me Qira	1,000	1,000		0.0
Palestra	418	374		0.0
FSHE	4,441	3,083	1,705	1.8
Godina e Fakultetit Ekonomik	3,144	1,865		0.0
FE	3,144	1,865	1,255	1.5
Godina e FSHMT	2,942	1,876		0.0
FSHMT	2,942	1,876	2,265	0.8
Rektorati	924	0		0.0
Godina FSHH(Ish maternitet)	1,313	0		0.0
Shuma	24,320	12,460	6,867	1.8



2. Të dhëna për infrastrukturën informatike e didaktike.

Investimet e kryera në laboratore, mjete didaktike, fond libri për bibliotekën e pajisje të tjera.e kemi paraqitur në dy periudha si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i projektit	Para krijimit të BA		Pas krijimit të Bordi Administrimit		
		Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019 8m
1	Pajisje laboratorike e didaktike	15,186	25,150	26,115	15,725	118
1	Laboratorë me pajisje kompjuterike	15,186	9,360	9,446	0	0
2	Pajisje e orendi për auditore laboratore	0	15,790	7,325	948	0
3	Pajisje laboratorike didaktike	0	0	9,344	14,777	118
II	Biblioteka	97	190	0	4,686	0
1	Fond libri biblioteka	97	190	0	4,686	0
III	Mjete transporti	0	0	0	7,620	0
1	Automjet Mini Bus - (8+1)	0	0	0	3,209	0
2	Automjet 4+1	0	0	0	4,411	0
VI	Projekte të huaja	0	1,402	89	1,460	9,967
1	Pagesë TVSH për investime	0	0	0	0	1661
2	Pajisje për projektet e huaja	0	1,402	89	1,460	8,306
	Shuma	15,283	26,742	26,204	29,491	10,085

REKTORI

Prof. Dr. Skender TOPI

